
PËRMBAJTJA E REVISTËS:

Numri XLI, viti 2008

Faqe

Reforma ligjore dhe procesi i integritit:

Efektet ligjore të marrëveshjeve të asociimit me BE-në për shtetasit e vendeve joanëtare

Alfred KELLERMANN 4

Historiku i ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë

Rovena PREG JA 63

E Drejta Kushtetuese:

Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe roli i rëndësishëm i tyre në forcimin e shtetit të së drejtës

Tefta ZAKA 80

Analizë e veprimtarisë dhe legjislacioneve për gjykatat kushtetuese të Europës Lindore, Perëndimore dhe SHBA-së. Vështrim krahasues.

Erion MANOHASA 111

E drejta, shteti, gjyqtari; Çështja e sigurisë.

Philippe RAYNAUD 120

Nga veprimtaria e Kuvendit:

Legjislacioni i miratuar

Filip LAKO 145

TABLE OF CONTENTS:

41th issue, year 2008

| | Page |
|---|------|
| <hr/> | |
| <i>Legal reform and the Integration process:</i> | |
| Legal effects of the Stabilization and Association Agreement with EU on the citizens of non-member states. Alfred KELLERMANN | 4 |
| The history of the law on the organization of the judiciary power in the Republic of Albania. Rovena PREGJA (QOSE) | 63 |
| <hr/> | |
| <i>Constitutional Law:</i> | |
| The execution of the decisions of the Constitutional Court and their importance for strengthening the rule of law in Albania. Tefta ZAKA | 80 |
| Analysis on the legislations and the activities of the Constitutional Courts in Eastern Europe, Western Europe and USA. A comparative view. Erion MANOHASA | 111 |
| The Law, state, the judge. Issue of security. Philippe RAYNAUD | 120 |
| <hr/> | |
| <i>From the activity of the Assembly:</i> | |
| Information about legislation approved by the Assembly Filip LAKO | 120 |
| <hr/> | |

Rubrikat në vijim synojnë prezantimin e politikave ligjore dhe të trajtimeve teorike për organizimin dhe funksionimin e institucioneve kushtetuese. Botuesi vlerëson si një kontribut në zhvillimin dhe përmirësimin e funksionimit të institucioneve kushtetuese, paraqitjen e opinioneve dhe të mendimeve të studiuesve të ndryshëm, në mënyrë të paanshme dhe objektive, duke nxitur një debat profesional.

Opinionet e paraqitura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin e botuesit të kësaj reviste.

Efektet ligjore të Marrëveshjeve të Asociimit me BE-në për shtetasit e vendeve joanëtare

*Alfred KELLERMANN**

Përktheu: Erjola Xhuvani

TABELA E PËRMBAJTJES

PJESA I. Efektet ligjore të Marrëveshjeve të Asociimit me BE-në në rendin ligjor të Komunitetit.

A. Prezantim i përgjithshëm i parimeve dhe burimeve të legjislacionit Komunitar.

B. Vendime paraprake të Gjykatës Europiane të Drejtësisë lidhur me efektet e paraanëtarësimit të Marrëveshjeve Europiane në rendin ligjor të Komunitetit.

C. Efektet e paraanëtarësimit të Marrëveshjes së Asociimit BE-Turqi, Marrëveshjeve të Stabilizim-Asociimit dhe Marrëveshjeve të Ndërmjetme, në rendin ligjor të Komunitetit.

D. Efektet ligjore në rendin ligjor të Komunitetit të Marrëveshjeve të Partneritetit dhe Bashkëpunimit midis Ruisë, BE-së dhe vendeve anëtare të saj.

*Udhëheqës ekipi në projektin “Për fuqizimin e Ministrisë së Integritimit”

PJESA II. Efektet ligjore të Marrëveshjeve të Asociimit në rendin ligjor kombëtar të vendeve joanëtare

A. Efektet ligjore të Marrëveshjeve Europiane dhe çështje gjyqësore në rendin e brendshëm ligjor gjatë periudhës së paraanëtarësimit.

B. Efektet ligjore të MSA-së, Marrëveshjeve të Asociimit me Turqinë, Marrëveshjeve të Partneritetit dhe të Asociimit me Rusinë në rendin e brendshëm ligjor.

Në këtë artikull do të flas për efektet ligjore të Marrëveshjeve të Asociimit me BE-në. Çfarë janë Marrëveshjet e Asociimit? Këto marrëveshje hyjnë në kategorinë e marrëveshjeve mikse. Për të kuptuar këtë ndarje duhet të shikojmë këto marrëveshje: Marrëveshjet Europiane, Marrëveshja e Asociimit me Turqinë, Marrëveshja e Stabilizimit me Turqinë, Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit dhe së fundi Marrëveshja e Partneritetit dhe e Bashkëpunimit (MPB).

Gjithashtu, do të kufizoj analizën në një Marrëveshje të Tregtisë së Lirë me Shqipërinë dhe nuk do të analizoj marrëveshjet me Maqedoninë dhe Kroacinë. Ndërsa, për sa i përket MPB-së, do të kufizohem në analizë të kësaj marrëveshjeje me Federatën Ruse, duke përjashtuar 10 marrëveshjet e tjera të këtij tipi. Për të marrë këtë vendim më ka ndihmuar eksperiencia vetjake gjatë punës sime si udhëheqës ekipi i projektit TACIS gjatë viteve 2002-2006 në Rusi dhe Projekti CARDS në Shqipëri nga viti 2007 deri në vitin 2009.

Marrëveshjet e Asociimit me BE-në sjellin pasojat ligjore. Marrëveshja Europiane, p.sh., përpara datës së anëtarësimit, përcakton të drejta dhe detyrime për vendet candidate dhe qytetarët e saj, të drejta këto që rrjedhin nga e drejta Komunitare dhe veçanërisht ato marrëveshje që negociohen midis vendeve candidate potenciale dhe BE-së e vendeve anëtare të saj. Këto mund të konsiderohen efektet e para të anëtarësimit të së Drejtës Komunitare. Gjithashtu, vendimet e Këshillit European kanë efekte paraanëtarësimi në sistemin ligjor Komunitar, si dhe në sistemin e brendshëm

ligjor të vendeve parakandidate, siç do të trajtohet më poshtë.

Kriteret e Kopenhagenit dhe efektet e paraanëtarësimit.

Këshilli European i Kopenhagenit vendosi në qershor të vitit 1993 se çdo shtet, i cili ka nënshkruar Marrëveshjet Europiane me Komunitetin European dhe vendet e tij anëtare, mund të aplikojë për anëtarësim nëse ka përmbushur kriteret e nevojshme politike dhe ekonomike, si dhe detyrimet e tjera për anëtarësim. Edhe pse një shtet kandidat ende nuk është një shtet anëtar i BE-së, ka të drejta dhe detyrime menjëherë sapo ka hyrë në fuqi Marrëveshja Europiane. Disa detyrime të tjera për vendet candidate ose candidate potenciale, që rrjedhin nga negociatat, anëtarësimi ose partneriteti european dhe kriteret e Kopenhagenit, janë:

- Vendi kandidat duhet të sigurojë qëndrueshmërinë e institucioneve, duke garantuar shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe respektimin e minoriteteve (kriteri politik).

- Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale, si dhe kapaciteti për të bashkëpunuar me fuqi konkurruese dhe në tregun European (kriteri ekonomik).

- Stabiliteti për të realizuar detyrimet e anëtarësimit, duke zbatuar qëllimin politik, ekonomik dhe atë të bashkimit monetar.

Efektet e së ashtuquajturës kritere të Kopenhagenit, kriteri politik, është futja e Traktatit të Amsterdimit në nenin 49 të Traktatit të BE-së, i cili i referohet nenit 6 të Traktatit të BE-së (Bashkimi themelohet mbi bazën e parimeve të lirisë, demokracisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës). Të njëjtat kritere janë parashikuar dhe në tekstet e Kushtetutave të vendeve kombëtare. Përputhshmëria me të gjitha këto kritere monitorohet nga Komisioni European në raportet e tij të progresit. Në fillim do të trajtoj efektet ligjore të Marrëveshjeve të Asociimit në doktrinë. Më pas do të demonstroj dhe analizoj efektet ligjore në praktikë me shembujt e shumë çështjeve gjyqësore:

I. Në rendin ligjor të Komunitetit

II. Në rendin ligjor kombëtar të vendeve jo-anëtare (kandidate potenciale), të vendeve kandidate dhe të vendeve të cilat kanë Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Partneriteti me BE-në.

Në pjesën e parë (1) të këtij artikulli do të trajtoj efektet ligjore të Marrëveshjeve të Asociimit me BE-në në rendin ligjor të Komunitetit (dhe në rendet ligjore kombëtare të vendeve anëtare të BE-së) për qytetarët e vendeve kandidate potenciale. Do të fokusohemi dhe do të diskutojmë vendimet parapërgatitore nga Gjykata Europiane e Drejtësisë që rrjedhin nga zbatimi i efektit të drejtpërdrejtë të Marrëveshjeve Europiane që janë negociuar midis BE-së dhe ish-vendeve kandidate, tashmë vende anëtare nga viti 2004 dhe viti 2007. Kam zgjedhur për të trajtuar çështje të Gjykatës Europiane, ku palë kanë qenë Polonia, Republika Çeke, Bullgaria, Turqia dhe Federata Ruse. Në vende si Kroacia, Shqipëria, Maqedonia, ku ende nuk ka çështje gjyqësore për shkelje të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, do të diskutojmë fillimin e procedurave ligjore sipas nenit 234 të Traktatit të Komunitetit Europian.

Pjesa e dytë e këtij artikulli do të fokusohet në efektet ligjore të Marrëveshjeve të Asociimit në periudhën e paraanëtarësimit në rendin ligjor kombëtar të vendeve joanëtare të BE-së. Do t'i jepet një rëndësi e veçantë çështjeve ku palë janë vendet joanëtare të BE-së, duke iu referuar dispozitave kushtetuese kombëtare dhe veçanërisht atyre kushteve që rregullojnë marrëdhëniet midis së drejtës ndërkombëtare, legjislacionit vendas dhe rolit të gjyqësorit. Do të trajtoj dhe efektet e Marrëveshjeve të Asociimit në rendin e brendshëm ligjor të vendeve të cilat nuk aplikojnë për anëtarësim, si Rusia.

Pjesa I. Efektet ligjore të Marrëveshjeve të Asociimit me BE-në në rendin ligjor të Komunitetit.

A. Prezantim i përgjithshëm i parimeve dhe burimeve të së drejtës

Komunitare.

Për të kuptuar efektet ligjore në rendin ligjor komunitar gjatë periudhës së paraanëtarësimit, do të bëj një prezantim të përgjithshëm të parimeve themelore të së drejtës komunitare (burimet parësore dhe dytësore, kazuse si Van Gend&Loos, Costa ENEL (1); marrëveshjet me vendet jo anëtare; rasti Demirel (2). Shumë i rëndësishëm është roli i Gjykatës Europiane të Drejtësisë në dhënien e vendimeve parapërgatitore, neni 234 i Traktatit të Komunitetit Europian, sipas së cilit gjykatat kombëtare e çdo shteti anëtar mund të kërkojnë interpretimin e Traktateve dhe të legjislacionit dytësor nga Gjykata Europiane e Drejtësisë.

Burimet e së drejtës Komunitare ndahen në burime parësore dhe dytësore. Legjislacioni parësor Komunitar përbëhet nga Traktati Ekonomik Europian, Traktati i Qymyrit dhe i Çelikut dhe Traktati i Bashkimit Europian. Së bashku me parimet e përgjithshme të së drejtës, ata përbëjnë dispozitat kushtetuese të së drejtës Komunitare. Legjislacioni parësor përfshin dhe protokollat dhe anekset e Traktateve, marrëveshjet ndërkombëtare si: Marrëveshjet Europiane, ato të Stabilizim-Asociimit dhe Traktatet e Anëtarësimit.

Legjislacioni dytësor përbëhet nga aktet e institucioneve (akte autonome si rregulloret, direktivat, vendimet, rekomandimet etj.). Për të kuptuar karakterin e të drejtës Komunitare duhet të kemi parasysh se zhvillimet e sistemit Komunitar ligjor nuk janë të parashikuara si dispozita Traktati ose legjislacion dytësor, nëpërmjet praktikave interpretuese të Gjykatës Europiane të Drejtësisë, siç do të shikojmë më poshtë.

Marrëdhënia midis legjislacionit parësor dhe dytësor, p.sh., nuk është parashikuar në Traktat, por hierarkia e normave të tij mund të interpretohet nga neni 231 i Traktatit të Komunitetit Europian, sipas së cilit nëse animimi është i bazuar, Gjykata e Drejtësisë e deklaron nul aktin e ankimuar. Rishikimi gjyqësor përfshin shqyrtimin e pyetjes nëse veprimet në fjalë janë në përputhje me atë çka ka parashikuar ligji. Në krye të hierarkisë janë dispozitat e legjislacionit Komunitar Parësor, duke futur këtu dhe parimet e përgjithshme

të së drejtës, për të cilat Gjykata e Drejtësisë siguron se zbatohen në përputhje me nenin 220 të Traktatit të Komunitetit Europian.

Marrëdhënia midis të drejtës Komunitare dhe legjislacionit vendas nuk parashikohet në mënyrë eksplicite në Traktat. Edhe parimet e superioritetit dhe të efektit të drejtpërdrejtë nuk janë shprehur në mënyrë eksplicite në Traktat. Këto parime janë interpretuar nga Gjykata Europiane e Drejtësisë në vendimin e saj për çështjen Van Gend & Loos dhe Costa Enel. Nga këto dy çështje do t'i citojmë si më poshtë:

Çështja 26/62

“Përfundimi që nxjerrim nga kjo është se Komuniteti parashikon një rend të ri ligjor të së drejtës ndërkombëtare për përfitimin e së cilës, shtetet kanë kufizuar sovranitetin e tyre, megjithëse në fusha të kufizuara dhe subjektet e së cilës përfshijnë jo vetëm vendet anëtare, por edhe qytetarët e tyre. Pavarësisht legjislacionit të vendeve anëtare, e drejta Komunitare jo vetëm që vendos detyrime për qytetarët, por edhe i mbron këto të drejta, të cilat bëhen pjesë e trashëgimisë ligjore. Këto të drejta ngrihen jo vetëm në rastet e shprehura në mënyrë eksplicite nga Traktati, por edhe aty ku ekziston detyrimi, të cilin Traktati e vendos për individët, shtetet anëtare dhe për institucionet e Komunitetit”.

Çështja 6/64, Flaminio Costa v. ENEL;

“... Në ndryshim me traktatet e zakonshme ndërkombëtare, Traktati i Komunitetit Ekonomik Europian krijoi sistemin e tij ligjor, me hyrjen në fuqi të Traktatit, duke u bërë pjesë integrale e sistemeve ligjore të vendeve anëtare të BE-së. Duke krijuar një Komunitet, i cili ka institucionet, personalitetin dhe kapacitetin e tij ligjor, si dhe kapacitetin e përfaqësimit në rrafshin ndërkombëtar dhe veçanërisht pushtet që rrjedh nga kufizimi i sovranitetit ose transferimi i pushtetit nga vendet anëtare drejt Komunitetit, vendet anëtare kufizojnë të drejtat e tyre sovrane, duke krijuar një sistem ligjor që duhet zbatuar nga qytetarët europianë...”

Përparësia e të drejtës Komunitare parashikohet në nenin 189, nëpërmjet

të cilit një rregullore është e detyrueshme dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në vendet anëtare të BE-së...”

Nga sa më sipër, e drejta që rrjedh nga Traktati, nuk mund, për shkak të natyrës së veçantë, të mos respektohet nga legjislacioni i një vendi anëtar. Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve, që rrjedhin nga Traktati, nga rendi i brendshëm ligjor i vendeve anëtare tek rendi ligjor i Komunitetit, shoqërohet me një kufizim të përhershëm të të drejtave të tyre të sovranitetit.

Gjykata e Drejtësisë nuk ka juridiksion të vendosë për vlefshmërinë e të drejtës Komunitare. Ajo bën vetëm interpretimin e kësaj të drejte. Kjo do të thotë se dispozitat e Marrëveshjeve të Stabilizim-Asociimit ose të Marrëveshjeve Europiane nuk janë subjekt i rishikimit gjyqësor nga Gjykata e Drejtësisë.

Marrëveshjet me vendet joanëtare të BE-së, Marrëveshjet Europiane, Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit, Marrëveshjet e Partneritetit dhe të Asociimit- Efekti i drejtpërdrejtë.

Neni 300 i Traktatit të Komunitetit European parashikon procedurën me të cilën Komuniteti negocion dhe nënshkruan Marrëveshje me vende joanëtare të BE-së ose me organizata ndërkombëtare. Marrëveshjet e nënshkruara në përputhje me kushtet e parashikuara në Traktat janë të detyrueshme për institucionet e Komunitetit dhe për vendet anëtare. Marrëveshje të tilla si ajo Europiane, e Stabilizim - Asociimit, e Asociimit, e Partneritetit dhe e Bashkëpunimit formojnë një pjesë integrale të rendit ligjor Komunitar nga momenti i hyrjes së tyre në fuqi.

Kjo është në përputhje me sistemin monist. Marrëveshjet e nënshkruara nga Komuniteti janë pjesë e rendit ligjor të Komunitetit pa qenë nevoja për të transpozuar dispozitat e brendshme të së drejtës Komunitare. Rregullat e përcaktuara nga marrëveshjet në hierarki qëndrojnë më lart sesa institucionet e Komunitetit. Kjo mund të vihet re nga fakti se Gjykata e Drejtësisë e konsideron institucionin e saj si të paautorizuar për të shqyrtuar vlefshmërinë e akteve të institucioneve. Duke qenë se marrëveshjet ndërkombëtare që

lidh Komuniteti janë në rang hierarkik më lart se legjislacioni dytësor Komunitar, dispozitat e këtij të fundit duhet të interpretohen në mënyrë që të jetë konsistente me këto marrëveshje. Qytetarët mund të ngrenë padi në Gjykatat Kombëtare për shkelje të një dispozite të Marrëveshjes vetëm nëse këto dispozita kanë efekt të drejtpërdrejtë. Lidhur me çështjen Van Gend & Loos gjykata u shpreh se “Formulimi i nenit 12 shpreh një ndalim të qartë dhe të pakushtëzuar, i cili nuk është pozitiv, por është negativ”. Çështja Van Gend & Loos u konsiderua si një detyrim negativ. Kështu, Traktati nuk krijon vetëm të drejta dhe detyrime për shtetet anëtare, por edhe për qytetarët”.

A zbatohet efekti i drejtpërdrejtë në marrëveshjet ndërkombëtare?

Sipas jurisprudencës së përcaktuar nga Gjykata Europiane e Drejtësisë, për shembull rasti Demirel (2), përgjigjja e kësaj pyetjeje është ‘po’: “Dispozita e një marrëveshjeje ndërkombëtare e lidhur nga Komuniteti me vendet joanëtare duhet të jetë drejtpërdrejtë e zbatueshme kur dispozita përmban një detyrim të qartë dhe preciz, i cili nuk është subjekt në zbatimin e tij ose prek miratimin e ndonjë mase pasuese. E thënë ndryshe, dispozitat e lartpërmendura të Marrëveshjeve të Stabilizim-Asociimit, Partneritetit dhe Bashkëpunimit, i lejojnë qytetarët e vendeve përkatëse të ngrenë padi ndaj shkeljes së këtyre dispozitave në gjykatat kombëtare të vendeve pritëse. Dispozitat identike që përmbajnë detyrime negative të ashtuquajtura dispozitat standstill, siç është rasti i çështjes Gend & Loos, parashikohen në Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit dhe të Marrëveshjeve të Partneritetit dhe të Bashkëpunimit. Sipas këtyre kushteve, një numër i konsiderueshëm i dispozitave të veçanta të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, të Marrëveshjes së Asociimit, të Marrëveshjes së Partneritetit dhe të Bashkëpunimit mund të shkelen dhe të ngrihet padi në gjykatë për shkeljen e tyre gjatë periudhës së paraanëtarësisimit. P.sh., rasti i detyrimeve negative, çështja Van Gend & Loos (detyrim, i cili nuk duhet të vendosej për tarifat doganore pas një date të caktuar), si dhe çështje të tjera për shkelje të dispozitave të mos-diskriminimit në fushën e së drejtës së vetëpunësimit të

qytetarëve dhe të lëvizjes së lirë të punëtorëve të vendeve kandidatë në vendet anëtare të BE-së. Gjithsesi, gjatë periudhës së paraanëtarësimit efekti i drejtpërdrejtë varet nga interpretimi i kushtetutave kombëtare, siç do të shikojmë në pjesën e dytë të këtij artikulli.

Edhe pse Këshilli dhe Komisioni Europian kanë hartuar forma fleksibile të integritimit në strategjinë e paraanëtarësimit, Kalendarin 2000 dhe Partneritetin i Anëtarësimit, të cilat janë bërthama e parimeve kushtetuese të Komunitetit, duhet të realizohen nga të gjitha vendet anëtare. Vendet kandidatë duhet të transpozojnë *acquis communautaire*, e cila është vënë si detyrim në Traktatin e Maastrichtit në vitin 1991 në nenin B dhe C (versioni i ri: neni 2 dhe 3). Përkufizimi i *acquis communautaire* është dhënë në Traktat. Në praktikë, institucionet e Komunitetit Europian i referohen *acquis communautaire* po aq sa dhe teksteve ligjore dhe vendimeve të Gjykatave të dhëna që nga ekzistenca e krijimi i Komuniteteve në vitin 1952 e deri tani. *Acquis* përfshin versionin e fundit të të gjithë legjislacionit parësor të BE-së, marrëveshjet e lidhura ndërkombëtare, si p.sh. Marrëveshjet Europiane, Marrëveshjet e Anëtarësimit dhe kazuse të Gjykatës së Drejtësisë, si dhe legjislacionin dytësor.

Gjykata Europiane e Drejtësisë i referohet në disa raste *acquis communautaire* dhe shpjegon se, që nga data e anëtarësimit, nevojitet një zbatim uniform i *acquis communautaire* dhe vendet e reja anëtare janë subjekt i detyrimeve të njëjta, ashtu si dhe vendet më të vjetra anëtare.

B. Çështje të Gjykatës Europiane të Drejtësisë lidhur me efektin e paraanëtarësimit të Marrëveshjeve Europiane në rendin ligjor të Komunitetit dhe çështje të tjera që lidhen më vendet anëtare të BE-së.

Që nga viti 1991, 10 Marrëveshje Europiane janë në fuqi. Duke qenë se 10 vende që kanë lidhur Marrëveshje Europiane me BE-në janë bërë vende anëtare të BE-së në vitin 2004, respektivisht në vitin 2007 efekti i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve Europiane është bërë më shumë një interes akademik. Gjithsesi, ka çështje të cilat janë shembuj shumë të mirë të efektit të

drejtpërdrejtë të Marrëveshjeve të Stabilizim-Asociimit dhe Marrëveshjeve të Partneritetit dhe të Bashkëpunimit. Ky fakt tregon se çfarë mund të mësojnë vendet kandidatë nga përvojat e mëparshme dhe nga jurisprudenca. Deri në vitin 1999, Gjykata Europiane e Drejtësisë, duhet t’u përgjigjej pyetjeve para përgatitore për gjykatat kombëtare mbi të drejtat e Marrëveshjeve Europiane, pyetje të cilat bëheshin nga qytetarë polakë, çekë, bullgarë, të cilët nuk kishin dijeni për të drejtat e tyre. Çështjet e Gloszczuk-ut, Kondova –s dhe Barkoci-t, iu referuan vendimit të dhënë nga Gjykata e Lartë e Drejtësisë së Anglisë dhe e Wales, ndërsa çështja Jany përdori si referencë vendimin e dhënë nga Gjykata e Holandës. Këto çështje kanë të bëjnë me efektin e drejtpërdrejtë të dispozitave të vendosjes dhe vendimet e Gjykatave u japin të drejtën qytetarëve të vendeve kandidatë të përfitojnë nga dispozitat e Marrëveshjeve Europiane përpara gjykatave të vendeve anëtare të BE-së.

CILAT ISHIN FAKTET?

Në çështjen Gloszczuk, një çift polak hyri në Angli. Në vitin 1989 dhe në vitin 1991 ata morën viza turistike duke paraqitur dokumente false në zyrën e emigracionit për rrethanat e tyre personale dhe qëllimin e vërtetë të qëndrimit të tyre. Pas lindjes së djalit të tyre në vitin 1993 dhe hyrjes në fuqi të Marrëveshjes Europiane ata pretenduan se mund të kishin të drejtën të qëndronin në Angli, sepse z. Gloszczuk kishte qenë kontraktor i vetëpunësuar që nga viti 1995, ndaj kishte të drejtën të vendosej në Angli në mbështetje të nenit 44 të Marrëveshjes Europiane midis Polonisë, Komunitetit European dhe vendeve të tij anëtare.

Barkoc-i dhe Malic-i, qytetarë çek, ishin shtetas anëtarë të Komunitetit Rom, të cilët nuk mund të gjenin punë në Republikën Çeke. Ata erdhën nga Anglia në vitin 1997 dhe aplikuan për azil, por pa sukses. Pas refuzimit të kërkesës për azil, ata vendosën që të përdorin Marrëveshjen Europiane si mbrojtje për të kërkuar punë në Angli, njëri si kopshtar i vetëpunësuar dhe tjetri si ekonomist i “shërbimeve shtëpiake dhe tregtare”. Por autoritetet e

emigracionit nuk ishin të kënaqur me realizimin financiar të planit të biznesit dhe qëllimin e tyre për t'u vetëpunësuar. Kërkesa për hyrje në Angli iu refuzua për herë të dytë.

Çështja Kondova lidhet me një shtetase bullgare, e cila, pasi kishte studiuar në Angli, donte të vetëpunësohej si “ofruese shërbimesh për mirëmbajtjen e shtëpisë”. Ajo hyri në Angli në vitin 1993, përpara hyrjes në fuqi të Marrëveshjes Europiane me Bullgarinë, pasi u pajis me një vizë, të cilën e mori duke falsifikuar dokumentet që dorëzoi në zyrën e emigracionit. Më pas ajo ngriti pretendimin për të fituar statusin e azilit politik, i cili iu refuzua në vitin 1994 nga Zyra Kombëtare e Emigracionit. Pretendimet ligjore që u paraqitën për të kundërshtuar refuzimin e azilit politik nuk u morën parasysh. Më pas znj. Kondova u martua me një shtetas mauritan, i cili kishte të drejtë të qëndronte në Angli për një periudhë ta pakufizuar kohe. Në datën 2 gusht 1995, znj. Kondova aplikoi në Sekretarinë Britanike të Shtetit për leje qëndrimi në Angli, mbështetur në dokumentin e martesës. Që nga koha që znj. Kondova bëri një intervistë duke pranuar se qëllimi saj i vërtetë i mbërritjes në Angli ishte përfitimi i azilit dhe që ajo me vetëdije kishte gënjyer si oficerin, i cili i kishte dhënë vizë në Bullgari, po ashtu dhe zyrën e emigracionit, e cila e kishte marrë në pyetje. Sekretariati i Shtetit mori vendimin që znj. Kondova kishte hyrë në Angli në mënyrë të paligjshme. Në datën 9 nëntor 1995, ajo fitoi “leje të përkohshme” dhe filloi të punojë si pastruese e vetëpunësuar dhe më pas aplikoi për leje qëndrimi në Angli në mbështetje të Marrëveshjes Europiane. Ajo deklaroi se donte të punonte si pastruese në shtëpi dhe bashkëshorti i saj mund ta mbështeste. Ky aplikim i ri iu refuzua nga Sekretariati i Shtetit në datën 24 qershor 1996, duke u bazuar në faktin se përfitimet ekonomike të znj. Kondova nuk ishin të mjaftueshme për të mbajtur dhe strehuar atë. Znj. Kondova u arrestua në 10 Shtator 1996 dhe u mbajt në një rajon policie me qëllimin që ta largonin nga Anglia. U kërkua një interpretim i Marrëveshjes Europiane me Bullgarinë dhe Gjykata e Lartë e Drejtësisë Angleze vendosi të kërkojë vendim parapërgatitor nga Gjykata

Europiane e Drejtësisë, bazuar në interpretimin e nenit 45 të Marrëveshjes Europiane për efektin e drejtpërdrejtë të së drejtës së vendosjes dhe për lidhjen e këtij neni me legjislacionin kombëtar të imigracionit.

Cilat janë rezultatet dhe efektet e vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë?

Gjykata Europiane e Drejtësisë vlerëson se e drejta e vendosjes për shtetasit polakë, çekë dhe bullgarë, në rastet e lartpërmendura përfshin të drejtën e hyrjes dhe të rezidencës dhe se këto të drejta, të cilat mbështeten në dispozitat e mosdiskriminimit të Marrëveshjes Europiane, duhet të zbatohen nga gjykatat kombëtare.

Objektivat e katër çështjeve janë pak a shumë identike: përfitimi i të drejtës së rezidencës për shtetasit e vendeve kandidate bazuar në Marrëveshjen Europiane. Shtetasit e vendeve përkatëse duhet të hyjnë dhe të qëndrojnë në territoret e dy shteteve anëtare të BE-së (Angli dhe Holanda), në mënyrë që të punojnë dhe aty si të vetëpunësuar. Meqenëse ata nuk i kanë këto të drejta të legjitimuara nga legjislacioni kombëtar duhet t'i kërkojnë nga zbatimi i Marrëveshjes Europiane. Marrëveshjet Europiane citojnë:

“Çdo shtet anëtar, nga momenti i hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, duhet të garantojë një trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai i akorduar për kompanitë dhe qytetarët e tij, për sa i përket të drejtës së vendosjes të kompanive dhe të qytetarëve”.

Për të ilustruar sa thamë më lart, po japim një pjesë të shkëputur nga vendimi i Gjykatës Europiane të Drejtësisë për çështjen Kondova:

“Vendimi i Gjykatës i datës 27 shtator 2001 “Për interpretimin e nenit 45 dhe 59 të Marrëveshjes Europiane, e cila përcakton një asociim midis Komuniteteve Europiane dhe vendeve të tyre anëtare nga njëra anë dhe Republikës së Bullgarisë nga ana tjetër, negociuar dhe miratuar nga Komuniteti me vendim 94/908/ECSC, (OJ 1994 L385, f.1), (1a).

GJYKATA

Në përgjigje të pyetjeve të bëra nga Gjykata e Lartë e Drejtësisë dhe e

Wals-it, me vendim të datës 18 dhjetor 1998, vendosi: “Neni 45 i Marrëveshjes Europiane, i cili përcakton një shoqërizim midis Komuniteteve të BE-së dhe vendeve të tyre anëtare nga njëra anë dhe Republikës së Bullgarisë nga ana tjetër, ...duhet të interpretohet ashtu siç citohet në Marrëveshje, brenda qëllimit të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, si një parim i pakushtëzuar dhe i saktë, i cili është mjaftueshëm operativ për t’u zbatuar nga gjykatat kombëtare. Mbështetur në zbatimin e parimit të efektit të drejtpërdrejtë të këtij neni, shtetasit bullgarë kanë të drejtë të ngrenë padi përpara gjykatave të vendeve pritëse të BE-së, pavarësisht faktit se autoritetet e atij shteti zbatojnë ndaj kësaj kategorie qytetarësh, ligjet e vendit të tyre. E drejta e vendosjes, e përcaktuar në nenin 45 të Marrëveshjes së Asociimit, nënkupton se të drejtat e hyrjes dhe rezidencës, të cilat vijnë si rrjedhojë e të drejtës së vendosjes, u janë akorduar qytetarëve bullgarë me qëllim ushtrimin e veprimtarive të karakterit industrial, tregtar, zejtarisë dhe të profesioneve të ndryshme në vendet anëtare të BE-së. Nga zbatimi i nenit 59 të kësaj Marrëveshjeje, rrjedh se të drejtat e hyrjes dhe të rezidencës nuk janë privilegje absolute, në disa rrethana ato mund të kufizohen nga ligjet e vendosura nga vendet anëtare të BE-së. Nenet 45 dhe 59 të Marrëveshjes së Asociimit, të interpretuara së bashku, në parim, nuk parashikojnë një sistem parësor kontrolli për çështjen e dhënies së lejes nga autoritetet kompetente të emigracionit. Gjithashtu, këto nene nuk përcaktojnë kufizim lidhur me kushtin nëse aplikanti duhet të tregojë se ai në mënyrë të sigurtë ka pasur si qëllim të hapë një aktivitet, dhe që në fillim ka pasur shanse për të pasur sukses. Neni 59 i Marrëveshjes së lartpërmendur, duhet të interpretohet në këndvështrimin se autoritetet e vendeve anëtare të BE-së mund të refuzojnë një aplikim, mbështetur në nenin 45 të Marrëveshjes, bazuar në faktin se në momentin që ishte dërguar aplikimi, shtetasi bullgar ishte rezident në mënyrë të paligjshme në vendin anëtar të BE-së, pasi ai kishte bërë deklaratat false kur ishte marrë në pyetje nga këto autoritete. Për rrjedhojë, këto autoritete mund t’i kërkonin qytetarit bullgar të dërgonte një aplikim të ri, mbështetur në zbatimin e Marrëveshjes,

duke aplikuar për një vizë hyrëse, tek autoritetet kompetente në shtetin e tij të origjinës ose në ndonjë shtet tjetër.

Për sa i përket rastit Kondova, aplikimi i znj. Kondova për leje qëndrimi në Angli, u refuzua sepse ajo kishte hyrë në mënyrë ilegale në Angli dhe kishte dhënë deklarata false si te nëpunësi, i cili e kishte pajisur me vizë në Bullgari, ashtu dhe te Zyra e Emigracionit në Angli. Kështu, ajo nuk përmbushi kërkesat për t'u mbrojtur nga Marrëveshja e Asociimit dhe, si rrjedhojë, aplikimi i saj u refuzua.

Si përfundim, nëse qëndroni në mënyrë ilegale në BE, nuk mund të keni të drejtë për të marrë leje qëndrimi. Vetëm nëse shtetasi i vendit kandidat i plotëson të gjitha kushtet, atëherë ai mund të marrë leje qëndrimi.

A mund të konsiderohet prostitucioni si një veprimtari ekonomike për një të vetëpunësuar?

Çështja gjyqësore Jane (5) trajton rastin e 2 prostitutave çeke dhe 4 bullgare, të cilat duke përdorur Marrëveshjen Europiane si bazë ligjore, paraqitën kërkesë për të fituar lejen e përhershme të qëndrimit në Holandë, dhe të punonin si prostituta të vetëpunësuar, në zonën e dritave të kuqe në Amsterdam. Sipas legjislacionit holandez, disa forma të prostitucionit janë të lejuara, si p.sh. prostitucioni në rrugë dhe në dritare. Dy zonjat polake dhe ato katër çeke deklaruan se kishin kërkuar leje të përhershme në Holandë gjatë muajit maj 1993 dhe atij tetor 1996. Të gjitha punojnë si “prostituta në dritare”. Ato e kishin dërguar aplikimin në Zyrën Holandeze. U regjistruan në regjistrin e Dhomës së Tregtisë dhe morën një certifikatë nga zyra e taksave si dhe i kërkuan llogaritarëve ose firmave të auditit të hartonin një llogari financiare për biznesin e tyre. Aplikuan për leje të përhershme qëndrimi si prostituta të vetëpunësuar. Në seancën e parë gjyqësore aplikimet u refuzuan. Gjykata e Hagës gjykoi se shtetasit e vetëpunësuar të vendeve anëtare të BE-së përfitojnë të drejtat e tyre të lëvizjes së lirë brenda tregut të brendshëm nga legjislacioni dytësor i BE-së dhe jo drejtpërsëdrejti nga vetë Traktati. Pas disa apeliemeve ndaj vendimit të dhënë, Gjykata e Hagës,

në datë 1 qershor 1997, vendosi se Sekretari i Shtetit i kishte dhënë leje qëndrimi në Holandë një prostitute italiane, pra ai e njihte prostitucionin si një veprimtari ekonomike. Gjithsesi, kuptimi i prostitucionit në Marrëveshjen Europiane është i ndryshëm nga kuptimi i prostitucionit në Traktatin e Komunitetit Europian. Sekretari i Shtetit vendosi që të mos pranojë të shqyrtojë përsëri aplikimet. Përfundimisht Gjykata e Hagës dërgoi pesë pyetje paraprake në Gjykatën Europiane të Drejtësisë me qëllim interpretimin e Marrëveshjeve Europiane. Gjykata Europiane e Drejtësisë vendosi që t'u njohë këtyre zonjave të drejtën e vendosjes, si dhe të njohë se e drejta e vendosjes siç është përcaktuar në Marrëveshjet përkatëse europiane çeke dhe polake me BE-në është e drejta e hyrjes dhe e qëndrimit të përkohshëm në një shtet të BE-së. Gjykata vendosi që “veprimtaria ekonomike në kuptimin e personit të vetëpunësuar” siç citohet në Marrëveshjet Europiane, ka të njëjtin kuptim me “veprimtari në kuptimin e personit të vetëpunësuar” siç citohet në nenin 52 të Traktatit.

Gjykata vendosi që veprimtaria e prostitucionit si një vetëpunësim, konsiderohet si shërbim që siguron shpërblim dhe për rrjedhojë mund të përdoret në të dyja kuptimet. Prostitucioni është një veprimtari ekonomike që ushtrohet nga një person i vetëpunësuar, siç citohet në dispozitat e mëposhtme:

- Jashtë ndonjë marrëdhënieje varësie, për sa i përket zgjedhjes së atij aktiviteti, kushteve të punës dhe kushteve të shpërblimit.
- Nën përgjegjësinë e vetë personit.
- Kundrejt një shpërblimi ndaj atij personi.

Gjykata Kombëtare dhe Gjykata e Hagës duhet të përcaktojë në secilin rast, mbështetur në prova, nëse janë zbatuar këto kushte.

Autoritetet e Emigracionit dhe ato të Gjykatave Kombëtare duhet të kontrollojnë në çdo rast, nëse zbatohen tri kushtet e çështjes “Jane”. Si mund të kontrollohet në këtë rast që prostituta nuk respekton tri kriteret e përcaktuara nga dispozitat? Si mund ta dimë nëse shërbimet janë paguar në

mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nuk ka përfituar prej tyre tutori? Duke qenë se Marrëveshjet Europiane u japin të drejta për hyrje dhe leje qëndrimi vetëm shtetasve të vetëpunësuar dhe jo punëtorëve të vendeve kandidatë, është shumë e rëndësishme të dallojmë personat e vetëpunësuar, nga ata që janë punësuar në një firmë ose organizatë dhe paguhen nga këto institucione.

LËVIZJA E LIRË E PUNËTORËVE

Marrëveshjet Europiane nuk e trajtojnë lëvizjen e lirë të punëtorëve. Ata vetëm përfitojnë të drejta të njëjta me ato të shtetasve të cilët janë rezidentë të ligjshëm dhe punojnë në një nga vendet anëtare të BE-së. Në çështjen C-162/00, Gjykata vendosi që neni 37 i Marrëveshjes Europiane duhet të zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, në këtë mënyrë shtetasit polakë mund ta përdorin si mbrojtje dhe të ngrenë padi në gjykatat kombëtare të vendeve pritëse anëtare të BE-së. Znj. Pokrzeptowicz-Meyer, një shtetase polake e diplomuar, u transferua në Gjermani, aty ku ajo filloi të jepte mësim si asistente me kohë të pjesshme e gjuhës së huaj në Universitetin e Bielefeldit. Ajo u mbështet në një precedent gjyqësor të dhënë nga Gjykata Europiane në të cilin citohej se paragrafi përkatës i Ligjit për Edukimin e Lartë në Gjermani ishte diskriminues për shtetasit Komunitarë. Gjykata Europiane vendosi që ky ligj kishte, gjithashtu, karakter diskriminues për shtetasit e vendeve kandidatë, prandaj interpretimi i nenit 48 të Traktatit të Komunitetit Europian, që u dha për Çështjen Spotti (çështja -272/92 Spotti (1993) ECR I-5185) duhet të transpozohet në nenin 37 të Marrëveshjes Europiane. Gjykata në këtë rast shtoi se dispozitat e Marrëveshjes Europiane duhet të kenë të njëjtin kuptim si edhe dispozitat e Traktatit të Komunitetit Europian. Përfundimi final është se në Holandë, duke iu referuar çështjes “Jane”, prostitutat e vetëpunësuar nga vendet kandidatë kanë të njëjtat të drejta, si edhe prostitutat që vijnë nga vendet anëtare të BE-së. Gjithsesi autoritetet e emigracionit duhet të kontrollojnë më përpara nëse shtetasit përkatës përmbushin kushtet e Marrëveshjes Europiane në mënyrë që vendet anëtare të BE-së të lëshojnë

leje të përhershme qëndrimi. Ndërsa për lëvizjen e lirë të punëtorëve, sipas interpretimit të Gjykatës Europiane të Drejtësisë të nenit 37 të Marrëveshjes Europiane me Poloninë, duhet të ekzistojë trajtimi i njëjtë për shtetasit që vijnë nga vendet kandidatë, për sa kohë që ata janë të tashmë të punësuar në mënyrë të ligjshme në territorin e një vendi anëtar të BE-së.

C. Efektet e paraanëtarësimit, në rendin ligjor të Komunitetit, të Marrëveshjes së Asociimit BE-Turqi, të Marrëveshjeve së Asociimit dhe të Marrëveshjes së Ndërmjetme.

Efektet ligjore të dispozitave të Marrëveshjes Europiane janë pak a shumë identike me ato të dispozitave të Marrëveshjes së Asociimit me Turqinë dhe me ato të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe BE-së, si p.sh., Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit midis BE-së, vendeve anëtare të saj dhe Shqipërisë. Kështu, (nëse zëvendësojmë shtetasit shqiptarë me ata turq), do të kemi të njëjtat efekte ligjore në rendin ligjor komunitar për këta shtetas. Në praktikë, deri tani, lidhur me Marrëveshjen e Ankarasë, mund të analizojmë vetëm efektet e drejtpërdrejta në rendin ligjor të Komunitetit, duke iu referuar disa precedentëve gjyqësorë të Gjykatës Europiane të Drejtësisë.

MARRËVESHJA E ANKARASË

Marrëveshja e Asociimit midis Turqisë dhe Komunitetit Europian e vitit 1963, e cila hyri në fuqi në datën 1 dhjetor 1964, është baza ligjore për asociim midis Turqisë dhe BE-së. Ka pasur mbi 24 vendime për çështje gjyqësore nga Gjykata Europiane e Drejtësisë dhe një numër çështjesh të shqyrtuara nga gjykata kombëtare të vendeve anëtare, të cilat kanë pasur si objekt shqyrtimi shkeljen e Marrëveshjes së Asociimit, Protokollin Shtesë dhe Vendimet e Asociuara. Gjykata Europiane e Drejtësisë i ka trajtuar vendimet e Këshillit të Asociimit në të njëjtën mënyrë si dhe Marrëveshjen e Asociimit dhe i konsideron këto dokumente si një pjesë integrale të rendit

ligjor të Komunitetit.

Ndryshe nga vendet e tjera candidate, marrëdhëniet institucionale me BE-në u vendosën që në vitin 1963. Në momentin kur Turqia negocionte për Marrëveshje Asociimi me BE-në, ajo ishte një vend perëndimor me një ekonomi tregu. Marrëveshja e Asociimit hyri në fuqi në datën 1 dhjetor 1964. Duke iu referuar nenit 22 të Marrëveshjes së Ankarasë, Këshilli i Asociimit do të miratojë vendimet e nevojshme pasi të kishte kaluar periudha tranzitore. Këshilli i Asociimit BE-Turqi, miratoi vendimin 1/95 për Bashkimin Doganor, i cili trajtonte lëvizjen e lirë të mallrave dhe çështje të tjera që lidhen me to. Ky vendim kishte 66 nene dhe hyri në fuqi në 1 janar të vitit 1995. Vendimet e Këshillit të Asociimit për Bashkimin Doganor do të interpretohen në përputhje me vendimet përkatëse të Gjykatës Europiane të Drejtësisë. Në këtë artikull tregohet se gjyqtarët turq duhet të marrin në konsideratë jurisprudencën e Gjykatës Europiane të Drejtësisë në mënyrë që të interpretojnë dispozitat e Vendimit 1/95 të realizimit të Bashkimit Doganor midis Turqisë dhe Komunitetit European në mallrat industriale dhe bujqësore, vendim i cili u miratua në 6 mars të vitit 1995. Neni 12 i Marrëveshjes së Ankarasë ka një rëndësi të madhe, pasi ai parashikon në mënyrë progresive lirinë e lëvizjes së punëtorëve, siç është parashikuar në Traktat. Ky nen përcakton se objektivat e Marrëveshjes janë guri themeltar për lëvizjen e lirë të punëtorëve. Ndërsa neni 36 i Protokollit Shtesë parashikon një kalendar për periudhën nga 12 deri në 22 vjet për lëvizjen e lirë të punëtorëve. Në çështjen Demirel Gjykata e Drejtësisë vendosi që neni 12 i marrëveshjes së Ankarasë dhe Protokollit Shtesë ishin problematikë dhe jo precizë për të përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë lëvizjen e lirë të punëtorëve. Gjykata nuk ka shqyrtuar pyetje specifike për çështjen e skadimit të afatit për periudhën transitore. Avokati i Përgjithshëm u sugjeroi që data e skadimit të afatit nuk krijon efekt të detyrueshëm. Në Marrëveshjen e Ankarasë mungojnë referenca për të drejtat e ribashkimit familjar. Edhe ky boshllëk u trajtua në çështjen Demirel. Gjykata e Drejtësisë konfirmoi efektin

e drejtpërdrejtë të nenit 7 për këto raste. Në të gjitha këto çështje Gjykata e Drejtësisë, nëpërmjet interpretimit, shpjegoi efektin e drejtpërdrejtë të Marrëveshjes së Ankarasë në rendin ligjor të Komunitetit.

Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit dhe Marrëveshjet e Ndërmjetme.

Nuk ka ndonjë praktikë të Gjykatës Europiane të Drejtësisë lidhur me zbatimin e MSA-së. Nuk mundëm të gjejmë ndonjë çështje në të cilën një shtetas i vendeve që kanë nënshkruar MSA-në është përpjekur të fitojë të drejtat e shkelura në rendin ligjor komunitar, për shembull shumë shtetas polakë, bullgarë, sllovakë, çekë, turq kanë ngritur padi për mosrespektim të MSA-së ose të Marrëveshjeve të Asociimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Shqipëria nënshkroi MSA-në me BE-në në datën 12 qershor 2006, e cila parashikon një kuadër angazhimesh të ndërsjella në spektrin politik, ekonomik dhe tregtar. Kjo Marrëveshje duhet të ratifikohet nga 27 vende anëtare të BE-së përpara hyrjes në fuqi. Deri më tani ajo është ratifikuar nga 18 vende anëtare të BE-së. Pjesët që trajtojnë çështjet tregtare të Marrëveshjes zbatohen nëpërmjet Marrëveshjes së Ndërmjetme për Tregtinë dhe Çështjeve Tregtare midis Komunitetit European nga njëra anë dhe Republikës së Shqipërisë nga ana tjetër. Kjo Marrëveshje ka hyrë në fuqi në datën 1 dhjetor 2006. Partneriteti i rishikuar European është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave 2006/54/EC të datës 30 janar 2006. Megjithatë, ende nuk ka një çështje gjyqësore në gjykatat shqiptare për shkelje të MSA-së ose të Marrëveshjes së Ndërmjetme, mendojmë që herët ose vonë dhe Shqipëria do të ketë precedentët e saj gjyqësorë në këtë fushë. Për këtë nevojitet një kuptim më i mirë i efektit të drejtpërdrejtë të Marrëveshjes së Ndërmjetme. Nëse krahasojmë dispozitat e tregut të brendshëm të Traktatit të Komunitetit European, nënshkruar në Romë më 25 mars 1957, ndryshuar së fundmi nga Traktati i Nicës, me dispozitat e Marrëveshjes së Ndërmjetme të datës 22 maj 2006, e cila hyri në fuqi në datën 1 dhjetor 2006 do

të vërejmë zhvillime të ngjashme ligjore veçanërisht lidhur me dispozitat “standstill”. Për shembull, në nenin 25 dhe 28 të Traktatit të Komunitetit Europian ndalohet vendosja e detyrimeve doganore dhe e kufizimeve sasiore midis vendeve anëtare të BE-së. Ky nen ka efekt të drejtpërdrejtë, ndërsa neni 20 i Marrëveshjes së Ndërmjetme në mënyrë të ngjashme parashikon që, nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, nuk vendosen detyrime të reja doganore për importet ose eksportet ose tarifa të reja me efekt të njëjtë me to dhe nuk rriten ato që zbatohen tashmë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë.

Cili është përfundimi dhe cilat janë pasojat e pritshme ligjore? Neni 20 i Marrëveshjes së Ndërmjetme ka efekt të drejtpërdrejtë dhe çdo person dhe kompani që është e vendosur në Tiranë mund të ngrejë padi në gjykatat kombëtare ndaj pagesave të detyrimeve doganore, nëse qeveria nuk zbaton nenin 20 të Marrëveshjes së Ndërmjetme. Edhe kur Shqipëria është në periudhën e paraanëtarësimit do të gjejë zbatim neni 20 i Marrëveshjes së Ndërmjetme, sepse neni 122, paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë citon: “Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj”. Në këtë bazë ligjore duhet të mbështeten gjykatat kombëtare kur kompanitë shqiptare dhe europiane të vendosura në Tiranë të ngrenë padi lidhur me korrektësinë e zbatimit të detyrimeve doganore ose kufizimeve sasiore.

Rasti i dytë lidhet me diskriminimin fiskal, neni 90 i Traktatit të Komunitetit Europian. “Asnjë shtet anëtar nuk vendos për prodhimet e shteteve të tjera anëtare, drejtpërdrejt ose tërthorazi, asnjë taksë të brendshme, të çfarëdolloj natyre qofshin, më të lartë se ato që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë janë vendosur për prodhimet e tij të brendshme të ngjashme me to”.

Ndërsa neni 91 i këtij Traktati citon: “Prodhimet e eksportuara drejt ndonjërit nga shtetet e tjera anëtare nuk mund të përfitojnë nga asnjë rimbursim i taksave të brendshme që të jetë më i lartë se taksat e brendshme që ka

paguar, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, qoftë të tërthortë”.

Në Marrëveshjen e Ndërmjetme ka nene të ngjashme me nenin 90 dhe 91 të Traktatit të Komunitetit Europian. Kështu, neni 20 i Marrëveshjes së Ndërmjetme (neni 34 i MSA-së) citon:

“1. Palët shmangin marrjen e masave ose shfuqizojnë praktikën me natyrë fiskale të brendshme ose ato ekzistuese që shkaktojnë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi diskriminim ndërmjet produkteve të së njëjtës palë dhe produkteve të ngjashme që e kanë origjinën në territorin e palës tjetër.

2. Produktet e eksportuara në territorin e njëres palë nuk mund të përfitojnë nga rimbursimi për tatimin e tërthortë të brendshëm që kalon shumën e tatimit të tërthortë të vendosur mbi to”.

Gjykata Europiane e Drejtësisë ka pasur një rast interesant për trajtimin e njëjtë fiskal dhe diskriminimin e konjakut dhe të uiskit . Pyetja që lindi ishte nëse këto dy pije ishin të njëjta apo të ngjashme për t’u taksuar. Detyrimi doganor për uiskin ishte më i lartë se ai për Konjakun, i cili mbronte prodhuesit e konjakut në Francë. Gjithsesi mbrojtja e Francës nuk i ndihmoi prodhuesit e konjakut, për shkak të kërkesës që kishte pija e uiskit në treg si pije “snobe”. Uiski u preferua dhe u ble më shumë sesa Konjaku.

Neni 90 i Traktatit të Komunitetit Europian mund të krahasohet me nenin 21 të Marrëveshjes së Ndërmjetme. Ka dy raste të mundshme ku një Gjykatë Shqiptare mund të fillojë procedim për diskriminimin fiskal dhe mos zbatim të nenit 21 të Marrëveshjes së Ndërmjetme. Një rast mund të jetë ai i rakisë dhe tjetri ai i birrës. Duhet të jetë interesante për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të hetojë nëse ligji nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat” është në përputhje me nenin 21 të Marrëveshjes së Ndërmjetme si p.sh. detyrimi doganor për rakinë.

Në Kodin CN 22 08 akciza për rakinë është 80 lekë për litër, ndërsa pijet e tjera alkoolike si grapa kanë akcize të ndryshme 100 lekë për litër. Pra nuk kemi të njëjtin trajtim fiskal për rakinë dhe për grapën. Në datën 6 qershor 2007 në Greqi u mbajt një memorandum për rritjen e akcizave për birrën

greke, kapërcimin e disa limiteve të prodhim-importit. A ka pasur trajtim të njëjtë të birrës shqiptare dhe birrës greke të importuar për sa i përket rritjes së akcizës?

Shembulli i pijeve alkoolike si rakia dhe grapa tregojnë se administrata shqiptare herët ose vonë do të përballet me çështje të tilla gjyqësore, të cilat kërkojnë rregullin para paraprak nga Gjykata Europiane e Drejtësisë, kur p.sh. prodhuesit e grapës do të padisin Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave në një gjykatë italiane dhe do të kërkojnë një vendim paraprak nga Gjykata Europiane e Drejtësisë.

Efektet e paraanëtarësimit për shtetasit shqiptarë nga momenti i hyrjes në fuqi të MSA-së.

Sapo MSA-ja të ratifikohet nga vendet anëtare të BE-së, automatikisht në fuqi, si pasojë, neni 46 i MSA-së, do të zbatohet kapitulli Lëvizja e Lirë e Punëtorëve, i cili parashikon “Në përputhje me kushtet dhe modalitetet e zbatueshme në çdo shtet anëtar:

- Trajtimi i akorduar punonjësve që janë shtetas shqiptarë të punësuar ligjërisht në territorin e një shteti anëtar nuk përmban asnjë formë diskriminimi bazuar në kombësi, për sa u përket kushteve të punës, shpërblimit ose shkarkimit nga puna, krahasuar këto me shtetasit e tij.

- Bashkëshorti/bashkëshortja dhe fëmijët rezidentë të ligjshëm të një punonjësi të punësuar ligjërisht në territorin e një shteti anëtar, me përjashtim të punonjësve sezonalë dhe të punonjësve që i nënshtrohen marrëveshjeve dypalëshe nën përcaktimin e nenit 47, në rast se nuk parashikohet ndryshe nga marrëveshjet e tilla, gëzojnë akses në tregun e punës së shtetit anëtar përkatës gjatë periudhës së qëndrimit të autorizuar për punësim të punonjësit.”

Pra, për të sqaruar shkurtimisht këtë nen, duhet të jeni ligjërisht të punësuar. Ky nen nuk ju jep të drejta të punësoheni legalisht. Por, gjithsesi, do të këtë efekt të rëndësishëm pas hyrjes në fuqi të nenit 46 të MSA-së. Përafërsisht një milion shtetas shqiptarë të punësuar legalisht në vendet

anëtare të BE-së mund të kërkojnë të drejtat e tyre dhe trajtim të njëjtë me shtetasit europianë mbështetur në nenin 46 të MSA-së.

D. Efektet ligjore në rendin ligjor të Komunitetit të Marrëveshjeve të Partneritetit dhe të Bashkëpunimit midis Ruisë, BE-së dhe vendeve anëtare të saj dhe çështjet gjyqësore.

Marrëveshjet e Partneritetit dhe të Bashkëpunimit janë instrumente që lidhin Komunitetin Europian dhe vendet e tij anëtare me vendet e ish-Bashkimit Sovjetik, të ashtuquajtura Vende të Reja të Pavarura. Këto marrëveshje janë nënshkruar nga viti 1994 deri në 1998. Preambula e këtyre Marrëveshjeve qëllimisht lë jashtë fraza të cilat mund të gjenden në Marrëveshjet Europiane, si “Procesi i Integritimit Europian”. Këto marrëveshje janë nënshkruar nga 11 vende, por vetëm 9 prej tyre janë në fuqi. Marrëveshja me Rusinë, e cila është Marrëveshja më gjithëpërfshirëse, hyri në fuqi në vitin 1997. Ne do të fokusohemi në efektet ligjore të kësaj marrëveshjeje.

Në datën 12 prill 2005, Gjykata Europiane e Drejtësisë, për herë të parë në historinë e saj dha një vendim mbi efektin e drejtpërdrejtë të Marrëveshjes së Partneritetit dhe të Bashkëpunimit.

Çështja Simotenko tregoi se Marrëveshja e Partneritetit dhe e Bashkëpunimit BE-Rusi, e nënshkruar në vitin 1994 në Korfuz, nuk ishte thjesht një dokument politik, por një dokument ligjor, i cili përcaktonte të drejta për trajtim të njëjtë të qytetarëve dhe kompanive ruse përpara gjykatave të vendeve anëtare të BE-së. Gjykata Europiane e Drejtësisë në vendim ndoqi të njëjtin arsyetim me opinionin e Avokatit të Përgjithshëm të Gjykatës Europiane të Drejtësisë (shiko periodikun e Delegacionit të Komisionit Europian në Moskë, Europa, nr. 4 prill 2005, faqe 8-11).

CILAT JANË FAKTET E KËSAJ ÇËSHTJEJE?

Igor Simontenko është një shtetas rus i cili ka leje të përhershme qëndrimi në Spanjë. Ai punon si futbollist, ka një kontratë me Klubin Deportivo Tenerife

dhe ka licencën e Shoqatës së Futbollit të Mbretërisë së Spanjës për jashtë Komunitetit European. Në janar të viti 2001 ai aplikoi për konvertimin e licencës nëpërmjet Klubit, mbështetur në Marrëveshjen e Partneritetit dhe të Bashkëpunimit. Aplikimi u refuzua nga Shoqata e Futbollit. Ata përdorën si bazë ligjore për refuzimin e aplikimit nenin 173 të Rregullores së Përgjithshme të Shoqatës së Futbollit të Mbretërisë së Spanjës dhe Marrëveshjen e 28 majit 1999 midis kësaj Shoqate dhe Lidhjes Kombëtare të Futbollit Profesionalist. Simontenkovi apeloj ndaj vendimit të Gjykatës në Gjykatën Sociale të Tenerife-s, duke pretenduar se i kanë shkelur të drejtat e tij dhe se ishte diskriminuar për shkak të kombësisë së tij ruse. Gjykata Sociale vendosi se Simontenkovi-i duhet të ketë trajtim të njëjtë me shtetasit e vendeve anëtare të BE-së për sa i përket kushteve të punës. Por vendimi nuk u finalizua për shkak të konfliktit të juridiksionit. Për këtë arsye Gjykata Qendrore për Apelimin e Procedimeve Administrative dha një vendim negativ lidhur me këtë çështje në datën 22 tetor 2002. Simontenkovi e apeloj vendimin në Gjykatën e Lartë, e cila vendosi të marrë opinion nga Gjykata Europiane e Drejtësisë mbi këtë çështje.

“Aplikimi i një federate sportive për një futbollist profesionist rus, i cili është punësuar nga një klub spanjoll, bie në kundërshtim me nenin 23 të Marrëveshjes së Partneritetit dhe Bashkëpunimit midis Komunitetit European nga njëra anë dhe Rosisë nga ana tjetër.”

Sipas kazusit, një nen i Marrëveshje midis Komunitetit dhe një vendi jo anëtar është drejtpërdrejt i zbatueshëm, kur neni përmban një objektiv të qartë dhe preciz, i cili nuk është subjekt në interpretimin e tij ose sjell si pasojë miratimin e ndonjë mase tjetër.

Interesant është fakti se opinioni i Avokatit të Përgjithshëm nuk i referohet precedentit të mëparshëm gjyqësor në Spanjë, vendimit të Gjykatës nr. 15, datë 23 Nëntor 2000, ku z. Karpin, një futbollist tjetër rus, i cili luante për Celta Vigo-n, fitoi një çështje ndaj Shoqatës së Futbollit të Spanjës, duke pasur si bazë ligjore nenin 23 të Marrëveshjes së Partneritetit dhe

Bashkëpunimit dhe, në këtë rast, nuk iu bënë pyetje Gjykatës Europiane të Drejtësisë. Në çështjen Simotenzov ishte hera e parë që Avokati i Përgjithshëm i Gjykatës Europiane të Drejtësisë dha një opinion mbi interpretimin e Marrëveshjes së Partneritetit dhe Bashkëpunimit midis Rusisë dhe BE-së. Përfundimi i analizimit të nenit 23 të kësaj Marrëveshjeje, ishte që versioni origjinal anglisht dhe shumica e versioneve të tekstit të përkthyer, duke përfshirë dhe versionin në gjuhën ruse, si dhe qëllimi i palëve negociuese, tregojnë një detyrim të qartë të Komunitetit dhe të vendeve anëtare për zbatimin e efektit të drejtpërdrejtë. Deri më tani, efekt të drejtpërdrejtë Gjykata Europiane e Drejtësisë ka njohur në çështjet që lidhen më shkelje të neneve të Marrëveshjeve Europiane midis Komunitetit Europian dhe vendeve candidate.

Gjithsesi, në këtë çështje Gjykata Europiane e Drejtësisë analizoi për herë të parë efektin e drejtpërdrejtë të Marrëveshjeve të Partneritetit dhe të Bashkëpunimit dhe në vendimin e saj nr. 28 dhe 29 u shpreh: “Fakti që Marrëveshja është e kufizuar për të përcaktuar një partneritet midis palëve, pa marrë masa për një anëtarësim të ardhshëm të Federatës Ruse në Bashkimin Europian, nuk nënkupton moszbatimin e efektit të drejtpërdrejtë për disa nene. Nga shqyrtimi i çështjeve gjyqësore del se kur Marrëveshja përcakton bashkëpunim midis palëve, disa nga dispozitat e Marrëveshjes mund, nën kushtet e përcaktuara në paragrafin 21 të gjykimit aktual, të përcaktojnë qëndrimin ligjor të individëve...”

Në dritën e këtyre fakteve, mund të themi se neni 23 (1) i Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe Partneritetit midis BE-së dhe Rusisë ka efekt të drejtpërdrejtë dhe, si rezultat, individët që pretendojnë se u është mohuar e drejta që u jep ky nen, mund të ngrenë padi në gjykatat e vendeve Anëtare të BE-së.

Më pas Gjykata Europiane e Drejtësisë analizoi parimin e mosdiskriminimit, i parashikuar në nenin 23 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe Partneritetit midis BE-së dhe Rusisë. Ajo doli në përfundimin se neni 23

(1) parashikon në mënyrë të qartë, të saktë dhe të pakushtëzuar ndalimin e diskriminimit mbi baza të kombësisë, duke hedhur në këtë mënyrë poshtë vendimin e Shoqatës së Futbollit ndaj shtetasit rus me profesion futbollin, i cili luante në një nga skuadrat e futbollit në Spanjë.

Për mendimin tim, pasojat ligjore të vendimit të Gjykatës Europiane të Drejtësisë prekin jo vetëm futbollistin rus, por edhe shtetasit e tjerë rusë dhe kompanitë ruse. Ka shumë nene të tjera në Marrëveshjen e Bashkëpunimit dhe Partneritetit midis BE-së dhe Ruisë që mund të kenë efekt të drejtpërdrejtë, kështu mund të presim të kemi plot çështje gjyqësore në të cilat shtetasit rusë të kërkojnë të vendosin të drejtat e tyre për një trajtim të njëjtë përpara gjykatave të vendeve anëtare të BE-së për çështjet e mëposhtme: kushtet e punës (neni 23), vendosja (neni 28), sigurimi i shërbimeve ndërkufitare (neni 36), lëvizja e kapitalit (neni 52 (5)).

Pjesa II. Efektet ligjore në rendin ligjor kombëtar të vendeve jo anëtare

A. Efektet ligjore të Marrëveshjeve Europiane dhe çështje gjyqësore në rendin e brendshëm ligjor gjatë periudhës së paraanëtarësimit

Është e mundur që shtetasit europianë dhe shtetasit e vendeve kandidate, gjatë periudhës së paraanëtarësimit, të ngrenë padi në gjykatat e vendeve kandidate, nëse iu është mohuar e drejta e vetëpunësimit?

Përgjigja, nëse Marrëveshjet Europiane kanë efekt të drejtpërdrejtë në rendin ligjor të vendeve kandidate, duhet të jepet nga interpretimi që sistemi gjyqësor u bën neneve kushtetuese kombëtare të ndërsjella, veçanërisht atyre neneve që kanë të bëjnë me marrëdhënien midis së drejtës ndërkombëtare dhe legjislacionit të brendshëm, për sa kohë që këto vende nuk janë pjesë integrale e rendit ligjor Komunitar. Për të dhënë efektin identik të drejtpërdrejtë dhe për të pasur mbrojtje identike ligjore nga Marrëveshja Europiane, rendet e brendshme ligjore të vendeve kandidate është i nevojshëm përafrimi i legjislacionit dhe miratimi i dispozitave kushtetuese të legjislacionit të këtyre

vendeve, si dhe interpretimi identik i legjislacionit kombëtar kushtetues. Më poshtë do të përqendrohemi në efektin ligjor të Marrëveshjes Europiane në rendin e brendshëm ligjor të Polonisë, Bullgarisë, Serbisë, Malit të Zi, Sllovakisë, Sllovenisë dhe Rumanisë. (6)

Do të përqendrohemi në dispozitat kushtetuese që trajtojnë këto efekte të mundshme dhe çështje të gjykatave kombëtare.

a) Polonia

Marrëveshja Europiane midis Polonisë dhe Komunitetit Europian dhe vendeve të tij anëtare u nënshkrua në datën 16 dhjetor 1991 dhe hyri në fuqi në datën 1 shkurt 1994 (7)

NENET KUSHTETUESE

Neni 9 i Kushtetutës Polake i vitit 1997 citon: “Republika e Polonisë do të respektojë dispozitat e së drejtës ndërkombëtare “, dhe nenet 87 dhe 91 jepin përkufizimin e statusit të marrëdhënieve ndërkombëtare me Poloninë dhe rendin ligjor polak (8).

Neni 87 (1)

Burimet e së drejtës universale të detyrueshme të Republikës së Polonisë janë: Kushtetuta, statutet, marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare dhe rregulloret.

Kjo listë është dhe hierarkia e burimeve ligjore.

Neni 90 i Kushtetutës parashikon kuadrin ligjor për anëtarësim:

“Republika e Polonisë, duke u mbështetur në marrëveshjet ndërkombëtare, i delegon një organizate ndërkombëtare ose institucioni ndërkombëtar kompetencën e organit të autoritetit shtetëror lidhur me çështje të caktuara...

Çështja e dytë kushtetuese lidhet me anëtarësimin në BE, mbështetur në nenin 91 (1) dhe nenin 91 (3).

Neni 91

3. Pas shpalljes në Fletoren Zyrtare të Republikës së Polonisë (Dziennik

Ustaw), një marrëveshje e ratifikuar ndërkombëtare do të jetë pjesë e rendit të brendshëm ligjor dhe do të zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rastit kur zbatimi i saj varet nga miratimi i një statuti.

4. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar nga Parlamenti dhe e miratuar me statut ka precedencë në raport me statutet, nëse një marrëveshje e tillë ka papajtueshmëri me dispozitat e këtij statuti.

5. Nëse një marrëveshje e ratifikuar nga Republika e Polonisë përcakton ngritjen e një organizate ndërkombëtare, ligjet e përcaktuara nga kjo marrëveshje do të jenë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kanë precedencë në raste të konfliktit midis ligjeve.

Efekti i marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara përpara hyrjes në fuqi të Kushtetutës adresohet në nenin 241, (1):

“Marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara më parë nga Republika e Polonisë sipas dispozitave kushtetuese që ishin në fuqi në atë kohë për ratifikimin dhe dekretimin e marrëveshjeve në Fletoren Zyrtare, do të konsiderohen si marrëveshje të ratifikuara me miratim paraprak të statutit dhe do të jenë subjekt i neneve 91 të Kushtetutës, nëse lidhja e tyre me kategoritë e çështjeve të përmendura në nenin 89 (1) të Kushtetutës rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare.”

Neni 89 (1) i Kushtetutës parashikon:

Ratifikimi i një marrëveshje ndërkombëtare nga Republika e Polonisë, si dhe mospjesëmarrja në këto marrëveshje, kërkon miratimin paraprak me statut nëse këto marrëveshje kanë të bëjnë me çështje:

1. Të paqes, aleancave, traktateve politike ose ushtarake.
2. Të lirisë, e drejta ose detyrimi i qytetarëve siç është specifikuar në Kushtetutë.
3. Të anëtarësismit të Republikës së Polonisë në organizatat ndërkombëtare.
4. Të përgjegjësisive të konsiderueshme financiare të ngarkuara nga shteti.
5. Të çështjeve që rregullohen me statut ose ato për të cilat Kushtetuta

kërkon miratimin me statut.

GJYKATAT POLAKE DHE ZBATIMI I DREJTPËRDREJTË I MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE

Gjykata e Lartë Administrative në vendimin për çështjen SA/Po 3057/98 dha opinionin e saj për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Gjykata vendosi që fakti, që një marrëveshje ndërkombëtare është e detyrueshme nga pikëpamja e së drejtës ndërkombëtare publike nuk mjafton për zbatimin e kësaj marrëveshje nga një gjykatë polake. Neni 91 i Kushtetutës përcakton kushtet për zbatimin e drejtpërdrejtë të marrëdhënieve ndërkombëtare, një ndër të cilat është dhe publikimi i marrëveshjeve në Fletoren Zyrtare të Republikës Polake. Gjykata e Lartë Administrative në vendimin e saj u shpreh pro zbatimit të detyrueshëm të marrëveshjeve ndërkombëtare në çështjen SA/Po 305/98. Sipas këtij vendimi, edhe pse e drejta ndërkombëtare publike përcakton se marrëveshjet ndërkombëtare janë të detyrueshme, kjo nuk është marrë parasysh nga gjykata polake. Nga këndvështrimi i të drejtës publike ndërkombëtare një marrëveshjeje ndërkombëtare hyn në fuqi në kohën që është përcaktuar në këtë marrëveshje. Gjithsesi publikimi në Fletoren Zyrtare i një marrëveshje ndërkombëtare është vendimtar për zbatimin e kësaj marrëveshje si pjesë e legjislacionit polak. Marrëveshja Europiane është një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me statut, që trajton çështje që janë të përcaktuara në nenin 89 (1). Për pasojë do të jetë pjesë e rendit të brendshme ligjor dhe do të jetë drejtpërdrejt e zbatueshme.

Pas anëtarësimit në BE, gjyqtarët polakë duhet të zbatojnë të drejtën Komunitare, kështu Polonia do të jetë pjesë e rendit ligjor Komunitar. Nëse nuk ka përkthim polak për tekstin përkatës Komunitar, atëherë duhet t'i referohen teksteve angleze, franceze ose gjermane .

ÇËSHTJE GJYQËSORE KUSHTETUESE

Çështje mbi diskriminimin e grave

Çështja K.15/97

Gjykata Kushtetuese fillimisht adresoi pyetje për zbatimin e Marrëveshjes Europiane duke iu referuar Kushtetutës së vjetër në gjykimin që dha për çështjen K.15/97, të datës 29 shtator 1997. Në këtë çështje Avokati i Popullit ndryshoi kushtetutshmërinë e nenit 44 (2) (1) të dispozitave të Aktit të Shërbimit Publik lidhur me moshën e daljes në pension për nëpunësit civilë.

Kjo dispozitë e bëri daljen në pension të detyrueshme për ata nëpunës civilë që arrinin moshën e pensionit. Moshja e daljes në pension ishte e përcaktuar në nenin 24 (1) me Aktin e Daljes në Pension dhe Pagesat për Paaftësi në Punë nga Fondi i Sigurimeve Sociale dhe ishte 65 vjeç për burrat dhe 60 vjeç për gratë. Avokati i Popullit argumentoi se kjo dispozitë nuk mund jetë në përputhje me nenet 67 (2) dhe 78 (1) të dispozitave kushtetuese të vitit 1952, të cilat mbetën në fuqi sipas nenit 77 të Aktit Kushtetues të vitit 1992. Gjithashtu, ky institucion pretendonte se dispozita e debatuar nuk ishte në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Europiane të Drejtësisë (zbatimi i nenit 141 të Traktatit të Komunitetit Europian për trajtim të njëjtë midis burrit dhe gruas) dhe me nenin 5 të Direktivës 207/76/EEC, i cili u miratua në zbatim të këtij neni për të siguruar efektivitet në zbatimin e parimit të trajtimit të njëjtë midis burrit dhe gruas. Një moshë e ndryshme e daljes në pension për burrat dhe gratë është diskriminim mbi baza seksi dhe nuk është në përputhje me Direktivën. Gjykata Kushtetuese vlerësoi legjislacionin Komunitar dhe precedentët gjyqësorë të Gjykatës Europiane të Drejtësisë, por gjithsesi kjo bazë ligjore nuk ishte e detyrueshme për Poloninë. Ky institucion vendosi që nenet 66 dhe 68 të Marrëveshjes Europiane e vënë Poloninë përpara detyrimit “Përppjekje maksimale për të bërë të mundur që legjislacioni i ardhshëm të jetë në përputhje me legjislacionin Komunitar”. Gjykata Kushtetuese vendosi që ky detyrim përcakton që gjykatat polake janë të detyruara të bëjnë interpretimin e ligjit aktual, si dhe të përafrojnë atë sa më shumë me legjislacionin Komunitar.

Çështja K.27/99

Gjykata Kushtetuese adresoi pyetjet e zbatimit të Marrëveshjes Europiane në funksion të zbatimit të Kushtetutës së vitit 1997 për çështjen K.27/99, të datës 28 mars 2000. Në këtë rast Avokati i Popullit ndryshoi kushtetutshmërinë e nenit 23 (1) (4) të Kartës së Mësuesit, nene që lidhen me moshën e daljes në pension të mësuesit. Neni i diskutuar ishte i detyrueshëm për një mësues, kur mësuesi ose mësuesja kishte arritur moshën e pensionit. Moshja e pensionit ishte e përcaktuar në nenin 24 (1) të Aktit të Daljes në Pension dhe Pagesat për Paaftësi në Punë, 65 vjeç për burrat dhe 60 vjeç për gratë. Avokati i Popullit arsyetoi që neni i Kartës së Mësuesit nuk ishte në përputhje me nenet 32 dhe 33 të Kushtetutës dhe me detyrimet ndërkombëtare, p.sh. neni 1 i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave dhe nenet 68 dhe 66 të Marrëveshjes Europiane. Avokati i Popullit pretendoi se sipas këtyre dispozitave Polonia duhet të përafrojë legjislacionin me standardet e Komunitetit Europian. Një ndër standardet më të rëndësishme ligjore është pagesa e njëjtë për gratë dhe burrat 207/76/EEC dhe precedentët gjyqësorë. Nga këto gjykime mund të dalim në përfundimin se pozicioni për të interpretuar Marrëveshjen Europiane dhe legjislacionin Komunitar nuk ka ndryshuar me Kushtetutën e viti 1997. Gjykata Kushtetuese mbështeti pozicionin që kishte mbajtur në rastet e mëparshme K.15/99 dhe K.35/99 (lidhur me diskriminimin e gruas për moshën e daljes në pension).

ÇËSHTJA E PAVARËSISË SË BANKËS KOMBËTARE TË POLONISË.

Çështja K.25/99

Kjo çështje lidhet me kushtetutshmërinë e neneve të Aktit të Bankës Kombëtare të Polonisë. Presidenti i Bankës Kombëtare, për të mbështetur pozicionin që nenet e diskutuara nuk ishin në përputhje me Kushtetutën, arsyetoi se këto nene që lidhen me pavarësinë e Bankës Qendrore duhet të interpretohen në kontekstin e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e

Ndërmjetme. Sipas nenit 83 të kësaj Marrëveshjeje, palët kanë rënë dakord për të bashkëpunuar për miratimin e rregullave të përbashkëta dhe standardeve për mbajtje llogarish, për mbikëqyrje, për sistemin rregullues të bankave dhe për sektorin financiar. Sipas nenit 84 palët kanë rënë dakord për të bashkëpunuar në fushën e politikës monetare dhe Polonia do të bëjë një përafrim gradual të politikave të saj me ato të Sistemit Europian Monetar. Standardet europiane në këtë fushë, pavarësia e Bankës Qendrore është e përcaktuar në nenin 107 dhe 108 të Traktatit të Komunitetit Europian. Prandaj duke pasur parasysh që kjo Marrëveshje ka si qëllim që Polonia të bëhet vend anëtar i BE-së, duhet që kjo e fundit të sigurojë që Banka Kombëtare e Polonisë të jetë e pavarur dhe të plotësojë detyrimet e një banke qendrore europiane sipas normave të përcaktuara nga Traktati i Komunitetit Europian.

Fatkeqësisht, Gjykata Kushtetuese nuk i mori në konsideratë këto argumente në gjykimin që dha për interpretimin e Kushtetutës së vitit 1997 për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit.

ÇËSHTJE TË SË DREJTËS KRAHASUESE

Çështja XVII Amr 65/96

Kjo çështje lidhet me refuzimin e furnizimit me bileta të transportit publik nga një gazetashitës. Zyra e Antimonopolit hetoi mbi këtë rast dhe dha një vendim që refuzimi i furnizimit me bileta përbënte një pozitë zotëruese. Vendimi u apelua në Gjykatën e Antimonopolit, e cila e anuloi këtë vendim për shkak të shkeljes së procedurave. Gjykata vendosi që çështja në fjalë duhet të vlerësohet në bazë të nenit 6 të Aktit të Antimonopolit, duke ndaluar marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ndalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës. Për më tepër Gjykata u shpreh se duke marrë në konsideratë nenet e Marrëveshjes Europiane, interpretimi i këtij neni do të përafrojë legjislacionin polak me të drejtën e krahasuar polake. Gjykata iu referua nenit 85 (3) të Traktatit të Komunitetit Europian dhe rregulloreve të Komunitetit Europian që trajtonin të njëjtin objekt. Gjykata u shpreh se duke

qenë se nuk ka nene specifike në sistemin ligjor polak për të rregulluar këtë çështje, nuk ka arsye pse e drejta e konkurrencës së Komunitetit Europian të mos merret në konsideratë për të mbushur këtë zbrazësi.

Çështja VII Ama 39/97

Në këtë çështje u shqyrtua një apelim i vendimit të Zyrës së Antimonopolit, i cili ndalonte bashkimin e një kompanie polake që publikon libra me një kompani holandeze, e cila publikonte periodikë mbi bujqësinë. Zyra e Antimonopolit ndaloi bashkimin mbi bazën që kompania holandeze, duke qenë një kompani me rëndësi ndërkombëtare dhe me kapacitet të madh investues, mundet që, pasi të bashkohej me kompaninë polake, të mbizotëronte në tregun polak. Gjykata e Antimonopolit vendosi që në mbështetje të nenit 11 a (4) (1) i Aktit të Antimonopolit, një bashkim mund të ndalohet nëse si rezultat i këtij bashkimi do të kemi një pozitë zotëruese në treg. Gjykata u shpreh se një ndërmarrje ka një pozitë zotëruese në treg nëse ajo mund të veprojë në mënyrë të pavarur nga konkurrentët e saj. Gjykata vendosi që nuk mund të parashikojë nëse një situatë e tillë mund të ndodhë në të vërtetë. Ajo u shpreh se kjo situatë duhet të vlerësohet nga nëninterpretimi i nenit 1, 7 dhe 65 të Marrëveshjes Europiane. Gjykata u shpreh se duke u përpjekur të kufizojë hyrjen e investitorëve Komunitarë në tregun polak nuk mund të kontribuojë në realizimin e objektivit të parashikuar në nenet e Marrëveshjes Europiane.

Çështja SN NI CKN 1217/98

Kjo çështje lidhet me zbatimin e të drejtës së konkurrencës në veprimtarinë e një zyre avokatie polake. Zyra pretendonte se avokatët nuk ishin të përfshirë në veprimtari ekonomike dhe që ata nuk kishin bërë marrëveshje për qëllime konkurrence. Gjykata e Lartë në vendimin që dha, u bazua në qëllimin ekonomik të Marrëveshjes Europiane, duke përfshirë edhe veprimtaritë si profesione. Gjykata e Lartë u mbështet edhe në Direktivën e Këshillit 77/249/EEC, të datës 22 mars 1977, për lehtësimin e ushtrimit efektiv të lirisë, për të siguruar shërbime nga avokatët në dhënien e përfundimit që avokatët

individualë duhet të marrin në konsideratë marrëveshjet në përputhje me të drejtën e konkurrencës. Gjykata, gjithashtu, vendosi që nenet 68 dhe 69 të Marrëveshjes Europiane detyrojnë Poloninë të përafrojë legjislacionin e brendshëm me atë të Komunitetit edhe në fushën e konkurrencës. Kjo Gjykata vendosi që ky detyrim duhet të përmbushet me miratimin e ligjeve të reja të harmonizuara, të cilat janë miratuar nga Parlamenti ose duke zbatuar legjislacionin aktual në përputhje me atë Komunitar. Gjykata theksoi në vendimin e saj se nga Marrëveshja Europiane mund të dilet në përfundimin se interpretimi i rregullimit polak të një profesioni si ai i juristit dhe e drejta e konkurrencës duhet të kenë si qëllim përafrimin e tyre me atë të legjislacionit Komunitar.

ÇËSHTJE MBI DETYRIMET DOGANORE

Çështja NSA i SA/Ld 777/97

Gjykata e Lartë Administrative zbatoi drejtpërsëdrejti nenin 27 të Protokollit 4 të Marrëveshjes Europiane. Në vendimin e saj Gjykata deklaroi se, sipas dispozitave të këtij neni nocioni i “produkteve me origjinë Komunitare” duhet të interpretohet si i tillë kur është bërë verifikimi i certifikatave të origjinës, të cilat janë të detyrueshme për Zyrën e Doganave për vendet importuese.

Çështja i SA/Po 3057/98.

Në këtë rast Gjykata e Lartë Administrative refuzoi të zbatojë nenet e ndryshuara të Protokollit 4 të Marrëveshjes Europiane. Nenet e ndryshuara hynë në fuqi në kohën kur u vlerësua kjo situatë. Pra, këto nene nuk ishin të publikuara në Fletoren Zyrtare të Republikës së Polonisë, procedurë e cila sipas Gjykatës ishte vendimtare për fillimin e efekteve të Marrëveshjes në rendin ligjor polak.

Çështja NSA v sa 1135/00

Ky rast lidhet me pyetjen nëse një kompani Komunitare, duke zbatuar nenin 253 (3) (2) të Kodit Doganor mund të emërojë një përfaqësues në marrëveshjet që lidh ajo me autoritetet doganore, në mënyrë që ai të

përmbushë veprime dhe formalitete të parashikuara nga deklaratat doganore, veçanërisht nëse një kompani Komunitare mund të emërojë një përfaqësues për lëshimin e deklaratave doganore. Sipas vendimit të Zyrës së Përgjithshme të Doganave kjo kërkesë nuk ishte e mundur, pasi, sipas nenit 66 (3) të Kodit Doganor, vetëm kompanitë polake kanë të drejtën të lëshojnë deklarata doganore. Për më tepër, Zyra e Përgjithshme e Doganave ishte e mendimit se nëse një kompani Komunitare nuk mund të ushtrojë të drejtat e saj, ajo nuk mund t'ia delegojë këtë të drejtë një kompanie polake përfaqësuese të saj në Poloni. Kjo zyrë në vendimin që dha argumentoi se të njëjtat parime janë të përcaktuara dhe në nenin 64 të Rregullores së Këshillit nr. 2913/12 të datës 12 tetor 1992, që përcakton miratimin e Kodit Doganor të Komunitetit. Gjykata e Lartë Administrative nuk e mbështeti këtë qëndrim të Zyrës së Përgjithshme të Doganave. Ajo vendosi që neni 252 dhe neni 66 të Kodit Doganor Polak pasqyrojnë përkatësisht nenin 5 dhe nenin 64 të Rregullores së Komunitetit. Ndërsa neni 64 i Kodit Doganor të Komunitetit nuk mund të interpretohet si kufizim për personat, deleguar për të lëshuar deklarata doganore. Gjykata u mbështet në nenin 7 të Marrëveshjes Europiane, për të dhënë vendimin e saj sipas së cilës Polonia dhe Komuniteti kishin vendosur një fushë të tregtisë së lirë. Gjykata vendosi që as Kodi Doganor dhe as Marrëveshjet Ndërkombëtare të ratifikuara nga Polonia, nuk mund të kufizojnë Komunitetin të ndërmarrë veprime për të emëruar përfaqësues të tij me qëllim negocimin me autoritetet doganore për të vepruar dhe për të kryer formalitete, veprime këto që janë të përcaktuara nga rregullat doganore.

Do të referojmë dhe një rast tjetër që lidhet me zbatimin e Marrëveshjes Europiane. Ai ka të bëjë me vendimin e Gjykatës së Lartë Polake të datës 27 prill 1995, në të cilin kjo Gjykatë iu referua Marrëveshjes Europiane. Fillimisht Gjykata diskutoi kushtet, të cilat duhet të realizoheshin nga një i huaj në mënyrë që të merrte lejen për të praktikuar mjekësinë në Poloni. Nëse ai donte të praktikonte profesionin e mjekut, duhej të vlerësonte diplomën sipas ligjeve në fuqi të vendit ku ai donte të ushtronte profesionin. Ndërkohë Polonia ishte bërë

anëtare në disa konventa për njohjen e diplomave. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë iu referua Marrëveshjes së Asociimit të nënshkruar nga Polonia nga njëra anë dhe Komunitetet nga ana tjetër bashkë me vendet anëtare, në datën 16 Dhjetor 1991, e cila kishte hyrë në fuqi në datën 1 janar 1994.

Pas analizës së kësaj Marrëveshjeje, Gjykata e Lartë vendosi: Nëse një shtet pranon faktin që të huajt të ushtrojnë profesionin e mjekësisë në Poloni në të gjitha format që janë të njëjta për qytetarët polakë, kjo nuk do të thotë që ata duhet të trajtohen njëllor me doktorët polakë. Për pasojë, të gjitha kufizimet që ekzistojnë në ligjin polak lidhur me ushtrimin e profesionit të doktorit në Poloni, nga mjekë që vijnë nga vendet anëtare të BE-së, nuk mund të ngrenë padi në gjykatat polake. Ky përfundim del si rezultat i faktit që parimi i trajtimit të njëjtë si parim themelor i Marrëveshjes Europiane nuk mund të zbatohet në fushën e lëvizjes së lirë të punëtorëve.

PËRFUNDIM

Nga çështja e lartpërmendur mund të dalim në përfundimin se gjykatat polake janë shumë të predispozura për të zbatuar Marrëveshjen Europiane në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe për të njohur epërsinë e neneve të saj ndaj legjislacionit të brendshëm. Kjo procedurë është ndjekur nga Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë, Gjykata Administrative dhe Gjykata e Antimonopolit. Sipas nenit 91 të Kushtetutës Polake, Marrëveshja Europiane është pjesë e rendit të brendshëm ligjor polak dhe gjykatat polake duhet t'i referohen kësaj Marrëveshjeje edhe pse disa nga këto nene nuk kanë efekt të drejtpërdrejtë, ashtu si kanë për vendet anëtare të BE-së. Nenet 66 dhe 68 të Marrëveshjes Europiane parashikojnë se “duhet të bëhen përpjekje maksimale për të siguruar që legjislacioni i ardhshëm të jetë në përputhje me legjislacionin Komunitar”. Në parim, gjykatat polake në arsyetimin e vendimit citonin nenin e Marrëveshjes Europiane dhe objektivat e tij në mënyrë që të interpretonin legjislacionin polak nën dritën e këtyre dispozitave, përveç atyre në fushën taksimit.

b) Bullgaria

Objektivi kryesor i Marrëveshjes Europiane midis Komunitetit European, vendeve të tij anëtare dhe Bullgarisë, e nënshkruar më 8 mars të vitit 1993, ishte të vendoste bashkëpunim ndërmjet Komunitetit dhe Bullgarisë për të lehtësuar anëtarësimin e Bullgarisë në BE. Marrëveshja Europiane hyri në fuqi në 1 shkurt të vitit 2005. (8) Marrëveshja e Asociimit me Bullgarinë u ratifikua nga Parlamenti Bullgar dhe vendimet e Këshillit të Asociimit u zbatuan në të njëjtën mënyrë nga Gjykata, ashtu si dhe nenet e marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara midis Bullgarisë dhe vendeve të ndryshme. Gjykata e Lartë Administrative në vendimin e saj nr. 3420 të datës 9 prill 2002 u shpreh se vendimi që ishte dhënë, sipas padisë që ngriti Këshilli i Asociimit u bë pjesë e legjislacionit bullgar.

Për shkak të mungesës së kuadrit kushtetues, legjislacioni i BE-së nuk mund të ketë epërsi dhe efekt të drejtpërdrejtë për Bullgarinë. Gjithsesi, ka mënyra që legjislacioni i BE-së ndikon në praktikën ligjore. Së pari, legjislacioni i BE-së shërben si udhëzues për zbatimin dhe interpretimin e neneve të përafuara. Së dyti, legjislacioni i BE-së mund të zbatohet nëpërmjet vendimeve të Këshillit të Stabilizim-Asociimit.

Gjykata Administrative e Lartë e përdor legjislacionin Komunitar si udhëzues në interpretimin e neneve të përafuara të legjislacionit. Ky afrim konsiderohet si një përputhje me nenet 69 dhe 70 të Marrëveshjes së Asociimit dhe përcakton një detyrim për të përafuar si legjislacionin dhe praktikën administrative ndaj konkurrencës së padrejtë.

c) Republika Sllovaqe

Marrëveshja Europiane midis Komunitetit European dhe vendeve të tij anëtare dhe Sllovakisë u nënshkrua në vitin 1993 dhe hyri në fuqi në 1 shkurt të vitit 1995, por nuk u dekretua deri në vitin 1997. Për shkak të periudhës së shkurtër, në të cilën ajo u zbatua, dihet pak për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje nga gjykatat polake për çështjet civile, administrative ose kriminale. Asnjë

rast nuk njihet në Republikën Polake për zbatimin e Marrëveshjes Europiane. Janë miratuar vetëm disa vendime të Këshillit të Asociimit. Gjykatat Sllovaqe mbështetur në nenin 144, pjesa I e Kushtetutës duhet të njohë të gjitha nenet e Traktatit të Anëtarësimit dhe Themelimit të Traktateve. Epërsia e këtyre Traktateve nënkupton që ata kanë precedencë në zbatimin e rregullave legjislative, por jo se ata kanë pozicion më të lartë në hierarki sesa Kushtetuta.

Neni 7

(1) Republika Sllovaqe mund të hyjë në një bashkim shtetesh. Një ligj kushtetues, i cili më pas do të miratohet me referendum, do të vendosë për hyrjen në një bashkim shtetesh.

(2) Republika Sllovaqe mund, nëpërmjet një traktati ndërkombëtar, i cili është ratifikuar dhe dekretuar sipas mënyrës së parashikuar nga ligji, të transferojë një pjesë të ushtrimit të pushtetit të Komunitetet Europiane dhe Bashkimi European. Aktet e detyrueshme ligjore të Komuniteteve Europiane dhe të Bashkimit European do të kenë përparësi ndaj legjislacionit të Republikës Sllovaqe. Transpozimi i akteve ligjore, i cili kërkon zbatim të tij do të realizohet nëpërmjet një ligji ose një rregulloreje të Qeverisë, mbështetur në nenin 120, paragrafi 2.

(3) Republika Sllovaqe për të ruajtur paqen, sigurinë dhe rendin demokratik, sipas kushteve të përcaktuara në traktatet ndërkombëtare, mund të bëhet pjesë e një organizate të sigurisë së ndërsjellë kolektive.

(4) Vlefshmëria e marrëveshjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, traktatet politike ndërkombëtare, traktatet ndërkombëtare me karakter ushtarak, traktatet ndërkombëtare, traktatet ekonomike ndërkombëtare të një karakteri të përgjithshëm, marrëveshjet ndërkombëtare, për të cilat nevojitet miratimi me ligj dhe marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat drejtpërdrejt akordojnë të drejta dhe vendosin detyrime mbi personat fizikë ose ligjorë, kërkojnë miratimin e Këshillit Kombëtar të Republikës Sllovaqe përpara ratifikimit.

(5) Marrëveshjet Ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare për të cilat nuk është i nevojshëm miratimi me ligj, si edhe marrëveshjet ndërkombëtare të cilat drejtpërdrejt akordojnë të drejta dhe vendosin detyrime për personat fizikë ose ata ligjorë dhe që janë të ratifikuara dhe të dekretuara sipas mënyrës së përcaktuar me ligj do të kenë përparësi ndaj ligjeve.

RREGULLAT GJYQËSORE DHE ATO PARAPËRGATITORE.

Është e vërtetë që vendimet gjyqësore europiane, në fakt janë vendime kombëtare. Qëllimi i nenit 144 të Kushtetutës, i cili trajton mundësinë e vendosjes së rregullave parapërgatitore në sistemin gjyqësor sllovak, duhet të zgjerohet. Kjo nënkupton që gjykatave në Republikën Sllovaqe duhet t'u jepet një siguri kushtetuese, për të dërguar pyetje parapërgatitore në Gjykatën Europiane të Drejtësisë, në përputhje me nenin 234 të kësaj Gjykate.

Një çështje tjetër e rëndësishme është interpretimi i nenit 125 të Kushtetutës, sipas së cilit “Gjykata Kushtetuese do të vendosë për vlerësimin e a) ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare për të cilat Këshilli Kombëtar i Republikës së Sllovakisë ka shprehur vlerësimin e tij dhe të cilat janë ratifikuar dhe dekretuar në mënyrën e parashikuar nga ligji, sipas këtij rendi: 1. Kushtetuta, 2. Ligjet Kushtetuese, 3. Marrëveshjet Ndërkombëtare . Për më tepër paragrafi 2 i nenit 7 citon se “aktet ligjore të detyrueshme të Komunitetit European dhe të Bashkimit European do të kenë përparësi ndaj ligjeve të Republikës Sllovaqe”.

Lidhur me këtë çështje mund të ngrihet një debat në dy fusha.

I. Si është trajtuar në Kushtetutë legjislacioni Komunitar *ultra vires* ose vendimet e Gjykatës Europiane të Drejtësisë? A do të shprehë neni kushtetues se doktrina gjermane e “*ausbrechende Rechtsakt*” është përdorur edhe në Republikën Sllovaqe? Akti *ultra vires* duhet të konsiderohet si subjekt i rishikimit kushtetues në përputhje me nenin 125 dhe nenin 125a të Kushtetutës mbi bazën e të cilit mund të jetë ndërtuar versioni i të ashtuquajturit vendim

i Maastricht-it .

II. Është i diskutueshëm edhe fuqia ligjore e rregullave qeverisëse sipas nenit 120 (2). Neni 120 (2) parashikon zbatimin e direktivave të Komunitetit European në rendin e brendshëm ligjor. Akti që rregullon çështjen e këtyre rregullave të përafritimit nuk i jep zgjidhje problemit në mënyrë eksplicite. Ekzistojnë dy këndvështrime kryesore.

Një përfundim i tillë është në kundërshtim me shtetin e së drejtës dhe jep të tjera argumente për Gjykatën Kushtetuese ndaj mospërputhshmërisë së Traktatit të Komunitetit European me rendin ligjor sllovak, në përputhje me nenin 125a.

Anëtarësimi në BE do të thotë një ushtrim i fuqive të pushtetit ose sovraniteti. Parlamenti European së fundmi ndryshoi Kushtetutën. Por ende në disa fusha nevojitet përafritimi i legjislacionit me *acquis communautaire*.

d) Sllovenia

Marrëveshja Europiane, për shkak të disa ndërlikimeve me ratifikimin e brendshëm hyri në fuqi në datën 1 janar 1999, edhe pse u nënshkrua në 10 qershor 1996. (9) Për shkak të disa neneve të Marrëveshjes Europiane, të cilat trajtojnë çështje të të drejtave ligjore të personave nga Komuniteti European, me qëllim blerjen e disa pasurive të patundshme në Republikën e Sllovenisë, Sllovenia përpara ratifikimit të Marrëveshjes duhet të ndryshonte nenin 68 të Kushtetutës. Gjykata Kushtetuese në datën 5 qershor 1997 dha opinionin e saj për kushtetutshmërinë e Marrëveshjes Europiane. Përpara nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, Republika e Sllovenisë nuk lejoi transferimin e sovranitetit tek institucionet mbikombëtare.

Në sistemin kushtetues slloven marrëveshjet ndërkombëtare kanë përparësi ndaj ligjeve të brendshme. Në nenin 112 të Marrëveshjes Europiane, Këshilli i Stabilizim-Asociimit nxjerr vendime dhe rekomandime. Këto vendime janë të detyrueshme për palët, ashtu si dhe Kushtetuta Sllovene shprehet për ratifikimin e çdo pjese të legjislacionit të huaj, duke përfshirë edhe vendimet e Këshillit të Asociimit.

Edhe pse gjykatat sllovae kanë zbatuar Marrëveshjen Europiane në mënyrë të drejtpërdrejtë, në teori nuk ka pengesa kushtetuese që gjykatat sllovene të zbatojnë nenet e Marrëveshjes Europiane.

e) Rumania

Marrëveshja Europiane e nënshkruar me Rumaninë në vitin 1993, u dërgua për t'u ratifikuar në Parlamentin Rumun në datën 6 prill 1993.

Rendi ligjor rumun shtrihet midis sistemit dualist dhe atij monist, duke iu krijuar marrëveshjeve ndërkombëtare një fuqi të ndryshme që varet nga natyra e tyre. Marrëveshjes Europiane midis Komunitetit European dhe vendeve të tij anëtare, nga njëra anë, dhe Rumanisë, nga ana tjetër, nuk i është dhënë ndonjë pushtet i veçantë, për këtë arsye kjo Marrëveshje është e njëjtë me marrëveshjet e tjera ndërkombëtare.

Marrëdhënia midis legjislacionit ndërkombëtar dhe legjislacionit të brendshëm parashikohet në nenin 11 (1) dhe (2) të Kushtetutës Rumune të vitit 1991, sipas së cilit traktatet ndërkombëtare janë pjesë e legjislacionit të brendshëm. Përderisa traktatet ratifikohen me ligj, atëherë nenet e tyre kanë të njëjtën fuqi me aktin që e miraton. Neni 20 i Kushtetutës, i cili trajton statusin e marrëveshjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, parashikon një nen të veçantë për përparësitë e këtyre traktateve.

Gjykata Kushtetuese është shprehur disa herë për fuqinë ligjore të marrëveshjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke bërë interpretimin e neneve 11 dhe 20 të Kushtetutës. Gjithsesi, nuk është marrë një vendim për zbatimin e Marrëveshjes Europiane.

Kushtetuta Rumune e vitit 1991 duhet të ndryshohej për të zbatuar parimet e drejtëpërdrejta të zbatueshme, epërsinë dhe mundësinë e transferimit të pushteteve te një organizatë ndërkombëtare. Vihet re se Kushtetuta Rumune është relativisht e ngurtë, sepse ajo lejon vetëm rishikimin e një sistemi të komplikuar teknik që lidhet me anën procedurale. Procedura e rishikimit rregullohet me nenin 147 b dhe 148.

Qeveria Rumune ndërmori hapat e parë për të studiuar përputhshmërinë midis neneve të Kushtetutës, parimeve dhe *acquis comunautaire* në dritën e anëtarësimit të saj në BE në dhjetor të vitit 2000.

Ligji për rishikimin e Kushtetutës së Rumanisë u publikua në Fletoren Zyrtare të Rumanisë nr. 669, i datës 22 shtator 2003. Gjykata Kushtetuese u shpreh për kushtetutshmërinë e ligjit për rishikimin e Kushtetutës me vendimin nr. 356/2003, i publikuar në Fletoren Zyrtare pjesa I, nr. 686 i datës 30 shtator 2003. Ky ligj u miratua me referendumin e datës 18/19 tetor 2003.

Në gjykatat rumune nuk ka pasur ndonjë çështje për zbatimin e Marrëveshjes Europiane. Por gjithsesi duhet përmendur që, sipas marrëveshjes europiane gjykatat kombëtare nuk janë të detyruara të zbatojnë legjislacionin Komunitar dhe interpretimin e Gjykatës Europiane të Drejtësisë. Gjithsesi, gjykatat, të cilat zbatojnë legjislacionin vendas që është i përafuar me *acquis communautaire*, kanë zbatuar në të njëjtën kohë legjislacionin Komunitar.

B. Efektet ligjore të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Marrëveshjes së Asociimit me Turqinë dhe Marrëveshjes së Asociimit me Rusinë në rendin e brendshëm ligjor.

f) Kroacia

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit u nënshkrua më 29.10.2001 dhe hyri në fuqi më 1 shkurt 2005, edhe pse disa vende anëtare të BE-në ende nuk e kishin ratifikuar këtë Marrëveshje. Por, ndërkohë që Kroacia pret të hyjë në fuqi MSA-ja, zbatohet Marrëveshja e Ndërmjetme si pjesë e MSA-së. Marrëveshja e Ndërmjetme filloi të zbatohet në datën 1 janar 2002 dhe hyri në fuqi në datën 1 mars 2002. Kjo Marrëveshje rregullonte çështje që lidheshin me tregtinë.

Përdërisa MSA-ja nuk kishte hyrë në fuqi, gjykatat nuk mund ta zbatonin këtë Marrëveshje në mënyrë të drejtpërdrejtë. Gjithsesi, gjykatat mund të

mërrnin në konsideratë interpretimin e legjislacionit kroat dhe t'i referoheshin atij si një mjet interpretativ.

Marrëveshja e Ndërmjetme ishte në fuqi jo më shumë se 2 vjet, gjithsesi në gjykatat kroate nuk ka pasur çështje gjyqësore për shkeljet e Marrëveshjes së Ndërmjetme. Gjykatat mund t'i referoheshin Marrëveshjes së Ndërmjetme në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë. Nuk kemi informacion nëse ndonjë gjykatë kroate i është referuar Marrëveshjes së Ndërmjetme. Ministria e Integritimit Europian nuk ka dijeni për ndonjë çështje gjyqësore. Dështimi i gjykatave për t'iu referuar MSA-së mund të ketë dy arsye: e para, sepse nuk ka patur konflikte që lidhen me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe, së dyti, sepse konfliktet mund të jenë ngritur në gjykatë, por gjykata i ka zgjidhur ato pa zbatuar MSA-në.

Kushtetuta Kroate e viti 1990 parashikonte nene për zbatimin e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve ndërkombëtare në rendin e brendshëm. Sipas këtyre dispozitave, marrëveshjet ndërkombëtare ratifikohen dhe publikohen si pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe kanë epërsi ndaj ligjeve të brendshme. Kushtetuta i referohet traktateve ndërkombëtare në 4 shkallë. Neni 2(3) i referohet juridiksionit territorial për detin “në përputhje me të drejtën ndërkombëtare”, neni 31 i referohet parimit të legjitimitetit të mbrojtjes ndaj një krimi sipas të drejtës ndërkombëtare, neni 33 trajton të drejtat e azilit “në përputhje me parimet themelore të së drejtës ndërkombëtare” dhe, si përfundim, neni 138, i cili parashikon çështjen e ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare në përputhje me rregullat e së drejtës ndërkombëtare si neni 25 i Legjislacionit Themelor Gjerman.

Marrëveshjet ndërkombëtare si pjesë e rendit ligjor kombëtar, mbështetur në nenin 140 të Kushtetutës, duhet të zbatohen nga gjykatat kombëtare dhe duhet të përcaktojnë të drejta individuale. Gjithsesi, neni 117 i Kushtetutës shprehet vetëm për Kushtetutën dhe ligjet si burime për gjyqësorin, i cili është në kundërshtim me nenin 140. Nuk duket se qëllimi i Kushtetutës është të përjashtojë të drejtën ndërkombëtare si një burim i autoriteteve ligjore. Referenca që

mbështet këtë këndvështrim mund të gjendet në Aktin Gjyqësor të vitit 1994, sipas të cilit, gjykatat kroate, përveç zbatimit të Kushtetutës dhe ligjeve, mund të zbatojnë dhe Traktatet ndërkombëtare si dhe rregulloret e miratuara në zbatim të Kushtetutës, traktatet ndërkombëtare dhe legjislacionin kroat.

Në Kushtetutën Kroate nuk ka nene të hapura, ta papajtueshme me anëtarësimin në BE. Prandaj, Traktatet e Komunitetit European mund të ratifikohen pa ndryshime formale të Kushtetutës. Janë disa nene kushtetuese, të cilat për shkak të tekstit të tyre të hapur, nuk përjashtojnë interpretimin, i cili mund të krijojë një pengesë për anëtarësimin në Komunitetin European.

g) Republika e Shqipërisë

Në datën 12 qershor 2006, Shqipëria nënshkroi MSA-në me Bashkimin European dhe vendet e tij anëtare. Nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje ishte një hap i rëndësishëm drejt rrugës së integritit të Shqipërisë për në BE. Kjo Marrëveshje ka kontribuar në stabilitetin ekonomik dhe politik të Shqipërisë dhe të rajonit (10).

Duhet të theksojmë se nga data 1 dhjetor 2006, vetëm nenet e Marrëveshjes për Tregtinë e Lirë (Marrëveshja e Ndërmjetme) kanë hyrë në fuqi. Nenet e tjera të MSA-së do të hyjnë në fuqi pasi Marrëveshja të jetë ratifikuar nga parlamentet e vendeve anëtare të BE-së. Në maj të vitit 2008 rreth 18 vende anëtare kanë ratifikuar MSA-në.

Kushtetuta Shqiptare e miratuar nga Parlamenti Shqiptar në datën 21 tetor 1998, parashikon nene për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, efektin e tyre në rendin e brendshëm shqiptar dhe transferimin e pushteteve të veçanta tek organizatat ndërkombëtare.

E drejta ndërkombëtare në rendin e brendshëm shqiptar, si dhe traktatet ndërkombëtare, si pjesë e rendit ligjor kombëtar, janë të zbatueshme nga gjykatat kombëtare dhe mund, të paktën në teori, të krijojnë të drejta individuale.

Neni 122

1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit

të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë.

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.

3. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj.

Neni 123

1. Republika e Shqipërisë, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare, u delegon organizatave ndërkombëtare kompetenca shtetërore për çështje të caktuara.

2. Ligji me të cilin ratifikohet një marrëveshje ndërkombëtare, siç parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni, miratohet me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

3. Kuvendi mund të vendosë që ratifikimi i një marrëveshjeje të tillë të bëhet me referendum.

Gjatë ratifikimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit çështja nëse pushteti rregullues duhet të transferohet të Këshilli i Stabilizim-Asociimit. Si përfundim Kushtetuta Shqiptare në nenin 123 parashikon transferimin e pushtetit legjislativ tek organizatat ndërkombëtare, edhe pse nuk ka konfirmim të një praktike gjyqësore. Gjithsesi, mbetet për t'u diskutuar pyetja nëse do të ishte më mirë prezantimi i nenit 123 të Kushtetutës si një bazë ligjore për anëtarësimin në BE, e cila mund të sigurojë transferimin e pushteteve të institucioneve të Komunitetit dhe në të njëjtën kohë të bëjë të qartë që aktet ligjore që miratohen kanë efekt të drejtpërdrejtë në rendin ligjor shqiptar dhe

kanë epërsi ndaj legjislacionit vendas.

Statusi ligjor i legjislacionit të Komunitetit, si ai parësor dhe ai dytësor, nuk është përcaktuar ende në rendin e brendshëm ligjor shqiptar. Nuk ka diferencim midis legjislacionit ndërkombëtar dhe atij Komunitar. Ajo çfarë është më e kuptueshme në këtë fazë është se Shqipëria nuk është vend anëtar i BE-së.

Në nenin 122 të Kushtetutës citohet qartë nevoja për bërjen e legjislacionit Komunitar pjesë integrale të legjislacionit kombëtar, si dhe e diferencimit të këtij legjislacioni nga traktatet ndërkombëtare ose nga rregulla të tjera të së drejtës ndërkombëtare.

Ky diferencim duhet të njohë natyrën e veçantë të legjislacionit Komunitar dhe nuk ka pse domosdoshmërisht të njohë qëndrimin e të drejtës ndërkombëtare në rendin ligjor Komunitar. E thënë ndryshe, rregullat ligjore të Legjislacionit Komunitar, si ai parësor ashtu edhe ai dytësor, duhet t'u jepet më mënyrë specifike autoritet ligjor dhe epërsi, si dhe mundësi për zbatimin e efektit të drejtpërdrejtë. Kjo çështje mund të rregullohet në të njëjtin nen duke siguruar kështu bazën ligjore për anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Ligji Zela i vitit 2004 parashikon rregulla të veçanta për rolin e Parlamentit si organi më i lartë hierarkik në procesin e Stabilizim-Asociimit, duke synuar hartimin e një kuadri gjithëpërfshirës ligjor, i cili mbështet dhe mbikëqyr procesin e integritimit europian të Shqipërisë për në BE. Mbështetur në nenin 3 të këtij neni, Këshilli i Ministrave i dërgon rregullisht Kuvendit informacione për punën e bërë pranë institucioneve të ndryshme të Bashkimit Europian dhe vlerësimet e bëra veçanërisht për projekt marrëveshjet dhe konventat që duhen lidhur me Bashkimin Europian, në kuadër të procesit të afrimit të Shqipërisë me Bashkimin Europian .

Gjithsesi, nevojitet një pjesëmarrje më e madhe e Qeverisë në vendimmarrje në nivel europian. Nevojitet autoritet kushtetues i drejtpërdrejtë, i cili duhet t'i japë Qeverisë bazën kushtetuese për hartimin e vendimeve dhe për zbatimin e tyre në nivel kombëtar. Kjo duhet shoqëruar me një

detyrim të njëhershëm për të informuar Parlamentin në mënyrë të rregullt për veprimtaritë rregulluese. P.sh., ky mund të jetë rasti me Vendimet e Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes së Ndërmjetme.

ROLI I GJYQËSORIT (GJYKATAT KOMBËTARE)

Në kohën e përgatitjes së këtij artikulli, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ende nuk ishte në fuqi, pra nuk ishte ratifikuar nga 27 vendet anëtare. Gjithsesi, ashtu si dhe në rastet e vendeve që kanë nënshkruar Marrëveshje Europiane, ndërkohë që presin të hyjë në fuqi MSA-ja, ka hyrë në fuqi Marrëveshja e Ndërmjetme, me qëllim bërjen efektive të atyre pjesëve të MSA-së për të cilat Komuniteti European është kompetent. Marrëveshja e Ndërmjetme hyri në fuqi në datën 1 dhjetor 1006 dhe kjo mundëson hyrjen në fuqi të neneve për çështjet tregtare të MSA-së. BE-ja pret që Shqipëria të përfitojë nga hapja e tregut European.

Ndërkohë që MSA-ja ende nuk është në fuqi, gjykatat mund të zbatojnë Marrëveshjen e Ndërmjetme dhe Vendimet e Përbashkëta të marra nga Komiteti i Përbashkët në zbatim të Marrëveshjes së Ndërmjetme, meqë Marrëveshja e Ndërmjetme është aktualisht në fuqi. Mund të ketë dhe çështje gjyqësore që lidhen me zbatimin e Marrëveshjes së Ndërmjetme. Gjykatat kombëtare mund të zbatojnë në këtë mënyrë Marrëveshjen e Ndërmjetme. Deri tani nuk kemi informacion nëse ka ndonjë çështje gjyqësore. Gjithsesi, mendojmë se mund të ketë çështje mbi nenet standstill, si p.sh. vërejtëm se taksa për rakinë është më e ulët sesa ajo për grapan. Kjo është në kundërshtim me nenin 21 të Marrëveshjes së Ndërmjetme, konkretisht me ndalimin e diskriminimit fiskal dhe një importues i Grappas mund të ngrejë një padi në gjykatë për këtë çështje. Lidhur me këtë çështje mund të ngrihen disa pyetje si: Çfarë ndodh nëse autoriteti kompetent nuk zbaton Vendimin e Përbashkët të Komitetit të Marrëveshjes së Ndërmjetme ose e zbaton atë, por në mënyrë jokorrekte, a duhet që gjykatat të zbatojnë drejtpërdrejtë Vendimin e Përbashkët të Komitetit sapo Shqipëria të jetë bërë vend anëtar i BE-së?

Për mendimin tonë MSA-ja vetë, nëse interpretohet në këndvështrimin e objektivit dhe të qëllimit të saj, i cili është pranë integritimit për në BE dhe anëtarësimi për në BE autorizon gjykatat shqiptare të zbatojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë legjislacionin dytësor, i cili është i aftë të krijojë efekte të drejtpërdrejta, të njëjta me precedentët gjyqësorë të Gjykatës Europiane të Drejtësisë. Ky fakt justifikohet me statusin e epërsisë së legjislacionit të MSA-së ose të Marrëveshjes së Ndërmjetme në rendin ligjor shqiptar dhe nga fakti se legjislacioni dytësor duhet të publikohet në Fletoren Zyrtare shqiptare.

Të dyja, si MSA-ja dhe kushtet për anëtarësim për në BE, kërkojnë që Shqipëria të përafrojë legjislacionin e saj me *acquis communautaire*. Kjo përshtatje nuk kryhet thjesht duke miratuar akte ligjore në përputhje me *acquis*, por duke i zbatuar këto akte në praktikë. Interpretimi i legjislacionit shqiptar dhe i akteve të tjera nën dritën e legjislacionit Komunitar mund të interpretohet si një nga detyrimet e parashikuara në MSA. Pra, një interpretim i mundshëm është se moszbatimi i parimeve të efektit jo të drejtpërdrejtë në raste të tilla paraqet një moszbatim të MSA-së nga ana e gjykatave.

Anëtarësimi në BE nuk shkakton ndryshime në organizimin e sistemit gjyqësor në Shqipëri. Nga precedentët gjyqësorë të Gjykatës Europiane të Drejtësisë del qartë se legjislacioni i BE-së nuk ndërhyt në organizimin e sistemit të drejtësisë në vendet anëtare, duke siguruar se janë gjithnjë gjykatat ato, të cilat janë kompetente për të nxjerrë vendime mbështetur në legjislacionin Komunitar.

Edhe pse nuk nevojitet një ndryshim organizativ, kërkesat për një efektivitet të mbrojtjes juridike do të provokojnë ndryshime në sferën procedurale, si dhe në praktikë për sa i përket gjykatave. Për t'u bërë gjyqtarë evropianë, gjyqtarët vendas duhet të jenë familjarë me legjislacionin Komunitar, të kuptojnë jo vetëm rregullat, por edhe precedentë që interpretojnë këto rregulla, si dhe parimet bazë të Komunitetit që lidhen me zbatimin dhe interpretimin e tyre. Për të realizuar këtë është e nevojshme të edukojmë të gjithë gjyqtarët të tanishëm dhe të

ardhshëm. Deri tani numri i gjyqtarëve shqiptarë të cilat kanë marrë leksione mbi të drejtën Komunitare është i vogël. Gjithsesi, Shkolla e Magjistraturës ka zgjeruar programin e saj për trajnimet për çështje të së drejtës Komunitare.

h) Turqia

Për të përafuar legjislacionin turk me kriteret e Kopenhagenit të vitit 1993, janë ndryshuar disa nene të Kushtetutës disa vjet më parë. Janë miratuar tetë paketa legjislative nga Parlamenti.

Turqia ka një afrim monist ndaj të drejtës ndërkombëtare, pra, si rrjedhojë, nuk ka nevojë që traktati ndërkombëtar të miratohet me ligj të brendshëm, për t'u bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm.

Neni 6 i Kushtetutës Turke parashikon:

“Sovraniteti i përket kombit. Kombi Turk do të ushtrojë sovranitetin tij nëpërmjet organeve kompetente siç është parashikuar në parimet e cituara më poshtë në Kushtetutë.

E drejta e ushtrimit të sovranitetit nuk delegohet tek asnjë individ, grup ose klasë. Asnjë person ose agjenci nuk mund të ushtrojë autoritetin e shtetit, i cili buron nga Kushtetuta.”

Neni 7

“Pushteti legjislativ është e drejtë e Parlamentit të Madh Kombëtar Turk, në interes të kombit turk. Ky pushtet nuk mund të delegohet.”

Edhe pse Turqia ka miratuar një afrim monist ndaj së drejtës ndërkombëtare, përfshirja e traktateve ndërkombëtare në rendin e brendshëm ligjor nuk është e menjëhershme dhe për këtë nevojitet ratifikimi i tyre.

Neni 90 i Kushtetutës së vitit 1982 parashikon pesë paragrafë mbi procesin e ratifikimit dhe efektet ligjore të traktateve:

Neni 90

“(1) Ratifikimi i traktateve të lidhura midis shteteve të huaja dhe organizatave ndërkombëtare në emër të Republikës së Turqisë do të jenë subjekt i miratimit nga ana e Parlamentit Turk me anë të një ligji.

(2) Traktatet që trajtojnë çështje ekonomike, tregtare dhe teknike, si dhe mbulojnë një periudhë kohë prej një viti, mund të kenë efekt ligjor nëpërmjet dekretimit, duke siguruar që nuk përmbajnë ndonjë angazhim financiar nga shteti dhe duke siguruar që ato nuk shkelin statusin e individit ose të qytetarëve turq jashtë shtetit. Në raste të tilla për këto marrëveshje duhet të vihet në dijeni Parlamenti Turk brenda dy muajsh nga data e dekretimit të tyre.

(3)...

(4) Të gjitha llojet e traktateve të cilat do të ndryshojnë legjislacionin turk do të jenë subjekt i neneve në paragrafin e parë.

(5) Traktatet Ndërkombëtare të miratuara kanë të njëjtin efekt juridik me atë të ligjit. Në Gjykatën Kushtetuese nuk mund të ngrihen padi ndaj këtyre traktateve, mbështetur në faktin se ato janë antikushtetuese”.

i) Federata Ruse

Nëse qytetarët dhe kompanitë rusë do të zbatojnë të drejtat e tyre të trajtimit të njëjtë, të cilat rrjedhin nga Marrëveshja e Asociimit për gjykatat kombëtare në vendet anëtare të BE-së, siç u tregua edhe në çështjen Simotenzov, do të ngrihet pyetja nëse qytetarët evropianë dhe kompanitë mundet të zbatojnë të drejtat e tyre të trajtimit të njëjtë përpara gjykatave kombëtare në Federatën Ruse? (11)

Përgjigja e kësaj pyetjeje varet nga zbatimi i Marrëveshjes nga gjykatat ruse. Neni 15 (4) i Kushtetutës Ruse i jep përparësi marrëveshjeve ndërkombëtare ndaj legjislacionit rus. Ky nen parashikon:

“Parimet e njohura dhe normat e së drejtës ndërkombëtare si dhe traktatet ndërkombëtare të Federatës Rusë janë pjesë e rendit ligjor të brendshëm. Nëse një traktat ndërkombëtar përcakton rregulla të tjera nga ato të përcaktuara nga ligji, do të zbatohen rregullat e përcaktuara nga traktati ndërkombëtar.”

Ky nen tregon se nuk ka pengesa ligjore dhe kushtetuese për gjyqtarët rusë për të zbatuar nenet e Marrëveshjes PCA, mbështetur në nenin 15 (4) të

Kushtetutës moderne ruse, pra, Marrëveshja PCA është pjesë e rendit ligjor rus.

Pse është zbatuar rrallë ky nen i Kushtetutës? Për mendimin tonë kjo vjen sepse gjyqtarët rus nuk janë trajnuar dhe nuk kanë përvojë në zbatimin e të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës Europiane. Për të përmirësuar mbrojtjen ligjore, nevojitet rritja e ndërgjegjësimit te shoqëria ligjore ruse dhe te sistemi gjyqësor në Rusi, në mënyrë që ata të jenë më aktivë në zbatimin e të drejtës ndërkombëtare. Ndoshta e ashtuquajtura çështja Simotenkov do të ndërgjegjësojë gjyqtarët për zbatimin e të drejtës ndërkombëtare dhe asaj Europiane. Kjo çështje duhet të ketë ndikim të njëjtë edhe në zhvillimin e rendit ligjor brenda Rosisë-BE siç ka ndikuar çështja Van Gend & Loos në rendin ligjor të Komunitetit. Një tjetër efekt është dhe ai politik. Në arsyetimin ligjor të vendimit të Gjykatës Europiane të Drejtësisë efekti ligjor i PCA-së u krahasua me efektin ligjor të Marrëveshjes Europiane. Ia vlen të përmendim disa karakteristika të kësaj norme të skajshme të rëndësishme kushtetuese. Neni 15 (4) parashikon se “të gjitha ligjet ndërkombëtare janë pjesë e rendit të brendshëm ligjor rus. Si traktatet ndërkombëtare, ashtu edhe parimet dhe normat e së drejtës ndërkombëtare”. Ky nen nuk përmban vetëm parimet dhe normat që janë të detyrueshme për Rusinë, por edhe parimet dhe normat që Rusia duhet të zbatojë në traktatet e ardhshme. Ky nen nuk bën dallimin midis parimit ndërkombëtar të vetekzekutueshëm dhe jo të vetekzekutueshëm. Individët mund të kërkojnë zbatimin e legjislacionit ndërkombëtar si pjesë e rendit ligjor në ndonjë gjykatë administrative. Ku nen përcakton një status më të lartë normativ për traktatet sesa për legjislacionin e brendshëm. Pra, ligjet e brendshme nuk do të zbatohen, nëse ato janë në kundërshtim me traktatet ndërkombëtare. Gjykatat kombëtare duhet t’i japin precedencë neneve të traktateve më shumë sesa legjislacionit të brendshëm. Me përjashtim të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, deri tani nuk kemi gjetur ndonjë vendim gjyqësor, i cili i jep përparësi normave ndërkombëtare dhe që ka zbatuar traktatet ndërkombëtare në vend të vetë Kushtetutës. Shumë vende kandidatë,

anëtarësimi për në BE i ka ndihmuar për modernizuar kushtetutën e tyre. Gjithsesi, Kushtetuta Ruse e vitit 1993, sipas nenit 15 (4) ka qenë gjithmonë më e përparuar sesa kushtetutat e shumë vendeve të tjera kandidate, pasi kjo Kushtetutë ka njohur parimin e parësisë. Ky parim është zbatuar edhe në një çështje të Gjykatës Kushtetuese Shqiptare të vitit 1998, e cila mund të përdoret si shembull për shumë vende kandidate. Për të arritur një sistem mbrojtjeje të mirë ligjore në Turqi, nuk është i mjaftueshëm vetëm teksti i Kushtetutës, por edhe interpretimet që jepen nga gjykatat kombëtare.

KUSHTETUTA RUSE DHE MARRËVESHJA E PARTNERITETIT DHE E BASHKËPUNIMIT

Kompanitë e vendeve anëtare të BE-së kanë të drejtë të ngrenë filiale në Rusi, me të njëjtat kushte me ato të kompanive ruse. I njëjti trajtim duhet të jetë dhe për kompanitë ruse, të cilat kanë filiale të tyre në BE. Në Marrëveshjen e Partneritetit dhe të Bashkëpunimit janë parashikuar detyrime negative për Rusinë pas një periudhë tranzitore prej pesë vjetësh nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, që është data 1 dhjetor 2002. P.sh. neni 52 (2) parashikon që “palët nuk do të vendosin ndonjë kufizim të ri ndaj lëvizjes së lirë të kapitalit dhe pagesave të drejtëpërdrejta ndaj personave rezidentë të Komunitetit dhe Rusia nuk do të rrisë detyrimet fiskale”. Për të kuptuar mbrojtjen ligjore të kompanive të BE-së dhe Ruisë duhet të dallojmë mbrojtjen ligjore në tri rënde të ndryshme: rendi ligjor rus, rendi ligjor i Komunitetit dhe rendi i brendshëm ligjor i vendeve anëtare të BE-së.

Sipas nenit 15 (4) të Kushtetutës Ruse, Marrëveshja e Partneritetit dhe e Bashkëpunimit, e cila është ratifikuar nga Duma, është pjesë e rendit ligjor rus dhe mund të kërkohet zbatimi i saj përpara gjykatave ruse (12), në rastet kur masa ligjore përkatëse është në konflikt dhe nuk përputhet me detyrimet negative të nenit 52 (5) të Marrëveshjes së Partneritetit dhe Bashkëpunimit. Gjykata ruse vendosi të mos zbatojë masat legjislative të Qeverisë, në rast se më vonë vendosen kufizime të reja ndaj lëvizjes së lirë të kapitalit dhe pagesave të

drejtpërdrejta. Nuk është e nevojshme që detyrimet ndërkombëtare të jenë drejtpërdrejt të zbatueshme. Në këtë mënyrë Kushtetuta Ruse është edhe më moderne, duke u krahasuar p.sh. me Kushtetutën Holandeze, e cila kufizon përparësinë e të drejtës ndërkombëtare ndaj legjislacionit holandez, vetëm për sa i përket normave drejtpërdrejt të zbatueshme.

PËRFUNDIM PARAPRAK:

EFEKTET LIGJORE TË MARRËVESHJEVE TË ASOCIIMIT ME BE-në PËR KOMBËTARËT E VENDEVE JOANËTARE

Në rendin ligjor Komunitar

Duke u mbështetur në efektin e drejtpërdrejtë të neneve të Marrëveshjeve të Asociimit me BE-në, çdo vend joanëtar mund të kërkojë të drejtat e tij përpara gjykatave të vendeve anëtare të BE-së. Kushtet bazë për efekt të drejtpërdrejtë të Marrëveshjeve të Asociimit me BE-në në rendin ligjor Komunitar janë formuluar nga Gjykata Europiane e Drejtësisë në rastin Demirel:

“Një dispozitë në një marrëveshje ndërkombëtare, e nënshkruar nga Komuniteti me vende joanëtare, duhet të konsiderohet si e aplikueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë kur, duke pasur parasysh formulimin e saj, qëllimin dhe natyrën e vetë Marrëveshjes, dispozita përmban një detyrim të qartë dhe të saktësuar që nuk i nënshtrohet, për sa i përket zbatimit ose efekteve të saj, miratimit të ndonjë mase pasuese.”

Efektet ligjore të marrëveshjeve të Asociimit me BE-në në *rendin ligjor komunitar* janë përmendur edhe në shumë vendime të tjera të Gjykatës së Drejtësisë në gjykime paraprake përsa i përket kombëtarëve të vendeve me të cilat është nënshkruar një Marrëveshje. Gjykata e Drejtësisë shpjegoi se dispozitat përkatëse krijojnë të drejta për kombëtarët e vendeve që kishin një Marrëveshje Europiane me BE-në. Na rezultoi se shumë kombëtarë të të vendeve që nuk bëjnë pjesë në BE ishin përfshirë në gjyqe në vendet anëtare të BE-së në të cilat gjykatat kombëtare përkatëse i kanë kërkuar

një gjykim paraprak Gjykatës Europiane të Drejtësisë

NË RENDET LIGJORE KOMBËTARE TË VENDEVE QË NUK JANË ANËTARE TË BE-së

Efektet ligjore të Marrëveshjeve të Asociimit me BE-në në *rendin ligjor kombëtar* të vendeve që nuk janë shtete anëtare të BE-së janë të drejtpërdrejta, megjithatë në radhë të parë varen nga interpretimi që U bë. Një gjyqtarët kushtetutave kombëtare përkatëse, duke i dhënë përparësi zbatimit të neneve të Marrëveshjeve të Asociimit në raport me legjislacionin vendas. Së dyti, efektet ligjore janë në varësi të interpretimit që gjykatat u bëjnë objektive të dispozitave të Marrëveshjeve të Asociimit me BE-në. Ne dhamë shumë gjykime si shembuj.

Vendi aplikant përpiqet të sigurojë që legjislacioni aktual dhe ai i ardhshëm do të harmonizohet gradualisht me *acquis communautaire*. Ky artikull do të ndikojë që gjykatat të interpretojnë legjislacionin aktual sa më shumë të jetë e mundur në përputhje me legjislacionin Komunitar.

Jo vetëm detyrimet negative, nenet standstill, por edhe trajtimi i njëjtë ose diskriminimi fiskal duhet të zbatohen nga gjykatat kombëtare në kuadër të zbatimit të neneve të MSA-së. Shembulli i detyrimit negativ paraqitet më poshtë;

“1. Asnjë tarifë e re doganore për importe ose eksporte ose detyrime që kanë një efekt të barasvlefshëm nuk do të hyjë në fuqi dhe ato që tashmë aplikohen nuk do të rriten në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe... nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.”

Nëse p.sh., në një rast imagjinar, një vend joanëtar, duke miratuar një dekret do t'i rrisë detyrimet doganore pas afatit përkatës, në këtë rast një kompani e vendosur në një vend joanëtar, mund ta padisë qeverinë në një gjykatë kombëtare për mospërshtatje me detyrimin, duke u bazuar në faktin se ngritja e tarifave doganore do të ketë si pasojë dëmtime për kompaninë. Një tjetër mundësi është t'i kërkojë gjykatës që të mos zbatojë vendimin e

qeverisë, i cili nuk përputhet me detyrimin negativ të Marrëveshjes së Asociimit.

Ose ndoshta mundet që Komisioni European ta padisë shtetin përkatës, pasi ai nuk është duke u përshtatur me detyrimet që rrjedhin nga një Marrëveshje Asociimi me BE-në.

Një gjë e tillë do të çojë në një situatë të ngjashme me atë të çështjes Van Gend & Loos, të cilën e komentova më sipër. Megjithatë në këtë rast imagjinar, përgjigjja në radhë të parë do të jepet nga ligji kushtetues kombëtar dhe jo nga ligji Komunitar.

REFERENCA

1. Çështja 26/62 Van Gend & Loos(1963) ECR 1 en çështja 6/64 Costa v. ENEL (1964) ECR 585

2. Çështja C-12/86 ECR 1987, 3719 (*Demirel*)

3. Schermer, Timmermans, Kellermann “Neni 177 i Traktatit të Komunitetit European: Përvojat dhe problemet”, Kompania Veriore Holandeze e Publikimit (1986). BE-ja dhe fqinjët e saj, një vlerësim ligjor i politikave europiane të stabilizimit, partneritetit dhe integritimit , Steven Blockmans & Adam Lazovski (Editors), T.M.C. Asser Press, 2007

E drejta Kushtetuese e BE-së, Koen Lenaerts and Piet van Nuffel, Editor: Robert Bray, Sweet & Maxwell; 1999 p. 534

Alfred E. Kellermann, Jaap W. de Zwaan, Jenő Czuczai (Eds), Zgjerimi i BE- së: Impakti kushtetues në BE dhe në nivel kombëtar, T.M.C. Asser

Press / The Hague, Shtator 2001.

4. Marrëveshja Europiane me Poloninë OJ 1993 L 348/1; Marrëveshja Europiane me Europën OJ 1993.

L347/1; Marrëveshja Europiane me Republikën Çeke OJ 1994 L 360/1; Marrëveshja Europiane me Republikën Sllovake OJ 1994 L 359/1; Marrëveshja Europiane me Rumaninë OJ 1994 L 357/1; Marrëveshja

Europiane me Estoninë L 68/1; Marrëveshja Europiane me Letoninë 26/1; Marrëveshja Europiane me Lituaninë OJ 1998, L 51/1 Mbi efektet e paraanëtarësimit të Marrëveshjes Europiane, shiko Jeno Czuczai, p 412 në Zgjerimin e BE-së: Impakti kushtetues në nivelin europian dhe atë kombëtar. A.E. Kellermann, et al. (Eds), 2001 Asser Press.

5. Gjykata Europiane e Drejtësisë e datës 27 shtator 2001- Çështja C-63/99 – *Gloszczuk*; - C-235/99 – *Kondova* and - C-257/99 – *Barkoci and Malik*; 20 nëntor 2001 – C-268/99 – *Jany dhe të tjerët*.

Të drejtat e vetëpunësimit CEEC qytetarët në vendet anëtare të BE-së sipas Marrëveshjes Europiane Dr. Andrea Ott, Gjykata Europiane e Drejtësisë 27 shtator 2001, Forumi Ligjor Europian, 8 – 2000/-1, pp. 497 – 556.

Shiko çështjet *Gloszczuk*, *Kondova* dhe *Barkoci*: Lëvizja e lirë e personave të vetëpunësuar dhe Marrëveshja Europiane, nga Ronald van Ooik, Fletorja Zyrtare e Migracionit f. 377-393.

6. Impakti i Anëtarësimit në BE në rendin ligjor të vendeve të reja anëtare dhe - *Hopes and Fears* – Redaktuar nga Alfred E. Kellermann, Jno Czuczai, Steven Blockmans, Anneli Albi and Wybe Douma- T.M.C Asser Press 2006.

Shiko Manualin për zgjerimin Europian, T.M.C. Asser Press, 2002, Redaktuar nga Andrea Ott dhe Kirstyn Inglis.

7. Shiko Krzysztof Wojtowicz, f 35

Rezoluta e shtatë vendimeve e datës 27 prill 1995 të Gjykatës së Lartë Polake, Dhoma Administrative, e Punës dhe Sigurimeve Sociale, publikuar në Jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, Fletore Zyrtare (IIIAPZ 4/95), publikuar në Jurisprudencën e Gjykatës së Lartë nr. 19/1995 faqe 201-207.

Në zbatim të nenit 3 të Ligjit të datës 28 tetor 1950 për profesionin e Fizikantit, (*Dziennik Ustaë*, Nr 50, neni 458) Ministri i Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Fizikantëve mund të autorizojë të huajt të praktikojnë profesionin e doktorit në Republikën Polake dhe për më tepër të punësohen në institucione publike të mbrojtjes së shëndetit.

8. Evgeni Tanchev, ndryshimet kushtetuese si pasojë e anëtarësimit në

BE, faqe 301-310. Librin Zgjerimi i BE-së. Impakti kushtetues në nivelin European dhe kombëtar 2001, T.M.C. Shtypi Asser, nga Alfred E. Kellermann , Jaap W. de Zwaan, Jenő Czuczai et al. (Eds), Aneksi II i Hagës ; E.Evtimov, Marrëveshjet e Integritit dhe Ndërkombëtare sipas legjislacionit bullgar, f. 221 – 228, nga A. Ott dhe K. Inglis (Eds), Libri i Zgjerimit European, 2002 T.M.C. Shtypi Asser, Hagë, Holandë.

9. Franci Grad, Igor Kaucic, Miha Pogacnik dhe Bojan Tigar, autorë dhe redaktorë të Sistemit Kushtetues të Republikës së Sllovenisë, SECLI f.316.

10. Impakti i Anëtarësimit në BE në rendin e brendshëm ligjor të Shqipërisë. Revista “E drejta parlamentare dhe politikat ligjore”, 1/2007, f. 4 – 35.

Përvojat Europiane të qeverisjes së mirë, “E drejta parlamentare dhe politikat ligjore”, 3/2007, f. 4 – 27. Udhëzues për një përafrim efektiv të legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire*, “E drejta parlamentare dhe politikat ligjore”, 4/2007, f. 12 – 53. Udhëzues për cilësinë e legjislacionit European dhe impakti i tij në Shqipëri, do të publikohet në 2008 në Fletoren Europiane të Reformës Ligjore, rreth 35 faqe. Shiko edhe “Prek dashurinë: Marrëdhëniet e BE-së me Ballkanin Perëndimor”. Steven Blockmans, Shtypi Asser, 2007.

11. Artikulli: “Impakti i zgjerimit të BE-së në Federatën Ruse”, publikuar në gjuhën angleze në Fletoren Zyrtare të Çështjeve Europiane, Tetor 2004, f. 5 – 40.

Artikulli: “Impakti i zgjerimit të BE-së në Federatën Ruse”, publikuar në gjuhën ruse në çështje të drejtësisë dhe të politikave, Moskë 1- 2005, f. 94-120. (Pravo i Politika është një gazetë e pavarur e shkëmbimit të mendimeve të shkencëtarëve rusë dhe psikologëve socialë.

Artikulli: “Impakti i zgjerimit të BE-së për Federatën Ruse, Poloninë, Sosnowiec 2005 – Fundamenty Nowego Porzadku Konstytucyjnego UE, red Aleksandry Wentkoëskiej, f. 53-91, Qendra Ruse - Europiane për Politika Ekonomike. (RECEP) Moskë nr. 3, 2005. Anëtarësimi në Tregun e Brendshëm European pa qenë vend anëtar i BE-së. Një krahasim i

marrëdhënieve BE-Norvegji, BE-Zvicër dhe BE-Rusi. Cila do të jetë mënyra më e mirë për Federatën Ruse? f. 3 – 50 (anglisht) dhe f. 52-106 (rusisht). Artikulli i publikuar në Europa (Fletore Zyrtare e Delegacionit të BE-së në Moskë), prill 2005, f. 8 – 10 mbi çështjen Simotenkov (Efekti i drejtpërdrejtë i nenit 23 (1) i Marrëveshjes së Partneritetit dhe Bashkëpunimit midis Rosisë, BE-së dhe vendeve të saj anëtare.)

12. Zbatimi i Marrëveshjes së Partneritetit dhe Bashkëpunimit nga Gjykatat Ruse.

1. Opinion i veçantë i çështjes Konovalov nga Gjykata Kushtetuese e Federatës Ruse nr. 16-Ë e datës 11 nëntor 1997. Gjetje e një konvergjence midis Kushtetutës dhe neneve 11 të legjislacionit rus mbi kufijtë shtetërorë dhe kushtet e detyrimeve kufitare, të cilat lidhen me Marrëveshjen e Partneritetit dhe të Bashkëpunimit. (nenet 38 - 40).

2. Vendim i Gjykatës Federale të Arbitrazhit të Rajonit Volgo-Vyatskiy çështja N A17-151A/5-2004 e datës 19 janar 2005. Shfuqizimi i dënimit administrativ për OOO “Ivanovkaya Alternative”.

3. Vendim i Gjykatës Federale të Arbitrazhit për Rajonin e Lindjes së Largët. Çështja N Ф03-À73/01-2/2609 e datës 19 dhjetor 2001. Shfuqizimi i dënimit administrativ për Kompaninë “Primorye”. Përcaktimi i shërbimeve të eksportit në legjislacionin rus. Analogji e legjislacionit; analogji me Seksionin IV, Kreu III dhe IV të Marrëveshjes së Partneritetit dhe të Bashkëpunimit.

4. Vendim i Gjykatës Federale të Arbitrazhit të Rajonit të Lindjes së Largët. Çështja N Ф03-A59/01-2/1791 e datës 24 shtator 2001. Shfuqizim i dënimit administrative të Kompanisë “Sakhalinmorneftegas-Shelf”. Përkufizimi i shërbimeve të eksportit në legjislacionin rus. Analogji e legjislacionit, analogji me seksionin IV, kapitulli III dhe i IV i Marrëveshjes së Partneritetit dhe të Bashkëpunimit.

5. Vendim i Gjykatës Federale të Arbitrazhit të Rajonit të Moskës. Çështja N KA-A40/5556-01 e datës 5 Tetor 2001 Pagesa e taksave duke përfutur AO “Ansaldo-VEI”. Përcaktimi i “subsidiaritetit.” Zbatimi i nenit 30 (b) të

Marrëveshjes së Partneritetit dhe të Bashkëpunimit.

6. Vendim i Gjykatës Federale të Arbitrazhit të Rajonit të Moskës. Çështja N KA-A40/8111-05 e datës 31 gusht 2005.

Apelimi i vendimit të Dhomës së Patentave Ruse i cili refuzonte regjistrimin e emrit “compromat.ru”. Kushtet e mbrojtjes së pronësisë intelektuale. Zbatimi i parimit “Cassis” nëpërmjet Protokollit 10 të Marrëveshjes së Partneritetit dhe të Bashkëpunimit.

7. Vendim i Gjykatës Federale të Arbitrazhit të Rajonit të Moskës. Çështja N KA-A40/5565-05 e datës 29 qershor 2005. Apelimi i korporatës “Volvo” (Volvo Personvagnar)” për Vendimin e Dhomës ruse të Patentave. Kushtet e pronësisë intelektuale. Zbatimi i parimit “Cassis” sipas Protokollit 10 të Marrëveshjes së Partneritetit dhe të Bashkëpunimit.

8. Vendim i Gjykatës Federale të Arbitrazhit të Rajonit të Moskës. Çështja N ÊA-A40/824-99 e datës 7 prill 1999. Shfuqizimi i dënimit administrativ të OOO “Popelenskiy dhe partnerët”. Përcaktimi i shërbimeve të eksportit në legjislacionin rus. Analogji e legjislacionit me Seksionin IV, Kreu III dhe IV i Marrëveshjes së Partneritetit dhe të Bashkëpunimit.

9. Vendim i Gjykatës Federale të Arbitrazhit të Rajonit të Moskës. Çështja N A56-11044/98 e datës 8 tetor 1998; Shfuqizimi i dënimit të taksave për OOO “Master Shipping”. Trajtimi për kombin më të favorizuar për shërbimet ndërkufitare. Zbatimi i nenit 36 të Marrëveshjes së Partneritetit dhe të Bashkëpunimit.

10. Vendim i Gjykatës Federale të Arbitrazhit të Rajonit të Moskës. Çështja N A44-1814/03-C9 e datës 11 dhjetor 2003. PAGESA E TAKSAVE PËR PËRFITIMIN E OOO “Amkor Ranch Novgorod”; Përcaktimi i parimit të subsidiaritetit në Rusi nuk është evidente për veprimtarinë ekonomike në Rusi. Zbatimi i nenit 18 të Marrëveshjes së Partneritetit dhe të Bashkëpunimit.

11. Vendim i Gjykatës së Lartë të Moskës. Çështja N 5-Å02-64 e datës 7 qershor 2002. Zbatimi i vendimit të Gjykatës së Lartë në Rusi për çështjen “Moscovskiyy Narodny Bank” ltd. v. GU MNTK “Microkhirurgia glaza”; Zbatimi i nenit 98 dhe 110 të Marrëveshjes së Partneritetit dhe të Bashkëpunimit.

Historiku i Ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë

*Rovena PREGJA (QOSE)
Juriste*

HYRJE

Sistemi gjyqësor përbëhet nga gjykatat, të cilat administrojnë drejtësinë në emër të popullit, një mënyrë kjo për të zgjidhur mosmarrëveshjet mes palëve. Me sistem gjyqësor nënkuptohen gjyqtarët, magjistratët, të gjithë ata që njihen si aktorë të sistemit, sikurse edhe stafi mbështetës i tyre, për një funksionim sa më të mirë të tij. Sipas doktrinës mbi ndarjen e pushteteve, “gjyqësori është ajo degë e pushtetit e cila njihet si përgjegjëse për respektimin e ligjit. Ai zbaton dhe interpreton ligjet e miratuara nga pushteti legjislativ”.

Në një kohë që procesi i reformës në drejtësi nis me amendimin e ligjit për pushtetin gjyqësor si rregullatori kryesor i tij, në vijim po sjellim një përshkrim historik të nisur që prej vitit 1991 përfshirë edhe ligjin e miratuar së fundi nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë¹. Ligji i është nënshtruar disa amendimeve përgjatë viteve duke iu referuar çështjeve të ndryshme të rregulluara prej tij. Në këtë paraqitje historike do të përmendim përkatësisht Dispozitat Kushtetuese të vitit 1991, ligji i vitit 1997, Kushtetuta e vitit 1998,

¹ Ligji është miratuar në datë 18.2.2008 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

ligji i vitit 1998 dhe amendimet e tij të viteve 1999, 2000, 2001², 2003 e 2008, ku si pikë referimi do të merret ligji bazë, ai i vitit 1998.

Në këtë kuadër urojmë që shkrimi t’i shërbejë të gjithë atyre që merren me analiza në fushën e së drejtës, studiuesve, pse ajo dhe ligjbërësve për të pasur një vizion më të qartë në atë se si dhe sa e domosdoshme është ndryshimi i një ligji në kohë dhe hapësirë. Reforma në drejtësi sapo ka filluar dhe çdo mendim dhe opinion vlen dhe duhet vlerësuar për mirë.

Në vijim do të paraqiten në rend kronologjik miratimi dhe amendimet e ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor me nenet përkatëse të ndryshuara në vite.

LIGJI PËR DISPOZITAT KRYESORE KUSHTETUESE 1991

Me rënien e regjimit komunist në Shqipëri ndryshimet u ndien edhe në kuadrin ligjor në vend me miratimin e ligjit për Dispozitat Kryesore Kushtetuese. Ligji sanksionoi ndarjen e pushteteve si parimin themelor të organizimit shtetëror³.

Sipas ligjit “Për dispozitat kushtetuese” të vitit 1991 tashmë pushteti gjyqësor njihet si pushtet i ndarë dhe i pavarur nga pushtetet e tjera⁴. Gjykata tashmë është autoriteti që zgjidh çështjet dhe mosmarrëveshjet të parashikuara në ligj.

Parimet e ligjshmërisë dhe i barazisë para ligjit gjejnë vend në ligj, një risi kjo për legjislacionin shqiptar të kohës së pas viteve ‘90.

Ligji njih ndarjen e pushtetit gjyqësor në tri shkallë: shkallë e parë, apel dhe e lartë⁵ si dhe gjykatat ushtarake.

² Ligji nr.8811, datë 17.5.2001, i cili nuk hyri në fuqi deri një vit më pas, pasi ai u kthye në Kuvend nga Presidenti pa u dekretuar dhe vetëm një vit më pas Kuvendi hodhi poshtë vendimin e kthimit të dekretit.

³ Pushteti legjislativ, ekzekutiv, gjyqësor.

⁴ Neni 1 i ligjit “Për disa ndryshime dhe plotësime në ligjin nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese.”

⁵ Ligji “Për dispozitat kryesore kushtetuese” përdor termin “gjykatë kasacioni”.

Ligji “Për dispozitat kryesore kushtetuese” rregullon kompetencat e Gjykatës së Lartë. Ligji vendos standarde të reja për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor krahasuar me të kaluarën. Kështu, në Dispozitat Kryesore Kushtetuese thuhej se vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara. Ato mund të prishen, të anulohen ose të ndryshohen vetëm me vendim të një gjykate më të lartë. (neni 8, ligji “Për dispozitat kryesore kushtetuese”).

Njihet imuniteti i gjyqtarëve dhe përjashtimi i gjyqtarëve nga gjykimi i një çështjeje. Ligji vendos standarde të reja për autoritetin e prokurorisë, duke krijuar një organ të ri në kompetenca. Kështu, prokuroria është autoriteti që ushtron ndjekjen penale në hetim dhe gjyq. Prokuroria mbron interesat e përgjithshme të shoqërisë, rendit juridik, të drejtat e liritë e shtetasve. Prokuroria organizohet dhe funksionon brenda pushtetit gjyqësor si organ unik dhe i centralizuar (neni 13 i ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”).

Ligji “Për dispozitat kryesore kushtetuese” rregullon edhe organe si KLD-ja dhe njeh profesionin e avokatisë, e cila filloi të jetë pjesë e sistemit gjyqësor në këtë kohë. Avokatia konsiderohej një profesion i lirë.

Pjesë e këtij ligji ishte dhe rregullimi i Gjykatës Kushtetuese, e njohur si autoriteti më i lartë që mbron dhe garanton respektimin e Kushtetutës dhe të legjisllacionit, si dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës (neni 17 i ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”). Ligji rregullon mënyrën e funksionimit të saj, zgjedhjen dhe largimin e anëtarëve, kriteret që duhen të plotësohen prej tyre, një detajim të kompetencave të kësaj gjykate.

Pjesë e standardeve të reja të vendosura me këtë ligj është edhe pavarësia ekonomike e këtij pushteti. Pushteti gjyqësor ka buxhetin e vet që, me propozimin e KM-së, miratohet nga Kuvendi Popullor. (neni 29).

Ky ligj njohu edhe varësinë e administratës gjyqësore nga Ministri i Drejtësisë.

LIGJI I VITIT 1997

Në 18 dhjetor 1997, Kuvendi⁶ i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 8265 “Mbi organizimin e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë,” ligj i cili hyri në fuqi në 23 dhjetor 1997. Ky ligj i parapriu miratimit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në vitin 1998 (28 nëntor 1998). Ligji përmbante parimet bazë të së drejtës siç përmenden: ushtrimi i pushtetit gjyqësor nga gjykatat; ndarjen e gjykatave në tri shkallë; organizimi, drejtimi e funksionimi i gjykatave; kushtet për ushtrimin e detyrës së gjyqtarit dhe prokurorit⁷; roli dhe organizimi i prokurorisë; përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve dhe prokurorëve etj.

KUSHTETUTA E VITIT 1998

Kushtetuta e vitit 1998 (28 nëntor 1998) ishte një hap me tej drejt vendosjes së shtetit ligjor në vend. Ajo mund të konsiderohet një arritje më shumë në kuadrin ligjor juridik në vend pas vendosjes së sistemit të ri demokratik pas lëvizjeve politike të viteve 1990. “Sistemi i qeverisjes në RSH bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor”, citoj nenin 7 të Kushtetutës së vitit 1998.

Kushtetuta sanksionoi parime si prezumimi i pafajësisë gjatë një procesi gjyqësor⁸ dhe përmend të drejta e liri të njeriut që shfaqen dhe realizohen gjatë një procesi gjyqësor⁹.

⁶ Në vitin 1997 në ligj përdorej termi Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë.

⁷ Sipas ligjit të vitit 1997 prokuroria ishte pjesë e sistemit gjyqësor dhe rregullimi i saj bëhej nga ligji “Për organizimin e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë”.

⁸ Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë (neni 8, Kushtetuta).

⁹ P.sh.: askush nuk mund të akuzohet dhe deklarohet fajtor për një veprë penale që nuk njihet si e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj; gjithkush ka të drejtë të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, të ketë lehtësitë e mjaftueshme për mbrojtjen e tij; askush nuk mund të dëshmojë kundër vetvetes; të dëgjohet para se të gjykohet, parimi i gjësë së gjykuar.

Pjesa e nëntë e Kushtetutës së vitit 1998 i kushtohet gjykatave, përkatësisht organizimit të tyre (Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit, gjykatat e shkallës së parë).

Kushtetuta njeh imunitetin e gjyqtarëve; pavarësinë financiare të gjykatave, publicitetin e vendimeve gjyqësore. Organizimi dhe funksionimi i Gjykatës së Lartë zë një vend të konsiderueshëm në këtë kre të Kushtetutës. Për nga rëndësia e këtij organi, Kushtetuta trajton pozitën e gjyqtarëve “të lartë”, emërimin dhe largimin e tyre nga detyra.

LIGJI I VITIT 1998

Ligji Nr. 8265 u shfuqizua në 28 dhjetor 1998 me ligjin nr. 8436 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (ligj i cili, me të gjitha ndryshimet e pësuara në vite, që këtej e tutje në këtë shkrim do të përmendet si “Ligji bazë”), i cili hyri në fuqi në 7 janar 1999. Ky është ligji bazë i pushtetit gjyqësor në Shqipëri. Dy nga arsyet më të mëdha për miratimin e një ligji të ri të pushtetit gjyqësor në këtë kohë ishte nevoja e të përshtaturit të tij me Kushtetutën e re (p.sh. prokuroria nuk ishte më pjesë e juridiksionit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe hallkë e pushtetit gjyqësor në Shqipëri, por tashmë paraqitet si autoritet më vete). Prokuroria është një organ më vete, i pavarur, i centralizuar. Si dhe, gjithashtu, mund të përmendet edhe përshtatja e ligjit për sa i përket trajtimit të gjyqtarëve që nuk kishin arsimin e plotë e të rregullt juridik.¹⁰ Ligji i vitit 1998 e rregulloi këtë pikë me zhvillimin e një provimi kualifikues profesional për gjyqtarët që do të vijonin të ishin

¹⁰ Fillimisht për shumë gjyqtarë përdorej termi “kursantë”, pasi nuk kishin arsimin e rregullt juridik, por kishin hyrë në radhët e gjyqësorit në vitin 1994 pas një kursi gjashtëmujor në periudhën e pranverë-verë 1993. Pas kundërshtimeve të Këshillit të Europës për mënyrën sesi janë trajtuar gjyqtarët me ligjin e vitit 1997, një trajtim tjetër i ndryshëm u caktua më tej: të gjithë gjyqtarët me më pak se dhjetë vjet përvojë iu nënshtruan një testi profesional.

pjesë e sistemit gjyqësor¹¹. Ligji i vitit 1998 ka mbetur në fuqi deri më datën 18.2.2008, azhornuar respektivisht me amendimet e herëpashershme të tij në vite, kohë në të cilën u miratua edhe ligji i ri tashmë në fuqi.

Ligji i 1998 solli ndryshime edhe në terminologjinë e përdorur në ligj. Kështu, ai sanksionoi termin e ri i cili do të përdorej si i tillë në vijim në të gjitha ligjet e mëpasshme, “Gjykatë e Lartë” në vend të “Kasacion”.

Ligji i vitit 1998 sanksionoi ndryshimet në përbërjen e trupit gjykues. Anëtari i trupit gjykues i njohur me termin “ndihmësgjyqtar” u hoq dhe u zëvendësua me “gjyqtar”.

Ligji i vitit 1998 përmend për herë të parë krijimin e gjykatave të veçanta, i cili mungonte në ligjin e mëparshëm, atë të vitit 1997. Në këtë ligj përmendet edhe hartimi i një ligji të veçantë organik për Gjykatën e Lartë.

Ligji i vitit 1998 krijoi pozicionin e kryesekretarit në gjykatat e shkallës së parë dhe ato të apelit, pozicion i cili në këtë ligj është njëzuar për nga funksionet me atë të kancelarit të Gjykatës së Lartë.

Ligji i vitit 1998 sanksionoi në mënyrë të detajuar, krahasimisht me atë të përmendur në ligjin e vitit 1997, rastet e emërimit të gjyqtarëve, të cilët nuk kanë përfunduar studimet në Shkollën e Magjistraturës (shiko shënimet 5 e 6).

AMENDAMENTET E LIGJIT TË VITIT 1998

Ligji i vitit 1999

Amendamentet e para të ligjit bazë nisin me ligjin nr.8546, datë 5.11.1999, ku reflektohen një sërë rrethanash, siç mund të përmendim miratimin e një

¹¹Të gjithë gjyqtarët e shkallës së parë, që kanë punuar si gjyqtarë për më pak se 10 vjet, do t’i nënshtrohen një provimi kualifikimi profesional, teorik dhe praktik, me shkrim e me gojë. Provimi do të organizohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës dhe Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës. Ai do të mbahet jo më vonë se 1 qershori i vitit 1999. Gjyqtarët që nuk e kalojnë provimin, shkarkohen nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Ata gëzojnë të drejtën e ankimit, të parashikuar në nenin 46 të këtij ligji (neni 48, ligji i vitit 1998).

ligji të veçantë për zyrën e buxhetit gjyqësor dhe, gjithashtu, disa ndryshime të tjera në përputhje me Kushtetutën e re, të parregulluara në parë. Amendimet e këtij ligji prekën nenet 5, 14, 17, 20, 22, 28, 33, 42 të ligjit bazë, si dhe u shtuan nenet 14/a e 14/b, 20/a.

Ligji i vitit 1999 solli ndryshime në pozicionin e kryesekretarit të gjykatës, i njohur deri atëherë si administrator i gjykatës dhe solli krijimin e një pozicioni të ri administrativ, atë të kancelarit të gjykatës. Ligji i ri hodhi bazat dhe prezantoi të drejtat dhe detyrat e kancelarit, si një prej figurave më të rëndësishme në administrimin dhe menaxhimin e institucionit të gjykatës.

Ligji i vitit 1999 preku edhe rregullimin e pozicionit të inspektorit të KLD-së. Ligji sanksionoi kompetencat e tyre, ku përkatësisht: Inspektorët kanë për detyrë të inspektojnë gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, të verifikojnë ankesat e shtetasve dhe të subjekteve të tjera për gjyqtarët, të kontrollojnë organizimin dhe punën e shërbimeve gjyqësore, të bëjnë evidentimin e aftësive profesionale të gjyqtarëve, në kuptim të nenit 45 të këtij ligji, ngarkesën në punë dhe në tërësi eficienten e gjykatave.

Më tej në ligj vijohet me rregullimin e çështjes së emërimit të gjyqtarëve të rinj, dhe posaçërisht atyre që janë diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës¹²; rregullimi i kompetencave të KLD-së në përshtatje me dispozitat përkatëse të tij në Kushtetutë. KLD-ja tashmë është një organ kyç në ngritjen dhe kontrollin e sistemit gjyqësor, me kompetenca në emërimin e gjyqtarëve-magjistratë, të gjyqtarëve të apelit, të drejtuesit të gjykatave të 2 shkallëve (të parë dhe të apelit).

Ligji prek edhe masat disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe përkatësisht heqjen e masës së “Ulje në pagë deri në masën 25 për qind për një periudhë nga 3-6 muaj” dhe shtimin e “Transferimin në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel ose të një niveli më të ulët”.

¹² Magjistratët e parë të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës i përkasin vitit 1999

Në të njëjtën datë me hyrjen në fuqi të ligjit nr.8546, por pa u lidhur me të, Gjykata Kushtetuese nxori vendimin nr.59, ku shpalli antikushtetues paragrafin 3 të nenit 48 të Ligjit bazë (1998). Vendimi u zbatua në një kohë (Maj 1999, përkon me kontrollin e gjyqtarëve të shkallës së parë me përvojë më pak se 10 vjet)¹³ e për këtë arsye nuk ishte e nevojshme bërja e ndryshimeve të mëpasshme në ligj.

LIGJI I VITIT 2000

Ligji bazë më tej u amendua nga ligji nr. 8656, datë 31 Korrik 2000, i cili preku nenet 6, 7, 10, 11, 14/b, 17, 24 të tij dhe shtoi nenet 4/a, 25/a, 30/a, dhe 38/a.

Ligji i ri krijoi konceptin e vitit gjyqësor. Data 10 maj u vendos dhe u quajt “Ditë e Drejtësisë”, duke parashikuar organizimin dhe rolin e gjithësecilit aktor në sistemin e drejtësisë në këtë ditë të shënuar, ku përmendim: gjyqtarë, prokurorë, funksionarë të Ministrisë së Drejtësisë, nga Gjykata Kushtetuese, Zyra e Avokatit të Popullit, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë, si dhe nga institucione ose subjekte të tjera, veprimtaria e të cilëve lidhet me fushën e drejtësisë dhe të gjyqësorit. Ligji krijoi Rezolutën e Përbashkët të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Drejtësisë, lidhur me administrimin dhe problemet në fushën e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë, në të cilën, ndër të tjera, jepen edhe orientime dhe rekomandime për veprimtarinë në vitin e ri gjyqësor.

¹³ Një numër gjyqtarësh të njohur si “kursantë” dhe ndoshta edhe të tjerë refuzuan t’iu nënshtroheshin testeve të parashikuara nga neni 48/3 dhe, si pasojë, u larguan nga sistemi, së bashku me disa të tjerë që nuk e kaluan suksesshëm testimin. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese vendosi “Shfuqizimin si antikushtetues të paragrafit të tretë të nenit 48 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, duke mos e justifikuar shkarkimin e këtyre gjyqtarëve.

Ligji i vitit 2000 shtoi numrin e gjykatave të shkallës së parë e atë të krimeve të rënda. Më tej në të vihet re një fjali në nenin 10 të Ligjit duke rregulluar që krimet e rënda të gjykoreshin nga pesë gjyqtarë.

Ligji i vitit 2000, gjithashtu, shtoi një dispozitë ku specifikohet (sikurse edhe në ligjin për Ministrinë e Drejtësisë), që gjyqtarët mund të ushtrojnë detyra në nivele menaxhuese në kabinetin e Ministrit dhe në strukturat juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë dhe se periudha e ushtrimit të tyre në shërbimin civil në këto struktura do të njihet si periudhë e ushtrimit të detyrës së gjyqtarit për qëllime karriere, rregulluar me ligjet e organizimit të pushtetit gjyqësor, të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe Prokurorisë së Përgjithshme.

Ligji i vitit 2000 preku sërish edhe pozicionin e kancelarit të gjykatës, duke synuar një rregullim më të plotë të tij, në çështje të pagës dhe pushimit vjetor të pagueshëm e konkretisht: Kancelari përfiton pagë dhe leje të pagueshme vjetore të njëjtë me atë të gjyqtarit të gjykatës përkatëse ku ushtron funksionet e tij.

LIGJI I VITIT 2001

Efektiviteti i ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” përfshiu disa ndryshime të ligjit për pushtetin gjyqësor.¹⁴ Disa nene të tij u shfuqizuan, të cilat zunë vend në këtë kohë në ligjin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD). Një shembull mund të marrim për emërimin e kryetarëve dhe zëvendëskryetarëve të gjykatave të ulëta (shfuqizuar neni 24/2 i ligjit bazë), në të cilin paraqitet rregullimi i trajtimit të kryetarëve dhe zëvendëskryetarëve sipas disa regjimeve juridike.

¹⁴ Ligji nr.8811 është i datës 17 maj 2001, i cili nuk hyri në fuqi deri një vit më vonë, pasi ai u kthye në Kuvend nga Presidenti pa u dekretuar dhe vetëm një vit më vonë Kuvendi refuzoi dekretin e kthyer.

Vlen të përmendet që një prej neneve të shfuqizuar nga ligji nr.8811 ishte edhe neni 17 i Ligjit bazë, për sa i përket inspektoratit të KLD, por kur u rikalua, ligji nr.8811, në të vërtetë shfuqizoi nenin 1 (“Pushteti gjyqësor ushtrohet vetëm nga gjykatat, në përputhje me Kushtetutën dhe kompetencat e dhëna nga ligji.”) Një tjetër amendim i dukshëm ishte edhe shfuqizimi i nenit 45, paragrafi 3, duke theksuar që një gjyqtar ka të drejtën e ankimit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndaj vendimit përfundimtar të vlerësimit brenda dhjetë ditëve nga marrja e njoftimit. Mund të këtë ekzistuar qëllimi i shfuqizimit të paragrafit të tretë të nenit 48, pasi ky ishte paragrafi i deklaruar si antikushtetues me vendimin 59/1999 të Gjykatës Kushtetuese.

LIGJI I VITIT 2003

Ligji nr. 9111, datë 24.7.2003 ishte ligji tjetër amendues i Ligjit bazë të pushtetit gjyqësor. Ndryshimet i përkisnin neneve 10, 28, 39, si dhe shtoi nenet 39/1 e 39/2. E rëndësishme është të përmendim shtesat e neneve 39/1 dhe 39/2, lidhur me pagesat e gjyqtarëve (gjyqtar, kryetar gjykate, zëvendëskryetar gjykate dhe zëvendëskryetar gjykate në Tiranë, në shkallë të parë dhe apel)¹⁵ një çështje e rregulluar më parë me ligjin nr.7800, datë

¹⁵ Paga fillestare e gjyqtarit në gjykatën e rrethit gjyqësor dhe në gjykatën ushtarake është e barabartë me 50 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

Paga e zëvendëskryetarit të gjykatës së rrethit gjyqësor dhe të gjykatës ushtarake është e barabartë me 57 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

Paga e kryetarit të gjykatës së rrethit gjyqësor dhe të gjykatës ushtarake është e barabartë me 60 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

Paga e Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës është e barabartë me 65 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe ajo e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është e barabartë me 70 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

Paga fillestare e gjyqtarit në gjykatën e apelit është e barabartë me 70 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

2.3.1994, i cili ishte shfuqizuar me ligjin nr. 9111. Ligji pati edhe ndryshime të tjera të vogla.

LIGJI I VITIT 2008

Ligji nr.9877, datë 18.2.2008 përmban amendimet më të fundit të bëra ligjit për pushtetin gjyqësor. Ai sjell disa risi në organizimin e gjykatave; vlerësimin dhe karrierën e gjyqtarëve me qëllim përmirësimin e statusit të tyre; mekanizmat e konkurrencës të gjyqtarëve; pagën dhe elemente të tjera si procedimi disiplinor, që kanë për qëllim përmirësimin dhe funksionimin sa më të mirë të sistemit gjyqësor në vend.

Në mënyrë të veçantë do të përmendim nenet 11, 12, 16, 17, 18, 20 të ligjit të ri lidhur me funksionimin e sistemit gjyqësor dhe veçanërisht normat që rregullojnë karrierën e gjyqtarëve, kriteret e përzgjedhjes dhe kompetencat e kryetarëve të gjykatave të shkallës së parë e të apelit.

Ligji i ri ka rezervuar edhe një parashikim të detajuar për emërimin e gjyqtarëve të krimeve të rënda dhe të gjyqtarit të apelit. Kështu, gjyqtar mund të emërohet vetëm personi që ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës, një ndryshim ky nga ligji i mëparshëm i cili rezervonte të drejtën e emërimit në këtë detyrë edhe të personave që nuk e përmbushnin këtë kriter. Përbashkë bëhet vetëm për personat që kanë ushtruar më parë detyrën e gjyqtarit¹⁶.

Paga e zëvendëskryetarit të gjykatës së apelit është e barabartë me 75 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

Paga e kryetarit të gjykatës së apelit është e barabartë me 80 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

4. Paga e Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Apelit të Tiranë është 80 për qind e pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe ajo e Kryetarit të Gjykatës së Apelit Tiranë është e barabartë me 90 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

¹⁶ Gjyqtar mund të emërohet shtetasi shqiptar, që përmbush kriteret e mëposhtme: a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar; b) të jetë me arsim të lartë juridik; c) të ketë përfunduar Shkollën e Magjistraturës; ç) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për

Ligji i ri përcakton edhe kriteret e emërimit të gjyqtarëve të apelit dhe ata të krimeve të rënda. Kështu, emërohen gjyqtarë të apelit nga KLD-ja personat që: të ketë punuar jo më pak se 7 vjet në gjykatat e shkallës së parë; të jetë dalluar për aftësi profesionale dhe cilësi të larta etiko-morale; të jetë vlerësuar “Shumë mirë” për aftësi profesionale dy herët e fundit; të mos ketë masë disiplinore në fuqi. KLD bazohet në përzgjedhjen e kandidatëve për në Gjykatën e Apelit në paraqitjen e jetëshkrimeve të tyre. Emërohen gjyqtarë të Krimeve të Rënda personat që të kenë punuar jo më pak se 5 vjet në gjykatat e shkallës së parë; të jetë dalluar për aftësi profesionale dhe cilësi të larta etiko-morale; të jenë vlerësuar “Shumë mirë” për aftësi profesionale dy herët e fundit; të mos kenë masë disiplinore në fuqi. Edhe për këta kandidatë përzgjedhja bëhet në bazë të paraqitjes së jetëshkrimeve personale.

Ligji i ri parashikon për herë të parë sistemin e pikëzimit në përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë.

Neni 13 i ligjit të ri bën një rregullim të sistemit të vlerësimit profesional të gjyqtarëve, një nga kompetencat e parashikuara për institucionin e KLD-së, në funksion të sistemit të karrierës së gjyqtarëve. Një rregullim i tillë ishte i nevojshëm tashmë edhe pas miratimit të sistemit të vlerësimit profesional të gjyqtarëve nga KLD. Vlerësimi i aftësive profesionale është: shumë mirë; mirë; pranueshëm dhe i paaftë.

Ligji i ri rregullon edhe pozicionin e kryetarit të gjykatës të shkallës së parë dhe të apelit, duke filluar me përcaktimin e kriterëve në emërimin e tij; qëndrimi në detyrë, shkarkimin dhe mbarimin e mandatit të tyre; si dhe një rikonceptim i detajuar mirëfilli të detyrave të tyre. Vlen të përmendet që kryetar gjykate emërohet personi që: të ketë punuar jo më pak se katër vjet

kryerjen e një vepre penale; d) të ketë cilësi të larta morale dhe aftësi profesionale. Këshilli i Lartë i Drejtësisë mund të emërojë deri në 10 për qind të numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve persona, të cilët kanë punuar më parë gjyqtarë dhe përbushin kriteret e shkronjave “a”, “b”, “ç” dhe “d” të pikës 1 të këtij neni (neni 11 i ligjit 2008).

si gjyqtarë në gjykatat e të njëjtit nivel ose të niveleve më të larta; të jetë vlerësuar “Shumë mirë” nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dy herët e fundit; të mos ketë masë disiplinore në fuqi; të ketë aftësi organizuese dhe menaxhuese; të mos jetë anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Ligji kufizoi në kohë mandatin e kryetarit të gjykatës, duke përcaktuar edhe rastet e mbarimit të tij: Kur jep dorëheqjen; në rastet e parashikuara për largimin nga detyra të gjyqtarëve (jep dorëheqjen; mbush moshën 65 vjeç të daljes në pension; dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi; shkarkohet nga detyra); kur është në pamundësi fizike të ushtrimit të detyrës për më shumë se 3 muaj; kur zgjidhet anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Në nenin 19 të ligjit të ri parashikohet ngritja e një regjistri të veçantë për gjyqtarët pranë KLD-së, i cili përmban: gjenealogjetet e çdo gjyqtari; të dhënat e edukimit të tij akademik; datën e emërimit; pjesëmarrjen në kualifikime dhe trajnime; vendime disiplinore, nëse ka; vlerësimin e tij si gjyqtar; të dhëna për karrierën gjyqësore.

Në mënyrë të veçantë, në ligjin e ri, nenet 26 e 27, përqendrohen në riformulimin e dispozitave për pagën e gjyqtarëve, duke u hequr trajtimi unik e i barabartë për të gjithë gjyqtarët dhe duke vendosur trajtimin individual të tyre; vendosjen e së drejtës së shpërblimit për kryetarët e gjykatave; vendosjen e shpërblimit për kushte të veçanta pune për gjyqtarin dhe kryetarin e Gjykatës së Krimeve të Rënda, vendosjen e shpërblimit për vjetërsinë në profesion për të dyja nivelet e gjykatave, etj. Kështu: paga bazë e gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë është e barabartë me 50 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Pas 5 vjet vjetërsie në shërbim, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit.

Paga bazë e gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë të krimeve të rënda është e barabartë me 50 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Pas 5 vjet vjetërsie në shërbim, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit. Mbi këtë pagë, për kushte të veçanta pune, shtohet 10 për qind. Paga bazë e kryetarit të gjykatës së shkallës së

parë është e barabartë me 50 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Pas 5 vjet vjetërsie në shërbim, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit. Mbi këtë pagë jepet një shtesë për drejtim në masën 10 për qind. Paga bazë e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës dhe e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë të krimeve të rënda është e barabartë me 50 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Pas 5 vjet vjetërsie në shërbim, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit. Mbi këtë pagë, për kushte të veçanta pune, shtohet 10 për qind dhe për drejtimin e gjykatës shtohet 10 për qind.

Paga bazë e gjyqtarit të gjykatës së apelit është e barabartë me 70 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Pas 15 vjet vjetërsie në shërbim, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit. Paga e bazë e gjyqtarit të gjykatës së apelit të krimeve të rënda është e barabartë me 70 për qind të pagës të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Pas 15 vjet vjetërsie në shërbim, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit. Mbi këtë pagë, për kushte të veçanta pune, shtohet 10 për qind. Paga bazë e kryetarit të gjykatës së apelit është e barabartë me 70 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Pas 15 vjet vjetërsie në shërbim, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit. Mbi këtë pagë jepet një shtesë për drejtim në masën 10 për qind. Paga bazë e Kryetarit të Gjykatës së Apelit të Tiranës dhe e kryetarit të gjykatës së apelit të krimeve të rënda është e barabartë me 70 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Pas 15 vjet vjetërsie në shërbim, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit. Mbi këtë pagë, për kushte të veçanta pune, shtohet 10 për qind dhe për drejtimin e gjykatës shtohet 10 për qind, por jo më shumë se paga e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

Ligji i ri në ndryshim nga ai i mëparshmi nuk e detajon organizimin dhe rregullimin e “Ditës së Drejtësisë”, 10 Majin, por mjaftohet vetëm me

përmendjen e saj në një datë të caktuar të parashikuar që në amendimet e mëparshme të Ligjit¹⁷.

Ligji i ri parashikon bazën ligjore për rregullimin e gjykatave administrative, duke i paraparirë hartimit të një ligji të veçantë për to¹⁸ (neni 7 i ligjit 2008).

Ligji i ri parashikon një dispozitë të veçantë edhe për çështjen e riorganizimit gjyqësor, duke plotësuar kështu një vakuum ligjor i cili u vu re me riorganizimin e disa gjykatave të shkallës së parë në vjeshtën e vitit 2007. Tashmë parashikohet që: kur një gjykatë mbyllet ose numri i gjyqtarëve zvogëlohet, për shkak të riorganizimit gjyqësor, gjyqtari mund të transferohet në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel ose më të ulët. Në këtë rast gjyqtari mund të transferohet edhe në institucionet e parashikuara në nenin 28 pika 1 të këtij ligji, duke përfutuar pagën e gjyqtarit. Në rast se transferimi, sipas pikës 1 të këtij neni, është i pamundur, gjyqtari futet në një listë të veçantë dhe ka përparësi emërimi në vendin më të parë vakant që krijohet. Deri në periudhën e emërimit ai merr 100 për qind të pagës.

Në rast se transferimi, sipas pikës 1 të këtij neni, refuzohet ose gjyqtari i përfshirë në listën e veçantë, sipas pikës 2 të këtij neni, ushtron veprimtari, e cila është e papajtueshme me statusin e gjyqtarit, atëherë gjyqtari shkarkohet nga detyra.

PËRFUNDIME

Reforma në drejtësi pati si pikënisje rishikimin e ligjit të pushtetit gjyqësor. Politika arriti konsensusin dhe rezultati ishte një ligj i ri me standarde të pëlqyeshme e të pranueshme për një menaxhim sa më të mirë të sistemit gjyqësor në vend.

Pasqyrimi i ecurisë së ligjit të pushtetit gjyqësor që prej vitit 1991 e deri më sot reflekton në këtë shkrim ndryshimet e bëra kohë pas kohe lidhur me

¹⁷ Neni 2: “Dita e Drejtësisë është 10 Maji”.

¹⁸ Organizimi dhe funksionimi i gjykatave administrative rregullohen me ligj të veçantë.

institute të së drejtës e aktorë të sistemit gjyqësor. Për një reformim të plotë të sistemit lipset sigurisht edhe rishikimi i ligjeve të tjera të fushës.

Në përfundim të këtij prezantimi historik të ligjit për pushtetin gjyqësor vlen të theksohet se ndryshimet përgjatë viteve të Ligjit kanë synuar dhe së fundi synojnë të sjellin një mënyrë të re organizimi dhe funksioni të gjyqësorit. Përcaktimi i kompetencave përkatëse, me qëllim sigurimin e një ndarjeje të qartë dhe të balancuar të përgjegjësive ndërmjet pjesëmarrësve të sistemit, forcimi i dialogut ndërinstitucional dhe bashkëpunimi në gjyqësor dhe aktorëve përkatës me qëllim krijimin e besimit, konsensusit ndërmjet palëve për reformën dhe funksionimin e përmirësuar të sistemit gjyqësor mund të përmenden si rezultate të ndryshimeve të ligjit në vite.

Le të urojmë se kjo analizë do të shërbejë mjaftueshëm në vijimësinë e amendimet dhe rishikimet edhe të ligjeve të tjera organike të pushtetit gjyqësor, gjithnjë duke pasur si model këtë të organizimit të pushtetit gjyqësor.

Reforma në drejtësi është një proces në vazhdim që kërkon kohë dhe dëshirë për t'u realizuar.

BIBLIOGRAFIA

1. Ligj nr. 8265, datë 18.12.1997 “Për organizimin e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë”
2. Ligj nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”
3. Ligj nr.8546, datë 5.11.1999 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”
4. Ligj nr. 8656, datë 31.7.2000 Për disa ndryshime në ligjin nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8546, datë 5.11.1999

5. Ligj nr. 8811, datë 17.05.2001 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”

6. Ligj nr.9111, datë 24.7.2003 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”

7. Ligj nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

8. Vendim nr. 59, datë 5.11.1999 i Gjykatës Kushtetuese

9. Ligji “Për disa ndryshime dhe plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”

10. “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” e vitit 1998.

Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe roli i rëndësishëm i tyre në forcimin e Shtetit të së Drejtës¹

*Dr. Tefta Zaka**

Projekti për nxitjen e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese kaloi në disa faza, ku faza më e rëndësishme është ajo e monitorimit të vendimeve të kësaj Gjykate dhe problemet që kanë dalë në ekzekutimin e këtyre vendimeve.

Fillimisht u bë një analizë e kuadrit ligjor që përfshin kompetencat e Gjykatës Kushtetuese, efektet e vendimeve të kësaj Gjykate dhe ku mbështetet ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Kjo analizë pati në konsideratë faktin se kontrolli kushtetues ka një rëndësi të madhe në forcimin e shtetit të së drejtës dhe Gjykata Kushtetuese është i vetmi juridiksion kompetent në fushën e kontrollit kushtetues, çka e bën edhe më të rëndësishëm ekzekutimin me efikasitet të vendimeve të kësaj Gjykate.

Analiza e dytë konsistoi në studimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese gjatë 5 viteve, pra nga viti 2002-2005, ku u përzgjodhën vendimet më të rëndësishme të zbatuara dhe ato të paekzekutuara, për të cilat do të flasim më poshtë.

Meqenëse tipet, objekti i kontrollit kushtetues dhe efektet e vendimeve të

*Autorja është avokate në studion ligjore “Zaka, Kosta & Tashko”, ish- anëtare e Gjykatës Kushtetuese.

¹ Ky raport është mbajtur në tryezën e organizuar nga QSP dhe MCC, në kuadër të projektit “Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe roli i rëndësishëm i tyre në forcimin e Shtetit të së Drejtës”, mbështetue nga Fondacioni Shoqëria e Hapur, Soros..

Gjykatës Kushtetuese janë të lidhura ngushtësisht me ekzekutimin e tyre, po i trajtojmë shkurtimisht para se të flasim për ekzekutimin e vendimeve të kësaj Gjykate dhe situatën konkrete në Shqipëri, duke u fokusuar në atë pjesë të kontrollit kushtetues që ka të bëjë me vendimet e përzgjedhura për monitorimin e ekzekutimit të tyre.

Meqenëse këto janë pjesë e analizës së kuadrit ligjor, po i trajtojmë në këtë rubrikë.

1. KUADRI LIGJOR I EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Kjo analizë synon parashtrimin e përmbledhur të bazës juridike që rregullon çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë. Analiza fokusohet vetëm në parashtrimin e atyre normave që zbatohen për çështjen objekt shqyrtimi. Për rrjedhojë, vlen të theksohet që në fillim se nuk është pjesë e kësaj analize trajtimi i mënyrës se si jepen vendimet e Gjykatës Kushtetuese, por vetëm parashtrimi i kuadrit ligjor të zbatimit të tyre.

Dispozitat në të cilat mbështetet zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë gjenden në tekstin e Kushtetutës dhe pjesë të tjera të rëndësishme gjenden në akte të tjera juridike që rregullojnë organizimin e funksionimin e Gjykatës Kushtetuese dhe të organeve të tjera shtetërore. Kështu, kuadri ligjor i zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë është:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit Popullor, miratuar me referendum më datë: 22.11.1998 dhe shpallur me dekretin nr. 2260, datë 28.11.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Kushtetuta ka pësuar ndryshime me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007.

- Ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

- Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*neni 87*).

Dispozitat e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë janë normat parësore që rregullojnë çështjet që lidhen me zbatueshmërinë e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Neni 124 i Kushtetutës nxjerr në pah funksionin kryesor të Gjykatës Kushtetuese, që është garantimi i respektimit të Kushtetutës dhe interpretimi përfundimtar i saj. Kjo dispozitë kushtetuese ka lidhje të drejtpërdrejtë me çështjen e zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, pasi këto vendime kanë si qëllim të tyre final garantimin e respektimit të Kushtetutës nga të gjithë subjektet, shtetërorë ose jo.

EFEKTET E VENDIMEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme, e parashikuar kjo në nenin 132 të Kushtetutës, i cili afirmon qartazi se vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme (*erga omnes*) dhe janë përfundimtare. Po ashtu, në këtë dispozitë kushtetuese përcaktohen edhe disa modalitete praktike që lidhen me publicitetin dhe marrjen dijeni të publikut për vendimet e Gjykatës Kushtetuese, si dhe çastin e hyrjes në fuqi të tyre. Kështu, parashikohet se vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare. Në funksion të faktit se Gjykata Kushtetuese ka vetëm të drejtën e shfuqizimit të akteve që shqyrton, kjo e fundit mund të vendosë që ligji ose akti tjetër normativ të shfuqizohet në një datë tjetër. Mendimi i pakicës botohet bashkë me vendimin, por forca detyruese dhe përfundimtare i përket gjithnjë vendimit të marrë nga shumica.

Në nenin 145 të Kushtetutës përcaktohet qartazi një nga elementet bazë të ekzekutueshmërisë së vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Ky nen përcakton se **vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjitha gjykatat**. Kjo nuk është gjë tjetër veçse një riafirmim i forcës detyruese *erga omnes* të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, por tashmë drejtuar në mënyrë specifike gjykatave (*gjykatave të shkallës së parë, të apelit dhe Gjykatës së Lartë*).

Pra, të gjitha vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë drejtpërdrejt të zbatueshme nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, për të gjitha çështjet me të cilat ato kanë lidhje dhe ndikojnë.

Siç u përmend edhe më sipër, ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, duke qenë se është një ligj organik, rregullon aspekte mjaft të rëndësishme të karakterit procedural në lidhje me veprimtarinë efektive të Gjykatës Kushtetuese. Është vetë neni 1 i këtij ligji përcakton ndër të tjera se objekt i tij është edhe përcaktimi i rregullave bazë që lidhen me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Neni 26 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatës kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, nuk bën gjë tjetër veçse ripërcakton fuqinë juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, ky nen përcakton edhe rregullin se, kur vendimi ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të individit, Gjykata mund të vendosë që ai të hyjë në fuqi me shpalljen e tij. Mjaft i rëndësishëm paraqitet edhe përcaktimi se organi që boton Fletoren Zyrtare detyrohet të bëjë botimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, jo më vonë se 15 ditë nga ardhja për botim e tyre pranë atij organi. Një rregull i tillë mundëson publikimin dhe bërjen të njohur për publikun dhe organet shtetërore, në një kohë të shkurtër, të përmbajtjes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese që është shprehur për një çështje të caktuar. Po ashtu, ky detyrim lidhet edhe me faktin se në Kushtetutë përcaktohet se vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Neni 45 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, parashikon disa modalitete të posaçme që lidhen me rastin kur Gjykata Kushtetuese urdhëron pezullimin e zbatimit të ligjit ose aktit. Ky pezullim vazhdon derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi. Kjo dispozitë paraqet rëndësi të veçantë dhe lidhet drejtpërdrejt me zbatueshmërinë e vendimeve të ndërmjetme të Gjykatës Kushtetuese (*ndonëse ligji nuk e përdor një*

term të tillë) që jepen nga Gjykata, kryesisht ose me kërkesë të palës, kur vlerësohet se zbatimi i ligjit ose i aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërorë, shoqërorë ose të individëve, sipas rastit. Në kuadër të zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, efekti i tyre *ex tunc* apo *ex nunch*, merr një përmasë mjaft të rëndësishme dhe me ndikime të vërteta praktike. Në lidhje me këtë element, ligji organik i Gjykatës Kushtetuese, në nenin 76 të tij, paragrafi i parë, përcakton efektin *ex nunch* të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, ndërsa në paragrafin e dytë të tij (*që përbëhet nga tre nënparagrafë*) përcaktohen raste specifike, kur zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese ka efekt *ex tunc*.

Nga ana tjetër, në nenin 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” përcaktohet se në rastin e shfuqizimit të vendimeve gjyqësore të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, këto vendime nuk do të kenë më fuqi që nga çasti i shpalljes së tyre dhe për pasojë çështja i dërgohet për rishqyrtim gjykatës, vendimi i së cilës është prishur.

Në kuadër të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, në nenin 78 të ligjit të sipërpërmendur, përcaktohet se kur vendoset shfuqizimi i ligjit ose aktit dhe marrëdhëniet e lindura kërkojnë rregullim juridik, vendimi i Gjykatës Kushtetuese i njoftohet organeve përkatëse që të marrin masat e parashikuara në vendimin e saj. Ky njoftim është pjesë e detyrimit që kanë organet, të cilave iu drejtohet vendimi, që të bëjnë ekzekutimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim. Është e qartë se në rastin e shfuqizimit të një dispozite ligjore ose një ligji, kur lënda mbetet e parregulluar ligjërisht, është detyrë e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë që të nxjerrë ligjet përkatëse zëvendësuese që të jenë në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Efekt tjetër i rëndësishëm *ex tunc* që i jepet vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe që ndikon drejtpërdrejt në zbatimin e tyre, lidhet me vendimet që jep Gjykata Kushtetuese **për interpretimin përfundimtar të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe që kanë efekt prapaveprues.**

2. ANALIZA E VNDIMEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Një pjesë e rëndësishme e Projektit për nxitjen e zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është edhe analiza e disa vendimeve të përzgjedhura në studimin e bërë për vitet 2002 – 2007. Vetëm për vendimet e pranimit dhe të interpretimit kushtetues. Nga studimi ka rezultuar që në afërsisht 100 vendime pranimi të marra nga Gjykata Kushtetuese në 5 vjet, rreth 12 për qind e tyre janë të paekzekutuara. Pra, vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë ekzekutuar nga organet përkatëse dhe vetëm në pak raste nuk ka gjetur vend ekzekutimi i tyre. Ne morëm rastet më tipike dhe të konsideruara si më të rëndësishme dhe që ende nuk janë ekzekutuar.

Qëllimi i këtij studimi nuk është analiza për përmbajtjen e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, por analiza e shkaqeve që kanë çuar në mosekzekutimin e disa prej vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” parashikon disa mekanizma të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në varësi të objektit dhe institucionit që detyrohet t’i zbatojë ato. Në këtë këndvështrim metodologjia e përdorur në përzgjedhjen e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese ka synuar të mbulojë të gjitha institucionet që kanë detyrimin t’i zbatojnë ato, si dhe të gjitha subjektet që kanë të drejtë t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese.

Analiza shërbeu si një material ndihmës në procesin e monitorimit të disa vendimeve të paekzekutuara. Megjithatë, u pa e arsyeshme që në këtë analizë të përfshihen dhe disa vendime të ekzekutuara. Kjo për faktin se rezultoi që i njëjti organ të ketë mbajtur qëndrime të ndryshme ndaj vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, pra herë i ka ekzekutuar dhe herë jo.

Për secilin vendim të përzgjedhur është bërë një përshkrim i shkurtër i shkaqeve të antikushtetueshmërisë së aktit që kundërshtohet.

Kjo mënyrë e analizës së shkaqeve të dhëna në arsyetimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese është përdorur sepse është e rëndësishme të theksojmë që vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë një specifikë në drejtim të

ekzekutimit të tyre. Në vendimet e gjykatave të zakonshme ekzekutimi bazohet vetëm në dispozitivin e vendimit dhe organi kompetent ekzekuton vendimin gjyqësor bazuar në dispozitivin e vendimit.

Në rastin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, ekzekutimi i shtrin efektet e tij edhe mbi arsyetimin e vendimit.

Më poshtë po paraqesim vetëm vendimet e paekzekutuara dhe pa një analizë të hollësishme, e cila është paraqitur në një material të veçantë.

I. VENDIMI NR. 9, DATË 26.2.2007 (V – 9/07)

1. Objekti i vendimit: “Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i neneve 1, 2 (pikat 5 e 6), 7 (shkronjat “a, b”) e 9 të ligjit nr. 9481, datë 16.02.2006 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9418, datë 20.05.2005 “Për sigurimet shoqërore suplementare të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

2. Gjykata Kushtetuese vendosi :

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të neneve 1, 7 (shkronjat “a, b”) e 9 të ligjit nr. 9481, datë 16.2.2006 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9418, datë 20.5.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

EKZEKUTIMI I VENDIMIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Në arsyetimin e vendimit të saj Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se shfuqizimi i dispozitave objekt gjykimi krijojnë një zbrazëti lidhur me pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe për pensionet e pleqërisë të ushtarakëve. Bazuar në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i

rekomandon Këshillit të Ministrave e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të bëjnë rishikimin në tërësi të ligjit në përputhje me këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese.

Në aspektin e ekzekutimit ndodhemi para një situatë që dispozitivi i vendimit vetëm shfuqizon dispozitat objekt shqyrtimi. A ndodhemi në këtë rast para një vendimi që kërkon ekzekutim.

Në referim të nenit 78 të ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000, kur vendoset shfuqizimi i ligjit ose aktit dhe marrëdhëniet e lindura kërkojnë rregullim juridik, vendimi i Gjykatës Kushtetuese i njoftohet organeve përkatëse që të marrin masat e parashikuara në vendimin e saj.

Në këtë rast mendojmë që ndodhemi para një vendimi të paekzekutuar sepse zbrazëtia ligjore e krijuar për shkak të shfuqizimit të dispozitave, objekt shqyrtimi, duhet të ishte plotësuar. Detyrimi në këtë rast është për Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

II. VENDIMI NR. 16, DATË 27.04.2007 (V – 16/07)

1.Objekti i këtij vendimi është : “Shfuqizimin si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr. 154/2, datë 31.03.2004 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nr. 15, datë 29.06.2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.”

2.Gjykata Kushtetuese vendosi :

- Pranimin e kërkesës dhe shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr. 154/2, datë 31.03.2004 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nr. 15, datë 29.06.2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Këshillin e Lartë të Drejtësisë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

III. VENDIMI NR.17, DATË 12.11.2004 (V – 17/04)

1. Objekt i këtij vendimi është : “Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr.130, datë 27.05.2002 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nr.83, datë 18.11.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë”.

2. Gjykata Kushtetuese vendosi :

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr.130, datë 27.05.2002 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nr.83, datë 18.11.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

- **Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Këshillin e Lartë të Drejtësisë.**

IV. VENDIMI NR.11, DATË 02.04.2003 (V – 11/03)

1. **Objekt i këtij vendimi është:** “Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.99, datë 20.12.2000 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nr.25, datë 04.04.2001 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë”.

2. Gjykata Kushtetuese vendosi:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.99, datë 20.12.2000 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nr.25, datë 04.04.2001 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;

- **Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Këshillin e Lartë të Drejtësisë.**

EKZEKUTIMI I VENDIMEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Të tri vendimet e sipërpërmendura të Gjykatës Kushtetuese kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe shfuqizimin e vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që i kanë gjykuar ato, të cilat kanë pasur si objekt shkarkimin e gjyqtarëve nga detyra për shkaqet e analizuara në vendimet e tyre dhe si pasojë e kontrollit të ushtruar në gjykatat përkatëse.

Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se procesi i zhvilluar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për shqyrtimin e të tri rasteve të mësipërme ka cenuar të drejtën e gjyqtarëve për një proces të rregullt ligjor, sipas argumenteve që janë renditur në të tri vendimet e sipërpërmendura.

Në mbrojtje të të drejtave të gjyqtarëve, të cenuara nga këto vendime, Gjykata Kushtetuese, pasi ka pranuar kërkesën për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve të KLD-se, ia ka kthyer për rishqyrtim kësaj të fundit.

Nga verifikimi i bërë ka rezultuar se KLD-ja nuk i ka zbatuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese të marra përkatësisht në vitet 2003, 2004 dhe 2007, sepse nuk i ka rishqyrtuar çështjet në fjalë.

V. VENDIM NR.75, DATË 19.04.2002 (V-75/02)

1. Objekt i këtij vendimi është: “Interpretimi përfundimtar i neneve 128, 140, 149, pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë”.

2. Gjykata Kushtetuese vendosi:

- Interpretimin brenda kufijve të objektit të kërkesës të neneve 128, 140 dhe 149 pika 2 të Kushtetutës në këtë mënyrë:

1. Shprehja “*akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën...*”, parashikuar nga nenet 128, 140 dhe 149, pika 2 të

Kushtetutës përmbledh në vetvete një sërë elementesh, të cilët mund dhe duhet të identifikohen rast pas rasti nga organi përkatës që merr vendimin për shkarkimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe Prokurorit të Përgjithshëm. Ato janë të lidhura me aktet dhe sjelljet e parregullta e të padenja që këta funksionarë të lartë kryejnë gjatë ushtrimit të detyrës, për shkak të saj, por edhe jashtë detyrës. Këto veprime ose mosveprime që analizohen në bazë të rrethanave të kryerjes së tyre, momentit subjektiv si dhe nga dëmet që ato i sjellin shoqërisë e shtetit, janë të asaj natyre që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese nga këto subjekte.

2. Shprehja *“shkelje e rëndë e ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve”* nga Prokurori i Përgjithshëm, parashikuar nga neni 149, pika 2 të Kushtetutës lidhet me një sërë elementesh që kanë të bëjnë me ato shkelje të dispozitave ligjore të kryera gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj. Këto shkelje marrin karakterin e rëndë të tyre lidhur ngushtë me rëndësinë e ligjit të shkelur, me pasojat e ardhura ose që mund të vinin nga shkelja, me frekuencën e shkeljes, kohëvazhdimin e pasojave dhe të vështirësive për riparimin e tyre, si dhe me qëndrimin subjektiv që mban autori i shkeljes kundrejt saj dhe pasojës së ardhur.

3. Në përcaktimin e procedurave të shkarkimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, organet përkatëse duhet të respektojnë rregullat për aq sa parashikohet në Kushtetutë, në ligjet organike të tyre, si dhe në aktet e tjera ligjore. Në ndërmarrjen e procedurave për shkarkimin e këtyre funksionarëve kusht thelbësor mbetet respektimi i së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42/1 i Kushtetutës”.

VI. VENDIM NR.76, DATË 25.04.2002 (V-76/02)

1. Objekti i këtij vendimi është : “Shfuqizimi si antikushtetues i Vendimit nr.20, datë 19.03.2002 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

dhe i Dekretit nr.3276, datë 25.03.2002 të Presidentit të Republikës”.

2. Gjykata Kushtetuese vendosi :

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.20, datë 19.03.2002 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe të dekretit nr.3276, datë 25.03.2002 të Presidentit të Republikës.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

EKZEKUTIMI I VENDIMEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Në rastin e dy vendimeve të sipërpërmendura që janë inicuar për shkak të procedurave të ndjekura nga Kuvendi dhe Presidenti i Republikës për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm në vitin 2002 rezulton që vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.75, datë 19.04.2002 është ekzekutuar përsa i përket normimit të procedurave parlamentare që kanë të bëjnë me shkarkimin e Presidentit të Republikës, Prokurorit të Përgjithshëm dhe anëtarëve të Gjykatës së Lartë. Në Rregulloren e Kuvendit është përcaktuar e gjithë procedura e dëgjimit të funksionarëve të lartë.

Ndërsa përsa i përket vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.76, datë 25.04.2002 që ka të bëjë me procedurën konkrete të dëgjimit të Prokurorit të Përgjithshëm për shkak të procesit të parregullt ligjor të zbatuar nga Kuvendi gjatë procedurës së shkarkimit të tij, nuk është ekzekutuar. Për më tepër, pas daljes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese, në vend që të zbatohet vendimi i sipërpërmendur, u procedua me emërimin e Prokurorit të ri të Përgjithshëm.

VII.VENDIMI NR. 6 DATË 31.3.2006 (V – 6/06)

1.Objekti i vendimit: “Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese, për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit

gjyqësor të formës së prerë.”

2. Gjykata Kushtetuese vendosi:

-Pranimin e kërkesës së kërkuesit Enver Memishaj, për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese, për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszbatimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, **nga Bashkia Tiranë dhe Zyra e Përmbartimit Tiranë.**

-Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

EKZEKUTIMI I VENDIMIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për detyrimin e organeve përkatëse për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nëpërmjet të cilit kërkuesi ka fituar të drejtat e tij është mjaft i rëndësishëm në kushtet kur mjaft vendime gjyqësore janë të paekzekutuara. Ky vendim vjen pas qëndrimit që mbajti Gjykata e Strasburgut për këto raste dhe ka një rëndësi të dyfishtë: e para, sepse e përcaktoi ekzekutimin e vendimit si pjesë të procesit të rregullt ligjor dhe realizim të të drejtës së individit, por së dyti, mund të shërbejë edhe si një nxitje për ekzekutimin e vendimeve të tjera gjyqësore, për të cilat shteti shqiptar mund të marrë gjoba të konsiderueshme.

Me gjithë sensibilitetin, me keqardhje mund të themi që ky vendim ende nuk është ekzekutuar.

Dy organe janë të detyruara ta zbatojnë atë, Bashkia e Tiranës dhe Zyra e Përmbartimit, në kushtet kur nuk është ekzekutuar vullnetarisht. Nga verifikimi i bërë rezulton se Bashkia e Tiranës nuk pranon ta ekzekutojë, sepse e konsideron të ekzekutuar, ndërsa përmbartimi e mban në proces, duke zvarritur edhe ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Mendojmë që vendimi i Gjykatës Kushtetuese është i një lloji të veçantë në këtë rast, sepse detyron organin të ekzekutojë një vendim tjetër pa

shfuqizuar një akt ose një vendim tjetër gjyqësor .

Rruga e ndjekur nga kërkuesi ka qenë edhe ajo e procedimit penal për shpërdorim detyre ndaj palëve që kanë pasur detyrimin ta ekzekutojnë atë.

VIII. VENDIMI NR. 19, DATË 03.05.2007

1. Objekti i vendimit: “Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të nenit 1 pika 1; të nenit 4; të nenit 7 pika 2; të nenit 9; të nenit 10 pikat 1, 2 përsa përfshijnë edhe institucionet e pavarura kushtetuese; si dhe të nenit 20 të ligjit nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”.

2. Gjykata Kushtetuese vendosi:

Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të nenit 1/1, nenit 4, nenit 7/2, nenit 9, nenit 10/1, 2 dhe nenit 20 të ligjit nr. 9584, dt. 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, vetëm për sa i përket institucioneve të pavarura kushtetuese.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

EKZEKUTIMI I VENDIMIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Megjithëse vendimi i Gjykatës Kushtetuese vetëm shfuqizon dispozitat e ligjit përkatës, pra nuk ka një detyrim të organit të kryejë veprime për ta ekzekutuar atë, u morr informacion nga drejtoria juridike e Këshillit të Ministrave për të parë nëse ligji ishte zbatuar edhe për institucionet e pavarura kushtetuese dhe rezultoi se ligji është zbatuar vetëm për institucionet e pavarura të krijuara me ligj, ndërsa institucionet kushtetuese, nga informacioni i marrë prej tyre, e pasqyrojnë vendimin e Gjykatës Kushtetuese në buxhetet përkatëse.

Nga elementet e arsyetimit të këtij vendimi del e qartë se Qeveria në hartimin dhe Kuvendi në hartimin e miratimin e ligjeve që prekin çështje organizative, funksionale e financiare të institucioneve kushtetuese duhet të mbajnë parasysh të gjithë këto elemente të pavarësisë së institucioneve kushtetuese dhe duke respektuar shumicën specifike prej 3/5 të të gjithë anëtareve të Kuvendit që kërkohet për ndryshimin e ligjeve të tyre organike.

IX. VENDIMI NR. 29, DATË 21.12.2006

1. Objekti i vendimit: “Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet qeverisjes vendore (Bashkia Tiranë) dhe pushtetit qendror (Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Policia e Ndërtimit).

2. Me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes kompetencave, shqyrtimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën dhe me Kartën Europiane të Autonomisë Vendore si dhe shfuqizimin e

a) neneve 9, paragrafi i parafundit, 10, 19, 21, 54 (fjalja “apo Policia e Ndërtimit”), 75/2 të ligjit nr.8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”;

b) neneve 2, (fjalja “Policia e Ndërtimit varet nga Ministria që mbulon veprimtarinë në fushën e urbanistikës e të ndërtimit”), 3/3 (fjalja “të marrë vendim për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm”) dhe nenin 6, të ligjit nr.8408, datë 25.9.1998 “Për Policinë e Ndërtimit”.

3. Interpretimi përfundimtar i nenit 13 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

2. Gjykata Kushtetuese vendosi:

1. Zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës të krijuar ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Punëve Publike, Transportit e Telekomunikacionit dhe Policisë Ndërtimore, duke përcaktuar, për çdo rast konkret, organin që ka në kompetencë shqyrtimin e çështjeve, objekt i kësaj mosmarrëveshjeje:

a) Shqyrtimi dhe miratimi i lejeve të ndërtimit, si çështje të planifikimit dhe menaxhimit urban që përfshihen në konceptin ligjor “*funksionet e veta*”, janë kompetencë e plotë dhe ekskluzive e organeve të qeverisjes vendore.

b) E drejta e shfuqizimit të akteve të paligjshme të KRRT-ve që funksionojnë pranë organeve të qeverisjes vendore është kompetencë e organeve të pushtetit gjyqësor.

c) KRRT-ja është organ i specializuar për urbanistikën që ushtron funksionin dhe kompetencat e tij vendimmarrëse në fushën e planifikimit dhe të menaxhimit urban, nën autoritetin e pushtetit vendor.

ç) Të drejtën për të vendosur për prishjen e volumit të punimeve të ndërtuara jashtë projektit të miratuar e ka Këshilli i Rregullimit të Territorit pranë organeve të qeverisjes vendore.

d) Kontrolli i zbatimit të standardeve teknike mbi territorin është në kompetencë të Policisë Ndërtimore që vepron si organ i pavarur nga pushteti qendror, por nën autoritetin e organeve të qeverisjes vendore.

2. Të deklarojë të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me Kartën Europiane të Autonomisë Vendore, si shkak i lindjes së mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore, dispozitat ligjore të mëposhtme:

a) Në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të neni **9**, paragrafi i parafundit, frazën “*Lejet e ndërtimit për objekte të rëndësishme në qendrat e qyteteve, studimet urbanistike të të cilave miratohen prej tij*”, nenin **10, 19**, si dhe të neni **54**, fjalët “*apo Policia e Ndërtimit*”;

b) Në ligjin nr.8408, datë 25.9.1998 “Për Policinë e Ndërtimit”, të neni **2**, frazën “*Policia e Ndërtimit varet nga Ministria që mbulon veprimtarinë në fushën e urbanistikës e të ndërtimit*”, si dhe nenin **6**.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Ekzekutimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese

Ky është një vendim kompleks i Gjykatës Kushtetuese i cili trajton marrëdhëniet ndërmjet pushtetit qendror dhe atij vendor dhe caqet e ndërhyrjeve ligjvënëse nën dritën e Kushtetutës. Pajtueshmëria e akteve ligjore është parë në kuptim të nenit 13 të Kushtetutës dhe të Kartës së Autonomisë Vendore. Përmes këtij kontrolli kushtetues, Gjykata ka caktuar se kujt organi qendror ose vendor mund t'i përkasë cila nga kompetencat ligjore në shqyrtim. Rasti ka rëndësi përtej zgjidhjes së çështjes në fjalë, pasi shërben për vendosjen e standardeve që lidhen me të gjitha çështjet ligjore të trajtuara më lart dhe të cilat duhen mbajtur parasysish nga ekzekutivi dhe legjislativi në rregullime të ardhshme të ngjashme.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese konsiderohet i ekzekutuar pas ndryshimeve që iu bënë ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën në 17.12.2007.

X. VENDIMI NR.3, DATË 11.2.2004

1. Objekti i vendimit: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i neneve 86 dhe 87 të Kodit Penal”

2. Gjykata Kushtetuese vendosi:

“Rrëzimin e kërkesës” të paraqitur nga Gjykata e Lartë.

Ekzekutimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese

Këtë rast e marrim në shqyrtim për shkak të specifikës që ai ka. Në parim vendimet e rrëzimit nuk kanë nevojë për ekzekutim. Por më poshtë do të shpjegoj pasojat që kanë sjellë ndryshimet e bëra në Kodin Penal në vitin 2007.

3. Procesi i monitorimit të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

Metodologjia e përdorur gjatë procesit të monitorimit të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese konsistoi në dy drejtime: nëpërmjet përgatitjes së disa pyetësorëve specifikë për çdo rast dhe nëpërmjet takimeve

të drejtpërdrejta me personat që merren drejtpërdrejt me zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese ose dhe drejtues dhe ish-drejtues të tyre që kanë qenë në funksione në kohën e daljes së vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Në këtë proces u konsiderua e rëndësishme që të grupohen vendimet sipas subjekteve që janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Në këtë mënyrë u analizua situatë konkrete dhe argumentet që dha secili prej tyre në rastet e moszekutimit të vendimeve të kësaj Gjykate.

Vlen të përmendet se nga analiza e vendimeve në 5 vite dhe nga bisedat e drejtpërdrejta me institucionet përkatëse ndihet që ka një sensibilizim të përgjithshëm për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, pa pasur një organ tjetër që të realizojë këtë ekzekutim. Sigurisht, Kushtetuta parashikon në mënyrë të qartë karakterin detyrues të këtyre vendimeve dhe një pjesë e tyre nuk kanë nevojë për veprime të mëtejshme të organeve që detyrohen t'i zbatojnë ato (siç është rasti i shfuqizimit të dispozitave kur nuk krijojnë zbrazëti ligjore), por në raste të tjera organet e detyruara në vendim duhet të ndër marrin veprime, për të ekzekutuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Këtë detyrim e gjejmë më evident në rastet e vendimeve për proces të rregullt ligjor, kur organet përkatëse duhet të rifillojnë procedurat, të cilat janë zhvilluar në shkëlqje të drejtave të individëve kërkues.

Neni 131, shkronja "f" e Kushtetutës, parashikon se Gjykata Kushtetuese bën gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Më poshtë po trajtojmë disa nga subjektet që kanë pasur detyrimin për të ekzekutuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese të marra në 5 vitet e fundit.

KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Gjykata Kushtetuese ka marrë një sërë vendimesh të detyrueshme për t'u zbatuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) dhe një pjesë e tyre janë

ekzekutuar nga KLD-ja dhe nga Gjykata e Lartë, si vendimet nr.43 dhe nr.48 të vitit 1999 që kanë të bëjnë me mospjesëmarrjen në gjykimin që zhvillohet në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të anëtarëve të kësaj Gjykate të cilët janë edhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kur shqyrtohet ankesa e gjyqtarit ndaj masës disiplinore të marrë nga Këshilli, vendimi nr.59, datë 05.11.1999, që deklaroi se vlerësimi vetëm i rezultatit të provimit pa marrë parasysh rezultatet në punë të gjyqtarit dhe kontributin e tij teorik e praktik në fushën juridike, është një qëndrim antikushtetues. Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se pamjaftueshmëria profesionale është koncept më i gjerë se mosmarrja e një provimi dhe se ky i fundit nuk mund të jetë tregues i vetëm sintetik i vlerësimit të aftësisë profesionale të gjyqtarit, vendimi nr.11, datë 27.05.2004, lidhur me të drejtën e Ministrit të Drejtësisë për të kryer inspektime dhe në përfundim të nisë procedimin disiplinor, kur vërteton shkelje që passjellin përgjegjësi disiplinore, vendim në të cilin Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se kjo kompetencë nuk përbën ndonjë zgjidhje me karakter antikushtetues, sepse nuk vjen në kundërshtim me nenet 7 e 145 të Kushtetutës.

Por një pjesë e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese që janë iniciuar me kërkesë të gjyqtarëve si individë nuk janë ekzekutuar. Jo pa qëllim kam përmendur vendimet e ekzekutuara para vitit 2002, vit në të cilin ne kemi bërë studimin, sepse rezulton që në këtë periudhë të këtë dhe vendime të tjera të Gjykatës Kushtetuese të paekzekutuara nga KLD-ja, të cilat kanë sjellë vështirësi në ekzekutimin e vendimeve të fundit, sepse kanë natyrë të njëjtë me to.

Këtu mund të përmendim çështjen e gjyqtarëve Xh. Balavia ku Gjykata Kushtetuese ka shqyrtuar ankimin e 10 gjyqtarëve, të cilët ishin liruar nga detyra e gjyqtarit me motivacionin për shkelje të rëndë të disiplinës në punë, për shkelje të etikës së gjyqtarit, për shkelje të ligjit dhe paaftësi në detyrë.

Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.15, datë 03.06.1997, ka vendosur

detyrimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë të rishqyrtojë çështjet e kërkuarve të mësipërm, duke iu dhënë atyre mundësi të ushtrojnë të drejtën e mbrojtjes.

Këta gjyqtarë kanë bërë dhe bëjnë vazhdimisht kërkesë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë për t’iu rishqyrtuar çështja e tyre, por kërkesa e tyre e bërë në zbatim të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nuk është marrë në konsideratë.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka arsytuar se nuk i kthehet me vendimeve të marra prej tij dhe aq me tepër atyre vendimeve të lëna në fuqi nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si instancë ankimi, por këta gjyqtarë do të konsiderohen të padënuar disiplinarisht nga Këshilli dhe do të trajtohen njësoj me personat e tjerë (gjyqtarët ose juristët) që plotësojnë kriteret dhe do të konkurrojnë pa ndonjë pengesë për vendet vakante që do të hapen në të ardhmen.

Përsa i përket vendimeve të fundit, që i kam përmendur tek analiza e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, ndodhemi në të njëjtën situatë.

Gjyqtarët A. Kalia dhe A. Aliaj, M.Mishgjoni dhe A.Capo janë shkarkuar nga detyra e gjyqarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës, “Për kryerje të veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës”. Gjykata Kushtetuese ka vendosur shfuqizimin e vendimeve të Kolegjeve të Bashkuara dhe të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si dhe dërgimin e çështjeve për shqyrtim pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për proces të parregullt ligjor, sepse: gjyqtarët nuk janë njohur me materialet e procedimit disiplinor, nuk janë respektuar rregullat procedurale që lidhen me të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur. Këshilli i Lartë i Drejtësisë e ka paragjykuar çështjen, duke cenuar parimin e prezumimit të pafajësisë, gjyqtari nuk mund të shkarkohet nga detyra për mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit, për sa kohë që nga rrethanat objektive e subjektive nuk rezulton se veprimet e tij mund të kenë qenë të qëllimshme dhe në kundërshtim të hapët e flagrant me ligjin ose me praktikat unifikuese të gjykatave me të larta etj.

Gjatë fazës së monitorimit të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës

Kushtetuese kam marrë kontakt me nëpunës të KLD-së për të marrë të dhëna për shkaqet që kanë detyruar KLD-në të mosekzekutojë vendimet e Gjykatës Kushtetuese, për të rihapur procedurën e dëgjimit të gjyqtarëve, duke zhvilluar në këtë mënyrë një proces të rregullt ligjor. Argumentet nuk ishin të shumtë, por si shkak kryesor dilte vështirësia për të rigjykuar edhe njëherë këta gjyqtarë, sepse dhe vendet e tyre të punës tashmë janë zënë.

Një nga informacionet më të rëndësishme në këtë drejtim e mora nëpërmjet komunikimit me ish-Kryetarin e KLD-së zotin Ilir Panda. Ai ishte tepër i ndjeshëm për këtë problem, i cili ishte diskutuar edhe në KLD, por ishte konsideruar i vështirë rigjykimi i të gjitha rasteve nga KLD-ja, sepse procedimet e padrejta disiplinore të gjyqtarëve, kryesisht për proces të parregullt ligjor datonin që në vitin 1994. Pra, shkak kryesor i mosekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, e cila detyronte KLD-në të rishqyronte çështjet, lidhej me numrin e madh të tyre. Problemi i ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese ishte diskutuar edhe në KLD, por nuk morri zgjidhje për të njëjtin argument.

Nga informacione me gjyqtarët e proceduar rezulton që ata i janë drejtuar KLD-se me kërkesa që çështjet e tyre të trajtohen nga KLD-ja në zbatim të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, por deri tani nuk kanë gjetur zgjidhje.

Sipas informacioneve që kam marrë nga Gjykata e të Drejtave të Njeriut në Strasburg rezulton që M.Mishgjoni (ish-gjyqtare) i është drejtuar Gjykatës së Strasburgut. Nga materialet e studiuara rezulton se kërkuesja Mishgjoni ka pretenduar në kërkimin e saj se i është drejtuar KLD-së më 28 dhjetor 2004 për të rishqyrtuar shkarkimin nga detyra si gjyqtare në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, por deri në këtë moment nuk rezulton që të ketë një procedurë të tillë.

Duke e parë KLD-në si një institucion të rëndësishëm në zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, kam marrë kontakt edhe me nënkryetarin aktual të KLD-së.

Çështja e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është në

rend të ditës për këtë institucion. Ajo është përfshirë në strategjinë 5-vjeçare të KLD-së, e prezantuar në dhjetor 2007 dhe është futur në rendin e ditës për t'u zgjidhur gradualisht. Nënkryetari prezantoi vështirësitë e krijuara në praktikë për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të marra në vite, sepse nuk ka vende vakant tashmë, por njëkohësisht kjo do të pengojë reformimin e gjyqësorit për të futur elemente të rinj dhe të përkushtuar për drejtësinë. Pra vullneti i institucionit është i plotë për ekzekutimin e vendimeve dhe shkaku i vetëm është vështirësia praktike. Zbatimi i vendimeve do të bëhet rast pas rasti dhe jo në bllok.

ORGANET E PUSHTETIT VENDOR

Gjykata Kushtetuese mbi bazën e kërkesës së kërkuarit EM, me objekt konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese, për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, me vendimin nr. 6, datë 31.3.2006 ka vendosur:

Pranimin e kërkesës së kërkuarit EM, për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese, për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszbatimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë nga Bashkia e Tiranës dhe Zyra e Përmbarimit të Tiranës.

Në arsyetimin e vendimit të saj Gjykata Kushtetuese i referohet në mënyrë të veçantë nenit 142/3 të Kushtetutës, sipas të cilit, **organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore**. Ky detyrim është konkretizuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, nga del se vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatat dhe për institucionet e tjera.

Çdo qytetar që i drejtohet një gjykatë kompetente për realizimin e një të drejtë, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj, prandaj janë të lidhura me domosdoshmërinë e respektimit të një afati të arsyeshëm, në rast të kundërt ndodhemi para një procesi të parregullt ligjor.

Mosekzekutimi i vendimit ka ardhur për shkaqe subjektive, **pasi Bashkia e Tiranës dhe Zyra e Përmbarrimit të Tiranës, nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore që kanë për vënien në zbatim të një vendimi gjyqësor të formës së prerë**, pasi nuk e kanë kthyer kërkesin në vendin e mëparshëm të punës dhe nuk e kanë paguar plotësisht për pagën sipas urdhërimeve të vendimeve gjyqësore.

Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se gjykimi për realizimin e një të drejte, si një proces kompleks, në vetvete përbëhet nga dy faza, **ajo e njohjes ose deklarimit të të drejtës, që si rregull përfundon kur vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë dhe ajo e zbatimit të tij**.

Gjykata Kushtetuese çmon se e drejta për të kërkuar ekzekutimin brenda një afati të arsyeshëm të një vendimi të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata Kushtetuese ka krijuar një praktikë të sajën duke u shprehur se **“Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të konceptit të shtetit ligjor** e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë” dhe se “asnjë organ shtetëror nuk mund të verë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre”.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për detyrimin e organeve përkatëse për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nëpërmjet të cilit kërkesi ka fituar të drejtat e tij është mjaft i rëndësishëm në kushtet kur mjaft vendime gjyqësor e janë të paekzekutuara. Ky vendim vjen pas qëndrimit që mbajti Gjykata e Strasburgut për këto raste dhe ka një rëndësi të dyfishtë, e para, sepse e përcaktoi ekzekutimin e vendimit si pjesë të procesit të rregullt ligjor dhe realizim të të drejtës së individit, por së dyti, mund të shërbejë edhe si një nxitje për ekzekutimin e vendimeve të tjera gjyqësor e, për të cilat shteti shqiptar mund të marrë gjoba të konsiderueshme.

Me gjithë sensibilitetin, me keqardhje mund të themi që ky vendim ende nuk është ekzekutuar.

Për këtë arsye, gjatë fazës së monitorimit u kontaktua fillimisht drejtpërdrejt me kërkuesin, i cili shpjegoi maratonën e kërkimeve të tij, tashmë për të realizuar ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Gjithashtu, ai pretendoi që përbarimi nuk po i ekzekuton vendimin, duke e sorollatur vazhdimisht.

Duke pasur në konsideratë faktin që sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, dy janë organet e detyruara ta zbatojnë atë, Bashkia e Tiranës dhe Zyra e Përbarimit, në kushtet kur nuk është ekzekutuar vullnetarisht, u mor kontakt me përfaqësues të Bashkisë së Tiranës, të cilët pretenduan se kërkuesi është paguar nga Bashkia, duke e konsideruar këtë si ekzekutim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Pra, Bashkia e Tiranës nuk jep shkaqe për të cilat nuk e ekzekuton vendimin, por e konsideron atë të ekzekutuar. Në fakt vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk konsiderohet i ekzekutuar, sepse kërkuesi nuk është kthyer në punë dhe vendimi gjyqësor parashikonte kthimin në punë të tij, ndërsa Zyra e Përbarimit e mban në proces, duke zvarritur edhe ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Zyra e Përbarimit pretendon se e ka në proces ekzekutimi, por ende nuk e ka ekzekutuar. Për këtë arsye kërkuesi ka proceduar penalisht për shpërdorim detyrë përbaruesin që nuk ekzekuton vendimin gjyqësor dhe për pasojë edhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Pra, çështja është në proces dhe ndiqet vazhdimisht nga kërkuesi.

Mendojmë që vendimi i Gjykatës Kushtetuese është i një lloji të veçantë në këtë rast, sepse detyron organin të ekzekutojë një vendim tjetër pa shfuqizuar një akt ose një vendim tjetër gjyqësor.

KUVENDI

Vendime të Gjykatës Kushtetuese që kanë të bëjnë me Kuvendin, sidomos në rast të shfuqizimit të dispozitave ligjore si antikushtetuese, kemi shumë,

por një pjesë e tyre nuk kanë nevojë të ekzekutohen sepse vetë shfuqizimi sjell si pasojë moszbatimin e dispozitës së shfuqizuar dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese konsiderohet i ekzekutuar në këtë moment.

Problemi qëndron në rastin kur ka vend për të plotësuar zbrazëtinë që lë shfuqizimi i normës nga Gjykata Kushtetuese. Në këtë rast, nëse e shohim strikt në kuptim të ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, mund të themi se vetëm moszbatimi i normës së shfuqizuar mjafton për ta konsideruar vendimin të ekzekutuar.

Megjithatë, në rastet kur Gjykata Kushtetuese shprehet në vendim se organi përkatës duhet të plotësojë zbrazëtinë ligjore të krijuar, mendoj se në këtë rast vendimi i Gjykatës Kushtetuese konsiderohet i ekzekutuar në momentin e plotësimin të zbrazëtisë ligjore. Kjo për faktin se në vendimet e Gjykatës Kushtetuese zbatohet jo vetëm diapozitivi, por dhe elemente të arsytimit të vendimit kur është e nevojshme.

Për shembull me vendimin nr.9, datë 26.02.2007, Gjykata Kushtetuese vendosi shfuqizimin si të papajtuëshëm me Kushtetutën të neneve 1, 7 (shkronja “a”, “b”) e 9 të ligjit nr.9481, datë 16.02.2006 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9418, datë 20.05.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Në arsytimin e vendimit të saj Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se shfuqizimi i dispozitave objekt gjykimi **krijon një zbrazëti** lidhur me pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe për pensionet e pleqërisë të ushtarakëve. Bazuar në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i rekomandon Këshillit të Ministrave e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të bëjnë rishikimin në tërësi të ligjit në përputhje me këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese.

Në aspektin e ekzekutimit ndodhemi para një situatë që dispozitivi i vendimit vetëm shfuqizon dispozitat objekt shqyrtimi. A ndodhemi në këtë rast para një vendimi që kërkon ekzekutim?

Në referim të nenit 78 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, kur vendoset shfuqizimi i ligjit ose aktit dhe marrëdhëniet e lindura kërkojnë rregullim juridik, vendimi i Gjykatës Kushtetuese i njoftohet organeve përkatëse që të marrin masat e parashikuara në vendimin e saj.

Në këtë rast mendojmë që ndodhemi para një vendimi të paekzekutuar sepse zbrazëtia ligjore e krijuar për shkak të shfuqizimit të dispozitave, objekt shqyrtimi, duhet të ishte plotësuar.

Gjykata Kushtetuese ka marrë disa vendime specifike lidhur me procedurat e rregullta ose jo të Kuvendit për shkarkimin e funksionareve të lartë.

Në po trajtojmë më poshtë rastin e interpretimit përfundimtar të neneve 128, 140, 149 pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, duke bërë interpretimin e shprehjes “akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën...”, etj. Gjykata Kushtetuese vendosi interpretimin e dispozitave të sipërpërmendura me vendimin nr.75, datë 19.4.2002.

Nga praktika e Gjykatës Kushtetuese rezulton se interpretimi i një dispozite kushtetuese kërkohet në rastet kur ka një çështje konkrete më pas. Dhe në këtë rast, pas interpretimit të dispozitave kushtetuese u paraqit kërkuesi AR, Prokuror i Përgjithshëm dhe kërkoi “Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.20, datë 19.3.2002 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe të dekretit nr.3276, datë 25.3.2002 të Presidentit të Republikës”.

Me vendimin nr.76, datë 25.4.2002 Gjykata Kushtetuese vendosi: Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.20, datë 19.03.2002 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe të dekretit nr.3276, datë 25.03.2002 të Presidentit të Republikës” dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Gjykata Kushtetuese, në ushtrim të plotë të kompetencave të saj, shqyrtoi kushtetutshmërinë e procedurave të shkarkimit dhe konkludoi se ato kanë qenë në kundërshtim me parimet kushtetuese. I përket Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të riparojë këto shkelje duke rishqyrtuar çështjen

në përputhje me parimet kushtetuese dhe normat e gjithëpranuara ndërkombëtare për një proces të rregullt ligjor.

Në informacionet që u përpoqëm të marrim për mosekzekutimin e këtij vendimi, i cili tashmë do të mbetet si diçka jo e mirë në veprimtarinë e Kuvendit, i cili nuk zbatoi një vendim të të vetmit organ kompetent në fushën e kontrollit kushtetues, mendimi i përgjithshëm është se ishin arsye dhe qëndrime politike ato që nuk lejuan ekzekutimin e këtij vendimi, për të rihapur procedurën konkrete të dëgjimit të Prokurorit të Përgjithshëm për shkak të procesit të parregullt ligjor të zbatuar nga Kuvendi gjatë procedurës së shkarkimit të tij.

Për me tepër, pas daljes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese, në vend që të zbatohet vendimi i sipërpërmendur, u procedua me emërimin e Prokurorit të ri të Përgjithshëm.

Një rast interesant, i cili u pa e arsyeshme të trajtohet, megjithëse bën pjesë në vendimet e rrëzimit, është ai që ka të bëjë me vendimin nr.3, datë 11.2.2004 të Gjykatës Kushtetuese.

Ky vendim është marrë mbi bazën e kërkesës së Gjykatës së Lartë për shfuqizimin e neneve 86 dhe 87 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, kërkesë e cila është konsideruar si e pabazuar dhe për rrjedhojë është rrëzuar.

Gjykata Kushtetuese, në këtë vendim arsyeton se "...për sa kohë që ndalimi i torturës dhe keqtrajtimi është përcaktuar si një e drejtë njerëzore dhe përderisa të drejtat e njeriut janë konsideruar si të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme, çdonjëri ka të drejtë për të mos iu nënshtuar torturës apo keqtrajttimeve, pavarësisht se ai është në duart e një zyrtari publik apo të një individi"

Me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007 për disa ndryshime në Kodin Penal është vendosur dhe ndryshimi i nenit 86 të Kodit Penal. Sipas ndryshimit në subjektet që janë përgjegjës për kryerjen e kësaj vepre penale (tortura) përfshihet vetëm personi që ushtron funksione publike.

Duke risjellë në vëmendje faktin që në rastin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese ekzekutohet edhe arsyetimi i vendimit të saj, arrijmë në përfundimin se kjo dispozitë vjen ndesh me vendimin nr.3, datë 11.2.2004 të Gjykatës Kushtetuese. Mendoj që në hartimin e kësaj dispozite nuk ka qenë në vëmendje ky vendim sepse ai është një vendim rrëzimi.

Këtu do të shtroja dy pyetje:

a. A ndodhemi në këtë rast para mosekzekutimit të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese apo vendimet e rrëzimit nuk janë të detyrueshme për t'u ekzekutuar?

b. A sjell ky fakt domosdoshmërinë e pasjes së një strukture që të ndjekë ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe a duhet që çdo institucion të ngarkojë një strukture për të ndjekur këto vendime?

4. MJETET QË SIGUROJNË EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Dispozita më e drejtpërdrejtë që përmban ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", në lidhje me çështjen e zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është neni 81 i tij. Ky nen përcakton se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për zbatim. Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese sigurohet nga Këshilli i Ministrave me anën e organeve përkatëse të administratës shtetërore. Gjykata Kushtetuese mund të caktojë vetë një organ tjetër që ngarkohet me zbatimin e vendimit të saj dhe, kur është e nevojshme, edhe mënyrën e ekzekutimit të tij. Personat që nuk zbatojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese ose pengojnë zbatimin e tyre, kur veprimi nuk përbën vepër penale, dënohen me gjobë deri në 100 mijë lekë nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, vendimi i të cilit është i formës së prerë dhe përbën titull ekzekutiv.

Neni 81 i ligjit të mësipërm, synon të vendosë rregulla të prera në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, duke shkuar deri aty sa Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese i jepet e drejta që të gjobisë personat që pengojnë zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, kur ky vendim është i formës së prerë dhe përbën titull ekzekutiv.

Nga kjo dispozitë duket që sistemi i zgjedhur i ngjason atij të Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg, ku organi që merret me ekzekutimin e vendimeve të kësaj Gjykate është Komiteti i Ministrave nëpërmjet strukturave të tij.

Në të vërtetë neni 81 nuk ka gjetur zbatim në praktikë dhe Këshilli i Ministrave nuk ka një organ që të ndjekë zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Gjithashtu, edhe vetë Gjykata Kushtetuese, megjithëse e ka të drejtën të caktojë vetë një organ tjetër për ekzekutimin e vendimeve të saj, madje të përcaktojë mënyrën e ekzekutimit të vendimeve të saj, nuk e ka realizuar asnjëherë këtë kompetencë.

Nga sa me sipër dhe në interpretim të nenit 81 rezulton që nuk mungojnë mekanizmat për të realizuar ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese kur ato nuk ekzekutohen vullnetarisht, por këto mekanizma nuk kanë funksionuar deri tani.

Mendoj që ndjekja e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese ka rëndësi, sepse jo gjithmonë ekzekutimi i tyre është i nevojshëm të bëhet në moment, por duke pasur parasysh faktin që ekzekutimi i tyre shtrihet në kohë, por edhe për raste të tjera që ndodhin me vonë del e domosdoshme që të jete një organ që do ta quaja pa frikë gardian të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në çdo kohë, siç është vete kjo Gjykatë, gardiane e respektimit të Kushtetutës.

Pjesë mjaft e rëndësishme e kuadrit ligjor të ekzekutimit të vendimeve

të Gjykatës Kushtetuese është edhe Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Në nenin 87 të kësaj Rregulloreje përcaktohet se **vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren në shqyrtim nga Këshilli për Legjislacionin menjëherë pas botimit të tyre në Fletoren Zyrtare**. Këshilli analizon dhe diskuton, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Rregullore, efektet e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për legjislacionin. Nëse Këshilli vendos se nevojitet marrja e nismës ligjvënëse për plotësime ose ndryshime në legjislacion, ai i paraqet Këshillit të Ministrave rekomandimet e nevojshme ose ndërmerr nismën e vet ligjvënëse. Mendimi i Këshillit mund t'i dërgohet Gjykatës Kushtetuese, Këshillit të Ministrave dhe Presidentit të Republikës.

Formulimi i mësipërm i nenit 87 të Rregullores së Kuvendit duket sikur lë në diskrecion të Këshillit për Legjislacionin vlerësimin nëse nevojitet marrja e një nisme ligjvënëse. Në lidhje me këtë, duhet theksuar se është vetë Kushtetuta dhe ligji organik për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese që përcakton efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe detyrimin e të gjitha organeve shtetërore (*përfshirë Kuvendin*) që të marrin të gjitha masat për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë prizëm, nëse Gjykata Kushtetuese shfuqizon një ligj të caktuar, atëherë duhet që Kuvendi të marrë masa për miratimin e një ligji tjetër në përputhje me Kushtetutën, natyrisht duke debatuar dhe analizuar çështjen, por pa cenuar në asnjë rast vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Parashikimi në Rregulloren e Kuvendit të një Këshilli për Legjislacionin, i cili funksionon vetëm për vendimet e Gjykatës Kushtetuese lidhur me Kuvendin, ngre pyetjen:

A duhet që çdo institucion të ketë një strukturë të caktuar që të ndjekë zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese që ka të bëjë me të?

Cilat do të ishin mekanizmat më të frytshme për të realizuar

ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese?

Kjo tryezë besoj do të paraqesë ide dhe rekomandime të vlefshme për të ndihmuar sadopak në procesin e rëndësishëm të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Analizë e veprimtarisë dhe legjislacioneve për gjykatat kushtetuese të Europës Lindore, Perëndimore dhe SHBA-së: Vështrim krahasues ¹

M.A. Erion Manohasa

HYRJJE

Kemi dy tipe kontrolli kushtetues; të SHBA-së dhe Europian. Europiani ndahet në modelin francez (kontroll paraprak), modelin gjerman (kontroll pas hyrjes në fuqi të ligjit) dhe rastin e Hungarisë (të dy tipat e kontrolleve) dhe mundësinë e vendimeve ne rast inercie të parlamentit.

Në Hungari dhe Bullgari vendimet janë përfundimtare kurse në Rumani dhe Poloni parlamenti ka mundësi të injorojë vendimet e Gjykatës Kushtetuese 2/3 votave.

KUSHTETUTA HUNGAREZE

Neni 19 Parlamenti ka kompetenca:

Të miratojë Kushtetutën e Republikës së Hungarisë.

(k) Zgjedh Presidentin e Republikës së Hungarisë, Kryeministrin, anëtarët e Gjykatës Kushtetuese etj.

¹ Ky raport është mbajtur në tryezën e organizuar nga QSP dhe MCC, në kuadër të projektit “Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe roli i rëndësishëm i tyre në forcimin e Shtetit të së Drejtës”, mbështetue nga Fondacioni Shoqëria e Hapur, Soros..

Neni 26 (4) Nëse Presidenti i Republikës mendon se ndonjë dispozitë e ligjit mund të jetë antikushtetuese, ai ia dërgon Gjykatës Kushtetuese brenda afatit të përcaktuar para se të nënshkruajë dhe kërkon një raport për kushtetutshmërinë e ligjit. (5): Gjykata Kushtetuese pasi ka proceduar ligjin me urgjencën e kërkuar, dhe e deklaron antikushtetues, Presidenti ia rikthen ligjin Parlamentit. Përndryshe ai duhet ta nënshkruajë ligjin, i cili hyn në fuqi brenda 5 ditësh.

Kreu IV

Gjykata Kushtetuese

Neni 32/A

(1)Gjykata Kushtetuese përcakton kushtetutshmërinë e dispozitave ligjore dhe kryen funksione të tjera të përcaktuara me ligj.

(2)Çdo ligj ose masë ligjore që shpallet jokushtetuese anulohet nga Gjykata Kushtetuese.

(3)Në rastet e parashikuara me ligj, çdokush mund të fillojë procedurat në Gjykatën Kushtetuese.

(4)Pesëmbëdhjetë anëtarët e Gjykatës Kushtetuese zgjidhen nga Parlamenti. Një komitet dominues, që përfshin nga një anëtar për çdo parti të përfaqësuar në Parlament, propozon kandidaturat për në gjykatë. 2/3 të anëtarëve të parlamentit duhet të miratojnë për zgjedhjen në Gjykatën Kushtetuese.

(6) Për ratifikimin e ligjit për organizmin dhe veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese duhen votat e 2/3 të anëtarëve të pranishëm të Parlamentit.

Neni 34 (1) Parlamenti dërgon rregullat e procedurës, para se t'i adoptojë ato, para Gjykatës Kushtetuese për t'i ekzaminuar në lidhje me kushtetueshmërinë e tyre, duke treguar dispozitat që mendon se janë të diskutueshme.

(2) Në rast antikushtetutshmërie të një dispozite të tillë, Parlamenti duhet ta eliminojë atë.

Neni 35 (1) Gjykata Kushtetuese shqyrton kushtetutshmërinë e dispozitave

nëse Presidenti bën peticion para se ta shpallë (promulgojë) një ligj.

(2) Nëse Gjykata Kushtetuese vendos për antikushtetutshmërinë e dispozitës në fjalë, Presidenti ka të drejtë të mos ta shpallë atë para se Parlamenti që të bëjë ndryshimet e duhura.

KUSHTETUTA SHQIPTARE

GJYKATA KUSHTETUESE

Neni 4:1. E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. 2. Kushtetuta është ligji me i lartë në Republikën e Shqipërisë. 3. Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe.

Neni 6: Organizimi dhe funksionimi i organeve të parashikuara në këtë Kushtetutë rregullohen me ligjet e tyre përkatëse, përveç, rasteve kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe.

Neni 124:1. Gjykata Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj. 2. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.

Neni 132:1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Gjykata Kushtetuese ka vetëm të drejtën e shfuqizimit të akteve që shqyrton. 2. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare. Gjykata Kushtetuese mund të vendosë që ligji ose akti tjetër normativ të shfuqizohet në një datë tjetër. Mendimi i pakicës botohet bashkë me vendimin.

Neni 145:1. Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. 2. Kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjitha gjykatat. 3. Ndërhyrja në veprimtarinë e gjykatave ose të gjyqtarëve sjell përgjegjësi sipas ligjit.

KUSHTETUTA ITALIANE GJYKATA KUSHTETUESE

Art. 134: Gjykata Kushtetuese gjykon për çështjet që kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë e ligjeve, të akteve të tjera ligjore, të shtetit ose të pushteteve vendore: për konfliktet midis organeve shtetërore, shtetit dhe pushteteve vendore dhe midis pushteteve vendore; për akuzat kundrejt Presidentit të Republikës, sipas Kushtetutës. Art. 135: Gjykata Kushtetuese është e përbërë nga 15 gjykatës të zgjedhur për 1/3 nga Presidenti Republikës, për 1/3 nga Parlamenti dhe për 1/3 nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Art. 136: Kur Gjykata Kushtetuese vendos për antikushtetutshmërinë e një ligji ose akti ligjor, ligji nuk është më në fuqi nga dita e nesërme e publikimit të vendimit. Vendimi publikohet dhe i komunikohet Parlamentit, në mënyrë që, kur ta shohin të duhur, të ndërmarrin nisma ligjore sipas Kushtetutës.

Art. 137: Kundër vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nuk lejohet asnjë lloj apelimi.

AUSTRIA

Kushtetuta e Austrisë është e para në botë që ka rregulluar me ligj (në vitin 1920) kontrollin e kushtetutshmërinë nga ana e gjyqësorit me një organ të veçantë, që më vonë u njoh me emrin “sistemi austriak”. Sipas këtij sistemi ekziston një gjykatë e veçantë kushtetuese, e cila merret me shqyrtimin dhe verifikimin e kushtetutshmërisë së ligjeve. Shumë vende kanë ndjekur sistemin austriak pas Luftës së Dytë Botërore.

ITALIA

Në nëntor 2002 Gjykata Kushtetuese Italiane me vendimin nr. 466/2002 vendos që asnjë person ose shoqëri nuk mund të posedojë më shumë se dy frekuenca televizive dhe stacionet e tepërta (në këtë rast Rete4) duhet të ndërpresin transmetimin tokësor. Gjykata fiksoi një datë e cila nuk mund të shtyhej, duke vendosur që brenda 31 dhjetorit 2003 Rete 4 duhet të vazhdonte

transmetimet në satelit. Në verën e 2003, Ministri i Telekomunikacioneve, Maurizio Gasparri paraqiti një projektligj për reformimin e sistemit radio-televiziv italian. Ky ligj (i njohur si ligji Gasparri) u miratua nga Parlamenti në dhjetor 2003 dhe i lejoj Rete4 vazhdimin e transmetimit tokësor. Presidenti i Republikës Carlo Azeglio Ciampi nuk pranoi të nënshkruajë ligjin dhe ia ktheu për rishqyrtim Parlamentit. Qeveria Berlusconi nxori një dekretligj (i njohur si dekreti “Shpëto Rete 4”). Ligji Gasparri u miratua në mënyrë definitive në prill 2004, pa marrë aspak në konsideratë vendimin 466/2002 të Gjykatës Kushtetuese.

RUSI

Gjykata Kushtetuese e Rosisë kishte probleme me “moszbatimin e vazhdueshëm dhe vonesa të shpeshta në zbatimin e vendimeve të saj nga autoritetet federale dhe rajonale” (Trochev, 2002: 96; Schwartz 2000). Që nga rënia e Bashkimit Sovjetik ka pasur përplasje të vazhdueshme ndërmjet Moskës dhe disa rajoneve lidhur me autonominë. Në këto përplasje gjykata u bë një aleat i vlefshëm i Qeverisë qendrore, duke rrezuar pretendimet rajonale në disa raste. Qeveritë rajonale nga ana tjetër i injoronin këto vendime dhe madje refuzonin t’i publikonin vendimet e Gjykatës. Si kundërpërgjigje, presidenti Putin në fund të vitit 2001 propozoi dhe bëri të mundur të miratohet në Duma një statut i ri që përcaktonte afate të caktuara lidhur me vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Sidoqoftë, sipas këtij ligji, sanksionet ishin vetëm për qeveritë rajonale që nuk zbatonin në kohë vendimet. Institucionet federale ishin të përjashtuara. (Trochev 2002:101)

HUNGARIA

Pas rënies së regjimit socialist, Hungaria vendosi një Gjykatë Kushtetuese të fuqishme, e cila doli nga tryezat e rumbullakëta të socialistëve me opozitën. E pajisur me një juridiksion të gjerë dhe mundësi aksesit nga qytetarët e thjeshtë, nën drejtimin e Laszlo Solyom, filloi të sfidonte pushtetin legjislativ,

i cili si rrjedhë u detyrua të formojë një legjislacion e ri. Duke qenë se aksesi në gjykatë ishte shumë i lehtë, në përgjithësi të gjitha problemet ligjore dhe politike të tranzicionit përfunduan në gjykatë. Në kulmin e punës, një ligj në tre u deklarua i pavlefshëm nga gjykata.

Pavarësisht kritikave dhe skepticizmit të Qeverisë dhe Parlamentit kundrejt Gjykatës Kushtetuese, të gjitha vendimet e kësaj të fundit u zbatuan dhe nuk u bë asnjë përpjekje për të kufizuar kompetencat e gjykatës, si në teori, ashtu dhe në praktikë, çka nuk ka ndodhur në vendet e tjera të lindjes dhe të ish-bllokut sovjetik. Disa komentatorë e kanë quajtur sistemin politik pas ndryshimit të regjimit si “gjykatokraci” (Scheppele, 2001).

GJERMANI

Shembuj gjykatash kushtetuese fuqiplota në Europën Perëndimore janë Gjermania, Italia, Spanja dhe Portugalia. (Stone Sweet 2000).

Dhe pse në Kushtetutën e Gjermanisë vendimet e Gjykatës Kushtetuese Gjermane janë të detyrueshëm, dhe në pjesën dërrmuese të tyre zbatohen, ka patur shumë raste kur nuk janë zbatuar ose është vonuar qëllimisht zbatimi. Si p.sh. vendimi nr. BVerfGE 93, I, me të cilin u shfuqizua (void) neni 13, seksioni 1 i rregullores shkollore për shkollat fillore në Bavari pasi ishte në kundërshtim me nenin 4 seksioni 1 të Ligjit Themeltar Gjerman. Parlamenti Bavarez miratoi një korrektim të rregullores shkollore, por ky ishte vetëm një formalitet, pasi teksti i ri bënte vetëm një lojë fjalësh, por kuptimi ishte i njëjtë me tekstin e shfuqizuar.

Argumentet në favor të një gjykate kushtetuese të fuqishme janë;

1) Duke përdorur dispozicione ligjore strukturale dhe rregulla procedurale mund të rritet paanshmëria e Gjykatës Kushtetuese dhe të kufizohet ndërhyrja në procesin legjislativ.

2) Kontrolli kushtetues duke mbrojtur të drejtat themelore përmirëson cilësinë e demokracisë në procesin politik.

Strategjia më e qartë për të shmangur konfliktet midis Parlamentit ose Qeverisë me Gjykatës Kushtetuese është përdorja e modelit të SHBA-së. Por duke qenë që vendet e Europës Lindore po ndjekin modelin evropian, në një farë mënyre të “detyruara” nga perspektiva për të hyrë në BE është shumë e vështirë që ta braktisin këtë model.

SHBA

Në historinë e SHBA-së maxhoranca në pushtet e ka sfiduar tri herë në mënyrë plateale pushtetin dhe pavarësinë e Gjykatës Supreme si institucion:
 1805 Mosbesimi i ndjekjes gjyqësore
 1868 U propozua ligji për kufizimin e juridiksionit të Gjykatës Supreme.
 Plani “Court-packing” i Franklin Roosvelt në vitin 1937.

GJENDJA NË EUROPËN LINDORE

Bela Prokol, për shembull, kritikoi kryesor i Gjykatës Kushtetuese Hungareze e ka vënë në diskutim autoritetin e kësaj të fundit. Sipas tij nuk mund të vendoset për çështjet politike në bazë të parimeve “super abstrakte” si “siguria ligjore” (Prokol, 1994) Argumenti i Prokol-i është parimor dhe nuk varet nga ajo që vendos gjykata. Ai arsyeton që një trup jo i zgjedhur demokratikisht nuk ka të drejtë të diskutojë çështje politike thelbësore në emër të parimeve abstrakte të Kushtetutës.

Në të njëjtën notë, Stephen Holmes ka kritikuar veprimtarinë e gjykatave kushtetuese “më prestigjioze” të Europës Lindore. Ai ka paralajmëruar për dobësimin e parlamenteve të ligjshme demokratike në emër të stabilitetit kushtetues. Ai i kritikon gjykatat kushtetuese të Europës Lindore që shikojnë si udhërrëfyese aktivizmin “Kantian” të të drejtave bazë të Gjykatës Kushtetuese Gjermane të pasluftës.

Revizioni abstrakt është më demokratik, se revizioni konkret, sepse në të parin Gjykata Kushtetuese ushtron një veprimtari gjyqësore, kurse në të dytin ka më shumë probabilitet për ndërhyrje në politikë nga ana e GjK. Revizioni abstrakt paraprak është më antidemokratik se revizioni abstrakt

në momentin kur ligji ka hyrë në fuqi, sepse:

1) revizioni paraprak zhvillohet përpara se të analizohet aplikimi ligjit në praktikë (vendimet zbatuese, udhëzimet etj.)

2) në këtë mënyrë Gjykata Kushtetuese merr pjesë në diskutimet në Parlament përpara se të mbarojë procesi legjislativ.

3) Ka më shumë mundësi për abuzime nga ana e minorancës sesa në rastet e revizionit *a posteriori*. (Spanja)

“Problemi” që Gjykata Kushtetuese ndërhyt në procesin demokratik dhe legjislativ, pa qenë e zgjedhur nga populli, ndjehet më shumë në vendet e Europës Lindore;

- pasi nuk kanë një kuptim të qartë të legjitimitetit zgjedhor, i cili është në zhvillim;

- sepse shumë nga parlamentarët kanë një të shkuar të bazuar në periudhën komuniste dhe nuk e perceptojnë Gjykatën Kushtetuese si institucion demokratik;

Si rrjedhojë, nëse Gjykata Kushtetuese ka kompetenca të shumta dhe i ushtron ato, perceptohet si një kufizim i përfaqësimit demokratik.

REKOMANDIME PËR GJYKIMIN KUSHTETUES

Legjitimiteti përfshin “kapacitetin e një sistemi politik për të krijuar dhe mbajtur bindjen që insitucionet politike ekzistuese janë më të përshtatshme për shoqërinë” (Lipset, 1959:68). Max Weber thotë që legjitimiteti është “prestigji i të qenit ekzemplar ose i detyrueshëm” (binding) (Weber, 1980:16).

“Gjykatat nuk kanë as pushtetin e forcës e as të ndalimit të financimit, prandaj, meqë për këto çështje ato varen nga mbështetja e publikut, sidomos në vitet e para, duhet të kenë kujdes dhe të mos ja ulin autoritetin vetes duke u marrë me çështje, të cilat mund të zgjidhen shumë më mirë nga institucione të tjera. (Prof. Herman Shvarc, Shkolla Juridike Amerikane).

Institucionet e shtetit dhe organet administrative duhet t’i binden vendimeve të gjykatave; këto subjekte nuk duhet t’i ndryshojnë vendimet e

gjykatave e as të vonojnë ekzekutimin e tyre.

PËRFUNDIME

Mosbesimi i pushtetit politik kundrejt gjykatave kushtetuese ka ekzistuar gjithmonë sidomos në vitet e para të funksionimit të këtyre të fundit. Ky mosbesim vazhdon të ekzistojë në formën e ngadalësisë në zbatimin e vendimeve dhe të sugjerimeve të GjK-së. Por duke marrë mësim nga përvojat e vendeve perëndimore, Gjykata Kushtetuese duhet të kalojë vështirësitë fillestare duke ndjekur disa rrugë:

1) Duhet të fitojë besimin e të gjithë trupit gjyqësor dhe të bëjë të vlejë përpara pushtetit politik forcën e pushtetit gjyqësor.

2) Me vendime “manipuluese”, të cilat si rrjedhojë e zbatimit të këtyre vendimeve nga gjykatat, bën të arrihen rezultate të barabarta më atë të riformulimit legjislativ të ligjit.

Ndërsa në rast mosbatimi të përsëritur mund të arrihet në kërkesa për dëmshpërblim nga të dëmtuarit nga ky mosveprim për moskryerje të akteve dhe detyrave të atribuara me ligj.

E drejta, shteti, gjyqtari: Çështja e sigurisë

Philippe RAYNAUD *

Përktheu: Diana ESTREFI

Hyrje: *Gjyqtari në filozofinë moderne. Kthesa juridiksionale e politikës demokratike.*

I/ *Teoritë europiane për shtetin e së drejtës*

- Doktrina gjermane e *Rechtstaat*-it dhe pranimi i saj në Francë.
- Kritikën e shtetit të së drejtës.

II/ *Debatet amerikane*

- *Original intent*-i dhe *living constitution*-i.
- Demokracia dhe konstitucionalizmi.

Hyrje: *Gjyqtari në filozofinë moderne. Kthesa juridiksionale e politikës demokratike.*

Gjyqtari në mendimin modern. Hobbes dhe Beccaria. Demokracia e legjicentrizmit të pushteti ekzekutiv. Ndryshimi i qëndrimit të së majtës ndaj “*Judicial Restreint*”.

I/ *Teoritë europiane të shtetit të së drejtës.*

I shpërfillur për një kohë të gjatë nga filozofia, e cila shpesh e shihte si një koncept vetëm juridik, madje “ideologjik”, koncepti “shtet i së drejtës” gëzon sot një prestigj tepër të konsiderueshëm në filozofinë bashkëkohore, i cili përputhet, sigurisht, edhe me zhvillimet e fundit të politikës së brendshme të demokracive dhe të së drejtës ndërkombëtare. Fundi i shekullit XX pa

* Autori është profesor për filozofinë politike në Universitetin Paris-II Panthéon-Assas.

zhdukjen e regjimeve autoritare konservatore të Perëndimit europian (Spanja, Portugalia, Greqia), ngjitjen lart të juridiksioneve kushtetuese në pjesën më të madhe të demokracive, shembjen e regjimeve komuniste në Europën Qendrore dhe Lindore dhe, më në fund, emergjencën, edhe pse problematike, për një “të drejtë ndërkombëtare”, e cila është menduar që të kufizojë sovranitetin e shteteve duke mundësuar, sigurisht në bazë të disa kushteve, sanksione kundër qeverive fajtoresh për shkelje flagrante të të drejtave themelore; pa dyshim që këto procese mund të mendohen si heterogjene, por ama të përqendruara rreth konceptit “shtet i së drejtës”, aq sa të gjitha bëjnë të shfaqet një opozitë midis shteteve “totalitare”, “autoritare” ose të paktën “arbitrare” dhe një modeli të epërm të shtetit, të përkufizuar nga konformiteti i tij me “të drejtën”, pa e kuptuar mirë nëse këtu bëhet fjalë thjesht për ekzistencën e një hierarkie normash të sanksionuara ashtu si duhet apo, më radikalisht, nëse bëhet fjalë për nënshtrimin e shtetit ndaj normave metajuridike, siç janë ato të “të drejtave të njeriut”; përveç kësaj mund të vërejmë se aktorët e këtyre transformimeve shpesh janë po ata që i drejtohen konceptit “shtet i së drejtës”, për të legjitimuar veprimet e veta, si drejtues qeverish në vendet në tranzicion, juridiksione kushtetuese ose edhe udhëheqësit e fundit komunist në përpjekje për të shpëtuar diçka nga regjimet që kishin në ngarkim (Mikhail Gorbachev donte ta bënte Bashkimin Sovjetik një “shtet socialist të së drejtës”). Filozofia politike bashkëkohore e ka përcjellë gjerësisht këtë lëvizje, duke u paraqitur si një filozofi e së drejtës (Renaut dhe Sosoe, 1991), duke u përpjekur të tregojë moszvogëlimin e shtetit të së drejtës në “shtet të policisë” (lindur në Europën Perëndimore, Kriegel, 1979) ose duke kërkuar një sintezë midis teorisë “radikale” të demokracisë dhe traditës liberale të shtetit të së drejtës (Habermas, 1997). S’ka dyshim që edhe në ditët e sotme nocioni i shtetit të së drejtës mbetet, në shumë vështrime, problematik, për të mos thënë i errët; çështjet kryesore janë ato të origjinave të konceptit të së drejtës (që nis me doktrinën gjermanike të *Rechtstaat*-it, shfaqur në një kontekst shumë të ndryshëm nga i yni, çështjet e vlerave vepruese (të kontestuara, duke filluar që me premisat e kundërshtuara njëkohësisht nga Carl Schmitt dhe

nga Hans Kelsen), dhe çështja e përkthimit në gjuhën angleze (aty ku vlen koncepti *Rule of Law*, i cili i referohet njëkohësisht artikullimit të ndryshëm midis “së drejtës” dhe “ligjit” dhe frazave kushtetuese të paepura ndaj modeleve “kontinentale”).

DOKTRINA GJERMANE E RECHTSTAAT-IT

Shprehja franceze “shtet i së drejtës” është përkthim i termit gjerman *Rechtstaat*, i cili u shfaq gjatë shekullit XIX, për të përcjellë dhe për të ideuar procesin progresiv të *inkuadrimit dhe të kufizimit të shtetit nga e drejta*, që mendohej se dukej në veprën e shtetit gjerman. Ashtu siç vëren Jacques Chevallier, “ky objektiv i përbashkët mbulon, megjithatë, vizione tepër të ndryshme për shtetin e së drejtës” (Chevallier, 1999, 11), të cilat shkojnë nga kërkesa e thjeshtë funksionale për një shtet që të veprojë *me anë të së drejtës* të kërkesat “thelbësore” lidhur me *përmbajtjen* e së drejtës, duke kaluar nëpër idenë “formaliste” të një shteti që i nënshtrohet së drejtës; përveç kësaj formula është e avancuar njëkohësisht nga juristët *liberalë*, si R. von Mohl, të cilët kërkojnë, mbi të gjitha, që të kufizojnë sferën e veprimit të shtetit dhe të mbrojnë liritë individuale dhe, nga disa të tjerë më pak ambiciozë ose më konservatorë, të cilët thjesht duan të racionalizojnë mbizotërimin e shtetit, duke normalizuar marrëdhëniet e tij dhe të administratës me shtetasit. Për ta përfunduar, imponohet një koncept “formalist”, sepse ai lejon, nga njëra anë të nënshtrojë administratën nga e drejta, duke hapur rrugët për rekurs individual kundër saj, gjithnjë duke e paraqitur këtë nënshttrim si fryt i një vetëkufizimi (çka përjashton çdo referencë të fundit tek ato norma juridike më të larta se ato të caktuara nga shteti). Nga njëra anë shteti i së drejtës i kundërvihet kështu shtetit policor (*Polizeistaat*), në të cilin e drejta nuk është tjetër, veçse instrumenti i një administrate që mund t’i imponojë shtetasve detyrime, pa qenë e lidhur nga norma të larta; nga ana tjetër shteti i së drejtës është fryt i një vetëkufizimi të lirë (por racional) të shtetit si subjekt i vërtetë i së drejtës, mbizotërimi i së cilës (*Herrschaft*)

është një e drejtë subjektive parësore, para së cilës nuk mund të ketë të drejtë publike, por që ka në vetvete si qëllim ta krijojë dhe të mbretërojë nëpërmjet së drejtës (Shënim: Shprehja franceze “vetëkufizim” në fakt përkthehet në shumë fjalë gjermane – *Selbstverpflichtung*, *Selbstbindung*, *Selbstbeschränkung* - të cilat përfshijnë, që të gjitha, idenë se shteti i imponon vetes detyra, detyrime ose kufij. (Carré de Malberg, 1962, 231)).

Pra, *Rechtsstaat*-i shfaqet si një koncept pazgjidhshmërisht liberal dhe “etatist”, i cili madje regjistrohet fare mirë në traditën e filozofisë politike gjermane përgjatë gjithë zhvillimit të saj, që nga Kanti te Hegeli. Aspekti “liberal” duket në kërkesën për mbrojtjen e shtetasve në raportin e tyre me shtetin, por, gjithashtu, më radikalisht, edhe në pohimin e qartë të parimeve të *konstitucionalizmit*: respektimi i normave më të larta nuk i imponohet vetëm administratës dhe pushtetit ekzekutiv, por edhe vetë pushtetit legjislativ, i cili i nënshtrohet kushtetutës sipas një skeme që është zhvendosur fare mirë nga perandoria në një shtet demokratiko-liberal (ashtu si në “Ligjin Themeltar” aktual gjerman). Aspekti “etatist” duket në mungesën e çdo norme suprakushtetuese (ndryshe nga ajo çka supozohet të krijohet sot), në një pohim mjaft të fryrë për fuqinë e shtetit (i njëjtë me epërsinë e së drejtës së brendshme ndaj asaj ndërkombëtare – edhe ky prodhim i vetëkufizimit të shteteve sovrane) dhe, më konkretisht, në pavarësinë e *së drejtës administrative* (e cila rrjedh nga privilegji që ka shteti për t’i caktuar vetë rregullat që duhet të ndjekë në marrëdhëniet e tij me individët). Teoria e *Rechtsstaat*-it futet kështu në një kuadër më të përgjithshëm të krijimit të një të drejte publike të përqendruar te shteti, e cila është e pandarë nga zhvillimi i perandorisë; lidhur me këtë do vërejmë se, duke këmbëngulur në karakterin e origjinës së të drejtës së shtetit në raport me kombin, teoricienët e vetëkufizimit kundërshtojnë përgënjeshttrimin ndaj tezave të romantikëve dhe shkollës historike të së drejtës, duke i prerë lidhjet me çdo koncept të trashëguar për shtetin dhe duke e dalluar qartë atë nga qeverisësit (për të gjitha këto pika shih Chevallier, 1999, 14-21). Megjithatë, do të ishte e padrejtë

të shohim aty vetëm një doktrinë “gjermane”, sepse teoria e shtetit të së drejtës mund të ishte e përshtatshme, gjithashtu, edhe në vende të tjera të Europës kontinentale, dhe përgjithësisht kudo ku shfaqej problemi i sintezës midis afirmimit të së drejtës publike dhe kufizimit “liberal” të fuqisë së shtetit; kjo sqaron futjen në Francë të “doktrinës gjermane”, e cila është rimarrë nëpërmjet veprës së Carré de Malberg-ut, megjithë mosbesimin ndaj një teorie që dukej se legjitimonte regjimin perandorak dhe se kundërshtonte konceptin për shtetin-komb, trashëguar nga revolucioni francez (Chevallier, 1999, 21-43).

Debatet franceze për problemin e shtetit të së drejtës nuk janë thjesht teorike, përkundrazi, ato janë të lidhura ngushtësisht me kontekstin politik kombëtar dhe ndërkombëtar të fillimit të shekullit. Kritikët më të mëdhenj ndaj doktrinës gjermane, si Leon Duguit ose në një masë më të vogël edhe Maurice Hauriou, janë para së gjithash të shqetësuar të dallojnë shtetin nga e drejta, për të garantuar sa më mirë nënshtrimin e të parit ndaj të dytës. Te Duguit kjo shfaqet nga një kritikë e dyfishtë ndaj doktrinës së sovranitetit dhe të individualizmit juridik, të konsideruar si efekte të subjektivizmit, të cilit juristi bordolez i kundërvë idenë e “rregullës së të drejtës” si e vetnija bazë reale e një të drejte *objektive* që mbështetet në solidaritetin social dhe që kundërshton njëkohësisht shtetin dhe individët: pra nuk ka “vetëkufizim” të shtetit, meqenëse ky nuk është një subjekt juridik dhe kufizimi i shtetit nuk bazohet aspak në “të drejtat subjektive” aq të shtrenjta për liberalët (Raynaud, 1987). Për Hauriou, e drejta dallohet qartë nga shteti, por doktrina e vetëkufizimit ruan, megjithatë, një kuptim për të treguar zhvillimin e lirive: “Logjikisht, vetëkufizimi i shtetit duket si një absurditet. Kjo, historikisht është e vërteta kushtetuese”. Te mbrojtësit e saj francezë, ndër më të shquarit e të cilëve është Raymond Carré de Malberg, “shteti i së drejtës” shfaqet njëkohësisht si një shprehje bashkëkohore e idealeve të lindura nga Revolucioni Francez (e cila lejon të kundërshtohet përparësia gjermane mbi këtë pikë, gjithnjë duke legjitimuar rimarrjen në Francë të një teorie

“gjermane”; shih, për shembull, Carré de Malberg, 1962, I, 488, nr.5) dhe si një instrument i fuqishëm për të kritikuar rregullimin kushtetues të Republikës III; regjimi francez i asaj kohe, në të vërtetë, garantoj më shumë rreptësi se në Gjermani për *ligjshmërinë* e veprimit të ekzekutivit ose administratës, meqenëse ai “vë në varësi të ligjit edhe ato akte administrative që nuk i interesojnë drejtpërdrejt dhe individualisht qytetarëve”, por, nga ana tjetër, Kushtetuta Franceze “nuk është në nivelin e perfeksionit të shtetit të së drejtës”, meqenëse ajo nuk e ndalon ligjvënësin që “të ndryshojë” nëpërmjet ligjeve të veçanta “rregullat e përgjithshme të legjislacionit ekzistues” dhe, mbi të gjitha, ligjvënësi nuk i nënshtrohet Kushtetutës, sepse nuk ka kontroll të kushtetutshmërisë së ligjeve, çka pengon mbrojtjen e të drejtave individuale kundër ligjvënësit (Carré de Malberg, 1962, I, 492). Paralelisht Carré de Malberg i rikthehet, për llogari të vet, teorisë së vetëkufizimit, duke e futur atë në fjalorin francez të sovranitetit dhe duke dhënë, për ta përfunduar, një version si të thuash “liberal” të pozitivizmit juridik, gjithnjë duke refuzuar konceptin gjerman të marrëdhënieve shtet-komb: nga pikëpamja e së drejtës kushtetuese franceze, shteti nuk mund të jetë tjetër veçse personifikimi juridik i kombit (shih për të gjitha këto pika Raynaud, 1983). Debati midis këtyre rrymave ka zgjatur shumë gjatë në historinë e mëtejme “të doktrinës”, pasi ai vinte në diskutim çështje themelore, teorike dhe praktike njëkohësisht (Chevalier, 1999; Raynaud, 1985; Redor, 1982). Për ta mbyllur, vërejmë se, midis versionit “gjerman” të teorisë së *Rechtsstaat*-it dhe zhvendosjes që i ka bërë Carré de Malberg, është vazhdimësia që fiton mbi shkëputjen: në të dyja rastet, sintheza midis shqetësimeve liberale dhe të drejtës publike kalon nëpërmjet *pozitivizmit juridik* dhe teorisë liberale të vetëkufizimit të shtetit, ndërkohë që teoria e shtetit të së drejtës, e cila mundëson përforcimin e garancive ndaj shtetasve dhe zgjerimin e veprimit të juridiksioneve, shërben “si mbështetje e fortë në ndërtimin doktrinal të së drejtës administrative në zhvillim” (Chevallier, 1999, 32); përkundrazi, kritikën teorike kryesore për shtetin e së drejtës bien, nga njëra anë mbi përbërjen liberale të saj dhe,

nga ana tjetër, mbi teorinë e “vetëkufizimit”, ndërsa vështirësia e gjuhës angleze për të përkthyer nocionin “shtet i së drejtës” historikisht është e lidhur me dobësinë e “së drejtës administrative” në Angli.

KRITIKAT PËR SHTETIN E SË DREJTËS

I lindur nga një projekt për racionalizimin liberal të shtetit, nocioni i shtetit të së drejtës ka qenë objekt i kritikave të ndryshme, shumica e të cilave janë antiliberale ose antidemokratike, ndërsa një pjesë e tyre, përkundrazi, janë frymëzime demokratike dhe antiautoritare.

Nga ana antiliberale, kritika më radikale dhe më e përpunuar gjendet, pa dyshim, te juristi gjerman Carl Schmitt (1888-1985), vepra e konsiderueshme e të cilit nuk mund të jetë e ndarë nga angazhimi i tij kundër demokracisë liberale, së cilës për një kohë iu desh ta shoqëronte për të mbështetur Rajhun e III (më pas, në Republikën e Weimar-it, ai pati kërkuar ndalimin e partisë naziste, në kuadrin vërtet të një transformimi “autoritar” të Kushtetutës në fuqi; Beaud, 1997). Në veprën e madhe të Schmitt-it mbi *Teorinë e kushtetutës* (1928), diskutimi i parimeve të “shtetit të së drejtës borgjez” synon të nxjerrë në pah karakterin polemizues ose partizan të nocionit “shtet i së drejtës”, gjithnjë duke zbuluar paaftësinë e tij për të kuptuar atë çka shteti liberal modern ruan si “politike”. Në qoftë se do ta merrnim fjalë për fjalë shprehjen “shtet i së drejtës” do të mund “të cilësonim shtet të së drejtës çdo shtet që respekton pa gabuar të drejtën objektive në fuqi dhe të drejtat subjektive ekzistuese”, çka do të çonte në zbatimin e kësaj shprehjeje te format politike më të pafuqishme dhe ndonjëherë edhe arkaike ku “të drejtat e fituara” do të respektoheshin në mënyrë skrupuloze në dëm të vetë kushteve të “ekzistencës politike” ose të “sigurisë së shtetit”: “në këtë kuptim, ish-Rajhu gjerman, perandoria romake e kombit gjerman, ishte një shtet i përkryer i së drejtës në kohën e tij të shpërbërjes; karakteri i tij si shtet i së drejtës nuk ka qenë veçse shfaqja dhe mjeti i shkatërrimit të vet politik” (Schmitt, 1993, 268); mirëpo kuptimi bashëkohor i nocionit është në fakt

thelbësisht polemik: “shteti i së drejtës i kundërvihet pushtetit (*Machstaat*) ashtu si edhe shtetit policor dhe atij hyjnor dhe “çdo lloj tjetër shteti i cili nuk kufizohet vetëm në mbajtjen e rendit juridik” (*po aty*, 268); së fundi, nëse kërkohet t’i jepet një kuptim më i saktë këtij nocioni, i drejtohen parimeve të konstitucionalizmit liberal, ku respekti ndaj të drejtave (individuale) themelore shprehet në ndarjen e pushtetit nga shteti (*po aty*, 264-265), çka çon në “kriteret organizuese” të ndryshme si parimi i ligjshmërisë, ndarja e saktë e kompetencave shtetërore dhe pavarësia e gjyqtarëve, që nxjerrin në krye mbizotërimin e përgjithshëm të formave *juridiksionale* (*allgemeine Justizförmigkeit*) në jetën e shtetit (*po aty*, 268-272). Rezervat e Schmitt-it mbi këtë koncept për shtetin janë fillimisht për karakterin e *njëanshëm* të tij, që çon në mosnjohjen e përmasës specifike të *politike* të rendit juridik, i cili mbështetet mbi *vendimin sovran* dhe jo thjesht në një “sistem normash juridike të destinuara për të mbrojtur individin nga shteti” (*po aty*, 263); Schmitt-i sugjeron kështu se shteti liberal, ngaqë sheh se “shteti i së drejtës” vetë supozon një vendim të tillë paraprak në favor të tij, është edhe hipokrit, edhe i paafat ta kuptojë vetë parimin liberal, i cili kërkon thjesht kufizimin e pushtetit, duke qendruar, nga ana tjetër, i heshtur para çështjes së formave të qeverisjes (*po aty*, 338). Në tekste të tjera Schmitt-i përmend, gjithashtu, përmasën *institucionaliste* të së drejtës, e harruar, sipas tij, nga doktrina e shtetit të së drejtës, pjesërisht e lidhur me idenë e thjeshtë “normativiste” të së drejtës si sistem rregullash abstrakte (shih, p.sh. *Les trois types de la pensée juridique*, përkth., P.U.F., 1995, ku nuk harrohet se bëhet fjalë për rivazhdim të konferencave të vitit 1934).

Në qoftë se teoritë e Schmitt-it mund të jenë parë si një riaktivizim i aspekteve “autoritare” të konceptit gjerman për shtetin, kundër tendencave liberale për shtetin e së drejtës, përkundrazi, vepra e Hans Kelsen, e cila afirmon *identitetin* midis “shtetit” dhe “të drejtës”, mund të jetë parë si një përpjekje për të emancipuar idenë “normativiste” mbi atë çka ideja e *vetëkufizimit* të shtetit e ruante si parademokratike.

Kelsen-i është i njohur si një nga përfaqësuesit e mëdhenj të “pozitivizmit” juridik, dhe për këtë ai bëhet shpesh objekt i kritikave sa rituale aq edhe të kota lidhur me gjoja paaftësinë e “pozitivizmit” për të kritikuar “të drejtën pozitive” kur kjo është dukshëm e padrejtë dhe shtypëse, aty ku këto të fundit kënaqen t’i drejtohen pamundësisë për të bazuar te vetë e drejta nevojën për bindje, si edhe karakterit krejt jojuridik (sepse është moral dhe/ose politik) të normës bazë nga e cila rrjedh e drejta pozitive. Duke e përkufizuar të drejtën si një rend detyrimesh, Kelsen-i ka futur aty fakte jashtëzakonisht shokuese (1962, 55-56), por kjo duhet parë si shprehja e një përpjekjeje për çshenjtërimin e rendit juridik, i cili është, gjithashtu, sipas demokritit Kelsen, kushti paraprak për përcaktimin e kushteve efektive të mbrojtjes së lirisë. Për sa i përket identitetit të shtetit dhe të së drejtës, ai çon në një kritikë të fortë të teorisë së vetëkufizimit (ndoshta këtu të vetëdetyrimit, *Selbstverpflichtung*), e cila tregon se mbështetet në një arsyetim rrethor, përderisa autoriteti i shtetit presupozon një normë që e bën atë subjekt juridik kompetent për të vendosur norma të tjera. Në këtë kuptim shteti është “shtet i së drejtës” dhe “është e pamundur të mendohet një shtet që të mos i jetë nënshtruar së drejtës”, meqënëse “shteti ekziston vetëm në aktet shtetërore, domethënë në akte të kryera nga njerëz që i përkasin shtetit si normë juridike” dhe “termi ‘shtet i së drejtës’ përbën një pleonazëm” (*po aty*, 410-411). Megjithatë Kelsen-i vëren se, në fakt, termi ‘shtet i së drejtës’ në përgjithësi është përdorur thjesht si sinonim i shtetit demokratik që garanton sigurinë juridike, të cilit ai nuk ia mohon aspak veçantinë që ka, krahasuar me shtetet autoritare. Si një jurist praktik, Kelsen-i, që ishte, gjithashtu, edhe një teoricien i madh i demokracisë (Kelsen, 1988), ka qenë në Europën kontinentale një nga promotorët e kontrollit të kushtetutshmërisë, që, ngaqë lejon nënshtrimin e pushtetit legjislativ ndaj “normës themelore”, është një nga vektorët më të fuqishëm të atij që është pranuar të quhet “shtet i së drejtës”. Orientimi antiperandorak i doktrinës së Kelsen-it, i cili frymëzohet në kritikën e tij nga nocioni “vetëdetyrim”, është, gjithashtu, i dukshëm në një tjetër tezë themelore

të “teorisë së pastër të së drejtës”, asaj të unitetit midis së drejtës ndërkombëtare dhe asaj të brendshme, që i kundërvihet qartë tezave të juristëve të perandorisë. Lexuesit më të mirë të Kelsen-it nuk janë gabuar në kuptimin e doktrinës së tij: në periudhën e vet më kritike, Carl Schmitt-i denoncon “normativizmin” si liberal në thelb dhe antipolitik (Schmitt, 1995, 70-80), ndërsa një mendimtar si Raymond Aron, i cili duke qenë liberal, ishte, gjithashtu, një mendimtar “realist” i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe pohonte parapëlqimin e tij për teorinë e “vetëkufizimit” (edhe pse nuk mund të themelojë “forcën detyruese” të së drejtës, kjo teori “i jep formë realitetit historiko-shoqëror) (Aron, 1984, 704-707).

RULE OF LAW DHE SHTETI I SË DREJTËS

Nëse nocioni gjerman *Rechtsstaat* mund të përkthehet lehtë në shumicën e gjuhëve kontinentale, përkthimi i tij në anglisht përbën probleme serioze që nuk janë vetëm gjuhësore. Më e zakonshme është që “*Rechtsstaat*” ose “shteti i së drejtës” të përkthehet me shprehjen “*Rule of Law*”. Nga pikëpamja gjuhësore shtrohet problemi i kuptimit të dyfishtë të fjalës “*Law*”, e cila do të thotë njëkohësisht edhe “e drejta” edhe “ligji”, ndërkohë që “të drejtat subjektive” më shumë njihen me fjalën “*Rights*” (shih artikullin *Law dhe Rights*); kjo nuk është gjëja më e rëndësishme, sepse mbi të gjitha duhet shënuar që *përmbajtja juridiko-politike* e konceptit të “*Rule of Law*” është mjaft e ndryshme nga “shteti i së drejtës”. Aq më tepër që në koherencën formale të një sistemi normash shtetërore nocioni *Rule of Law* të çon te disa kriteret *thelbësore* dhe *procedurale* të legjitimitetit të qeveritarëve dhe normave juridike: ai nga njëra anë do të thotë se në organizimin e “*qeverisë*” ligji duhet të vihet mbi njerëzit (sipas idesë klasike që nis me filozofinë greke) dhe, nga ana tjetër, që legjislacioni dhe procesi juridiksional duhet të paraqesin disa cilësi *procedurale* (shih nocioni amerikan i “*due process of Law*”), i cili do përkthehej në përgjithësi me “procedurë paanshme”; kështu, aty ku shteti i së drejtës këshillon mbi të gjitha *një mjet*

(hierarkinë e normave), pikërisht për të arritur një rezultat të caktuar (lirinë), *Rule of Law* përcakton shumë më saktë rezultatin, mirëpo nuk tregon asnjë mjet për ta arritur atë (Troper, 1992, 63). Përveç kësaj vështirësia dyfishohet nga origjinat *angleze* të nocionit, aq sa Kushtetuta Angleze është pak e përshtatshme me normat e konstitucionalizmit bashkëkohor; autori klasik këtu është juristi i madh A.V.Dicey (1835-1922), i cili tregoi se regjimi anglez mbështetet në një ekuilibër të mprehtë midis sovranitetit të Parlamentit (i cili përjashton kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve) nga njëra anë, dhe nga ana tjetër *Rule of Law* (që kërkon që administrata të varet nga *Common Law* dhe që nëpunësit, si të gjithë qytetarët, të përgjigjen para gjykatës të zakonshme, çka që nuk përputhet me idenë “kontinentale” dhe pikërisht atë franceze të “së drejtës administrative”); pasoja e kësaj doktrine është që Mbretëria e Bashkuar, nga njëra anë, nuk është një “shtet i së drejtës” për shkak të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe që Franca, nga ana tjetër, nuk jeton sipas “*Rule of Law*”, nga fakti i ekzistencës së një të drejte administrative që vjen nga një juridiksion specifik (shih Mockle, 1994). Sfidat praktike janë sot më pak të rëndësishme sesa në fillim të shekullit të kaluar, për faktin e zhvillimit “liberal” të së drejtës administrative, si dhe të rëndësisë së konstitucionalizmit *amerikan* në kulturën e juristëve dhe të filozofëve të gjuhës angleze; madje edhe në ditët e sotme autorët anglezë ose amerikanë me fjalët *Rule of Law* nuk kuptojnë krejtësisht të njëjtën gjë që juristët ose filozofët kuptojnë me “shtet i së drejtës” (prandaj ata më rigorozët mes tyre e përkthejnë *Rechtstaat* me *constitutionnal government* dhe jo me *Rule of Law*; Troper, 1992, 54).

2/ DEBATET AMERIKANE

Që prej pothuajse pesëmbëdhjetë vitesh debatet amerikane për natyrën e pushtetit gjyqësor dhe në mënyrë të veçantë për rolin e Gjykatës Supreme në procesin kushtetues, janë zotëruar nga një diskutim i përsëritur që mund të përmbledhjet në kundërshtimin midis doktrinës së “qëllimit origjinal”

(*original intent*) të përbërësve dhe asaj të “kushtetutës së gjallë” (*living constitution*), që nuk është thjesht një historicizëm, meqenëse është e pandarë nga ajo çka mbrojtësi më i shquar, Ronald Dworkin, e quan në një mënyrë domethënëse “lexim moral” (*moral reading*) të Kushtetutës. Këto debate janë shpeshherë të errëta dhe ngandonjëherë të gjalla, sepse ato janë vënë në dukje, nga të gjitha drejtimit, me dredhi, çka nuk e përjashton edhe moskuptimin. Për këtë, pa dyshim, shumica e praktikuesve të së drejtës amerikane qëndrojnë në përgjithësi në pozita të kujdesshme eklektike dhe tentojnë që t’i kthejnë protagonistët kurriz më kurriz, pa u dhënë të drejtë asnjërit; megjithatë ato fusin në lojë probleme madhore të Kushtetutës Amerikane dhe të teorisë demokratike, siç janë ato lidhur me natyrën e *interpretimit* të ligjeve kushtetuese nga gjyqtari dhe me rolin e *kohës* në formimin e së drejtës: duke kufizuar në minimum pushtetet e gjyqtarit kushtetues, doktrina e *original intent*-it çon dukshëm në privilegjimin e vullnetit të shkuar ose të tashëm të konstitucionalistit ose ligjvënësit, ndërsa ideja e *living constitution*-it u jep një vend të rëndësishëm interpretimeve të prodhuara nga gjyqtarët në një proces që paraqitet njëkohësisht i nënshtruar ndaj “së drejtës” dhe i orientuar drejt së ardhmes. Duke u përpjekur që të kalojmë këtë dilemë, do të përpiqemi këtu, pasi të flasim për kontekstin politik (I) dhe institucional të diskutimeve bashkëkohore (II), të nxjerrim sfidat kryesore teorike para se të skicojmë, si përfundim, një interpretim të bazuar në një vështrim të shkurtër të origjinave të konstitucionalizmit amerikan.

I/ ZHVILLIMI I REGJIMIT AMERIKAN

Sfida më e dukshme e debateve të sotme amerikane është *juridike* dhe *politike* njëkohësisht: përtej polemikës teorike, problemi më i madh (i cili ishte haptas në qendër të përpjekjes së dështuar për emërimin e gjyqtarit Bork në Gjykatën Supreme) është në të vërtetë ai i vlerësimit të jurisprudencës së hartuar nga Gjykata Supreme me *Chief Justice* Warren, i cili kishte lejuar realizimin e një pjese të konsiderueshme të programit tradicional të “liberalëve”

amerikanë (domethënë të së majtës së moderuar) në rrugë krejt të ndryshme nga ato të ndjekura prej Roosvelt-it. Në të vërtetë, në kohën e *New Deal*-it, demokratët i kishte udhëhequr logjika e institucioneve. Ata donin të krijonin elementet e parë të një sistemi kombëtar të mbrojtjes sociale në konflikt frontal me Gjykatën Supreme, jurisprudenca e së cilës, e bazuar në një interpretim njëherësh detyrues dhe tepër të shtrirë të lirisë kontraktuale dhe të ‘*due process of Law*’, kufizonte në mënyrë të konsiderueshme ndërhyrjet e pushtetit politik ose të administratës në çështjet “sociale”; në sajë të mbështetjes së zgjedhësve, Roosvelt-i triumfoi në këtë konflikt, duke u mbështetur në një interpretim të qartë demokratik të regjimit amerikan: refuzimi i jurisprudencës së kësaj gjykate, sipas tij, nuk mund të ngatërrohej me opozitën ndaj Kushtetutës, meqenëse, tek ajo, tri degët e qeverisjes (legjislativi, ekzekutivi, gjyqësori) s’ishin gjë tjetër veçse “buajt” e një pende, ku “karrocieri” ishte vetë “populli” amerikan, vullneti i të cilit shprehej kryesisht nëpërmjet zgjedhjeve, edhe pse regjimi parashikonte kundërpesha ndaj logjikës mazhoritare. Sado radikal që të ishte, qëndrimi i Roosvelt-it mund të autorizohet edhe nga disa paraardhës me emër (presidentët Jefferson, Jackson dhe Lincoln kishin mbajtur tashmë pozita mjaft të ngjashme) dhe, mbi të gjitha, ai shkonte fare dukshëm me tendencat e demokracisë radikale, e cila ka tentuar gjithmonë të kishte parasysh logjikën mazhoritare nëpërmjet mekanizmit të mprehtë të ‘*check and balances*’. Krejt ndryshe ndodhi me transformimet e realizuara pas luftës së viteve ’70-të, të cilat sigurisht që mund të konsiderohen si fryte të vonuara të *impulse*-t të dhënë nga Roosvelt-i, por që shpesh, për të plotësuar dobësinë e mekanizmave mazhoritare, kishin nevojë për një ndërhyrje nga Gjykata Supreme në favor të “liberalëve”, për shumë çështje vendimtare, duke filluar me dallimin racial (*Brown vs Board of Education of Topeka*, 1954), tek *affirmative action* (*Bakke*, 1977), për të kaluar te liberalizimi i abortit (*Roe vs Wade*, 1973). Roli – ndonjëherë politikisht vendimtar – i luajtur këtu nga “*judicial review*” i ligjeve, sollti një ndryshim të thellë, por tepër të kuptueshëm të perceptimit të

funksioneve *politike* të Gjykatës, për të cilën mund të themi skematikisht se i ka çuar konservatorët dhe progresistët të luftojnë me ballin lart: të parët e kanë denoncuar “aktivizmin gjyqësor” si një uzurpim, ndërsa të dytët zbulonin meritat e kufijve të kundërshtuar nga gjyqtarët nëpërmjet logjikës mazhoritare, që pa dyshim në Francën e sotme mund të cilësohet si “populiste”.

Megjithatë do të ishte gabim nëse debatet teorike bashkëkohore do të reduktoheshin në një opozitë të tillë midis “aktivizmit gjyqësor” dhe populizmit mazhoritar, i cili i korrespondon më shumë mënyrës me të cilën çdo kamp paraqet dhe karikaturon pozicionin e kampit kundërshtar: Dworkin-i, përkundrazi, bën shumë përpjekje për të mos u dukur si mbrojtës i “*judicial activism*”¹-it (sh. *Taking Rights seriously*, 1977, 137) dhe gjyqtari Bork nuk harron, kur i jepet rasti, të përmendë, në mbështetje të kauzës së vet, karakterin “kundërmazhoritar” të Kushtetutës². Në të vërtetë shkelja ndodh në një rrethanë retorike të madhe (referimi të “Kushtetuta Amerikane”), e cila i detyron pjesëmarrësit të marrin përgjegjësinë për disa aksioma të mëdha të traditës kushtetuese amerikane dhe t’i paraqesin doktrinat e tyre si një formulim të qartë të kuptimit të kësaj tradite; mirëpo kjo traditë është pazgjydhshëmrisht “liberale” dhe “demokratike”, në kuptimin që ajo pohon njëkohësisht nevojën për *self-gouvernement* dhe kërkesën për mbrojtje të frytshme të qytetarëve ndaj shpërdorimeve të mundshme të pushtetit ekzekutiv ose legjislativ; interpretimet e detyrës së pushtetit gjyqësor duhet pra, në një mënyrë ose në një tjetër, të rimarrin disa tema madhore: një doktrinë kushtetuese do të ishte e besueshme vetëm nëse do të ishte e përshtatshme me “konstitucionalizmin” (pra, me epërsinë e Kushtetutës dhe “të të drejtave kushtetuese” ndaj legjisllacionit të zakonshëm) dhe nëse do të lejonte të dalloheshin normat e

¹ Shih, për shembull, Ronald Dworkin, *Taking Rights seriously*, Cambridge, Mas., Harvard U.P., 1977, 137.

² Shih, për shembull, Robert H. Bork, *The Tempting of America. The Political Seduction of the Law*, The Free Press, 1990, 173.

mirëfillta “juridike” (*legal*) nga çështjet “politike”, të lëna në vlerësimin e ligjvënësve ose të pushtetit ekzekutiv; gjithashtu ajo do të duhet të mundësojë një interpretim të historisë kushtetuese të Shteteve të Bashkuara, i cili të tregojë *vazhdimësinë* e qartë të Kushtetutës që prej ratifikimit të vitit 1789, gjithnjë duke legjitimuar, të paktën pjesërisht, ndryshimet e regjimeve politike dhe të së drejtës amerikane. Kështu doktrinat në garë dallohen njëherësh nga interpretimi i tyre *juridik* i logjikës së konstitucionalizmit amerikan dhe nga vlerësimi i tyre politik i shndërrimeve të mëvonshme të sistemit politik të Shteteve të Bashkuara. Pikërisht duke u nisur nga këto çështje, ne do të paraqesim doktrinat kontradiktore të *original intent*-it dhe të *living constitution*-it, para se të shqyrtojmë një pozicion të tretë, i cili pretendon se e tejkalon këtë debat, duke i dhënë një bazë “civile” ose “politike” më shumë sesa “juridike” ndryshimeve të demokracisë amerikane.

II/ “ORIGINAL INTENT”-I DHE “LIVING CONSTITUTION”-I

(1) Ashtu siç shprehet te Bork-u, doktrina e *original intent*-it duket në pamje të parë më e gjetur dhe më pak reaksionare se karikaturat që i bëhen shpeshherë. Në planin politik Bork-u nuk flet hapur në favor të anulimit të të gjitha *rezultateve* të punës së trupit gjykues me emrin Warren, edhe pse ai e kundërshton doktrinën kushtetuese mbi të cilën u ngrit ky trup gjykues: për shembull, ai përpiqet të tregojë se mund t’u imponohej *Shteteve* fundi i dallimit racial, duke u mbështetur në mënyrë jo të drejtpërdrejtë tek *original intent*-i i pas Luftës Civile³; më tej, ai nuk kërkonte ndonjë angazhim të qartë konservator të gjykatës për çështjet “morale” si aborti ose dënimi me vdekje, pasi ai paraqitej si një mendimtar skeptik dhe si një jurist i lidhur me asnjësinë morale të trupave gjykuese: ashtu si Kushtetuta afirmon kërkesën për *self-government*, në të njëjtën kohë me mbrojtjen e “të drejtave”, po ashtu, thotë ai, u takon autoriteteve të zgjidhin çështjet morale, në dritën e

³ Robert H. Bork, *vep. e cit.*, f. 74-84.

opinionit të *Common Law* dhe jo të ndonjë “filozofie morale” të dyshimtë⁴. Për sa i përket kuptimit të fundit të doktrinës së tij, ai mbrohet fuqishëm ndaj idesë se kjo doktrinë kërkon që të udhëhiqemi nga të vdekurit: këta, thotë ai, janë kundërshtarët e saj që pretendojnë në fakt të pengojnë *self-government*-in e të gjallëve⁵.

Por do të ishte gabim nëse do të besohej se refuzimi i tezave të Bork-ut nga opinioni liberal mbështetet krejtësisht në një keqkuptim, sado që është e qartë se ai nga ana e tij përmend të gjitha lidhjet e përbashkëta të kritikës konservatore me “liberalizimin” bashkëkohor, duke filluar me denoncimin e “relativizmit liberal” të paqartë ndaj liberalizimit të zakoneve deri në denoncimin e pushtetit të fshehtë të “klasës së re”, e cila u ka imponuar amerikanëve një revolucion, sfidat e të cilit asnjëherë nuk janë diskutuar qartë para qytetarëve. Tema *original intent*, që përfshin një ermeneutikë tepër elementare dhe shumë pak të mundshme në sytë e shumicës së juristëve⁶, duhet edhe ajo vetë të zëvendësohet në kontekstin e një debati të mbetur tashmë në kulturën e sotme amerikane, ku logjika partizane fiton mjaft pastër mbi rreptësinë filozofike. Nëpërmjet temës së “shkatërrimit”, një pjesë e mendimtarëve “radikalë” e ka kthyer rëndësinë e interpretimit në instrument të një kritike të përgjithshme të traditave morale mbizotëruese dhe, si reagim, sektorë të ndryshëm të opinionit “konservator” kanë konsideruar se kauza e tyre kalonte nga një refuzim global i të gjitha formave të “relativizmit” dhe, mbi të gjitha, nga mbrojtja e idesë se për çdo ligj kishte një *kuptim* uniform, i cili mund të shfaqej menjëherë, që në transparencën e parë. Aty, në diskutimet filozofike të këtyre situatave tepër qesharake, ku “shtrausianët” – pretenduesit për trashëgimtarë të një tradite tipike fenomenologjike – shihen të denoncojnë pjesëmarrjen në përmbysjen e veprës

⁴ *Po aty*, f.178.

⁵ *Po aty*, f.171.

⁶ *Shih Stéphane Rials, “Entre artificialisme et idolâtre”, Le débat nr.64, 1991, f. 167-168.*

së Gadamar-it (*sic*) për të mikluar një lloj sensibiliteti fondamentalist, ndërsa “radikalët” i bëjnë Heidegger-in dhe Nietzsche-n zëdhënës të një “shkatërrimi” të sundimit të meshkujve të bardhë perëndimorë; po aty, gjithashtu, në debatin juridik, sukseksi i temës së “*original intent*”-it, po dukej se mund t’i jepte një goditje ndaluese asaj jurisprudence, ku filozofia morale dhe interpretimi ishin thjesht maska të një qëllimi politik të pashfaqur.

Për t’iu përmbajtur interpretimit “borkian” të historisë kushtetuese amerikane, thjesht do të vërejmë se, në qoftë se ajo vetvetiu nuk ka një farë zotësie politike, përfundon në shumë pak ndriçuese, pasi shfaqet me një *lamento* të gjatë për rënien amerikane, e cila duket gjithashtu e paaftë për të menduar për transformimet demokratike, sa edhe për të ndriçuar logjikën juridiksionale të zhvillimit të së drejtës kushtetuese. Nga njëra anë, në të vërtetë, përpjekjet e gjykatës për të “zbuluar” në logjikën e Kushtetutës “parimet” e një përgjigjeje për çështjet e reja, të cilat pushteti politik nuk do të dinte t’i rregullonte vetë, duken më shumë si një uzurpim (siç ishte rasti, thotë Bork me shkathtësi, për jurisprudence anti-*Welfare* të periudhës pararuzveltiane); nga ana tjetër, transformimet e pësuar nga regjimet politike, si pasojë e garave të tyre zgjedhore, nuk janë më legjitime, për shkak se është vepruar qartësisht sipas nenit V të Kushtetutës.⁷ Koha juridike është reduktuar kështu në përsëritjen e thjeshtë të precedentëve (me kusht që këta të jenë të autorizuar nga “qëllimi i hershëm” i konstitucionalistëve), gjithnjë duke gjetur burimin e vet te çasti i “krijimit”, përfaqësuese kryesore e të cilit është vetë përsëritja.

(2) Edhe pse në dukje, pa dyshim, është më e kohës, teoria e Dworkin-it mund të shihet si një antitezë pothuajse e përkryer e asaj të Bork-ut, megjithëse ajo shtron të njëjtat probleme me të. Politikisht Dworkin-i është një liberal, kështu që përfundimet e tij juridike janë në përshtatje me ortodoksinë e qartë (ai mbron *veprimin pohues* dhe të drejtën *kushtetuese* për abort, e vë pornografinë nën mbrojtjen e amendamentit të parë, pohon

⁷ *Vep. e cit.*, f. 215.

epërsinë e lirisë ndaj sigurisë) dhe, mbi të gjitha, synon të tregojë se roli i luajtur nga Gjykata Supreme në zhvillimin e demokracisë amerikane ishte i bazuar juridikisht dhe jo thjesht i mbështetur politikisht. Për këtë ai ka dhënë shumë mendime, ku merita kryesore është, pa dyshim, propozimi për një kritikë origjinale ndaj pozitivizmit juridik, sigurisht e përshtatur më mirë sesa versionet e zakonshme të së “drejtës natyrore” me të kuptuarit e “vetvetishëm” të veprimtarisë së gjyqtarit kushtetues. Duke diskutuar tezat e Austin-it e, mbi të gjitha ato të Hart-it, Dworkin-i kundërshton reduktimin e së drejtës në disa *rregulla* që përcaktojnë se cilat qëndrime janë të ligjshme dhe cilat duhen qortuar, për të propozuar një teori që të lejojë njëkohësisht me *shtrirjen e fuqive të gjyqtarit në marrëdhëniet e tij me autoritetet “politike”* edhe *shpëtimin nga akuza e “judicial activism”-it*. Sipas doktrinës së Hart-it, gjyqtari ka pushtetin e hartimit të rregullave plotësuese, kur e drejta në fuqi nuk mjafton për të zgjidhur një rast; ndërsa sipas asaj të Dworkin-it, gjyqtari nuk krijon rregulla të reja, pasi ai priret të mbështetet dhe duhet të mbështetet në “parime”, të cilat nuk e fitojnë vlefshmërinë e tyre nga fakti se i ka vendosur një autoritet, por ngaqë ato rrjedhin nga kërkesat e përgjithshme të drejtësisë ose paanshmërisë që mbahen si kuptimi i së drejtës në fuqi. Pra, gjyqtari kushtetues mund ta censurojë ligjvënësin, pa patur nevojë që të mbështetet në tekstin e kushtetutës, jo sepse ai ka uzurpuar ndonjë funksion *politik*, por ngaqë ai nuk bën gjë tjetër veçse “zbulon” një të drejtë tashmë të pranishme, pa qenë nevoja t’ia nënshtrojë ligjin ndonjë procesi në instanca më të larta. Në mungesë të mundësisë për të propozuar këtu një diskutim për tërësinë e këtij ndërtimi elegant dhe tërheqës, i cili ka meritën e një formulimi shumë të qartë të disa prejerve të forta të së drejtës bashkëkohore⁸, do të mjaftohemi me disa komente rreth pasojave të saj në problemet e *kohës* dhe të *interpretimit*, para se të përmendim vështirësitë kryesore të kësaj doktrine nga pikëpamja e teorisë demokratike.

⁸ Shih për të gjitha këto pika Ph. Raynaud, “La démocratie saisie par le droit”, *Shënime të fondacionit Saint-Simon*, shtator 1995 dhe *Debat* (*Le débat*), nr.87, nëntor-dhjetor 1995.

Forca e argumentimit të Dworkin-it, i cili, ndonëse u është referuar filozofëve si Kant ose John Stuart Mill dhe është mbështetur nga tradita e gjatë e *Common Law*-t, vjen ngaqë ai propozon një konceptim të karakterit të përkohshëm juridik, që afirmon *vazhdimësinë* e së drejtës, pa qenë kështu e mbyllur në pasigurinë e së ardhmes. Në konceptimin e Dworkin-it, në të vërtetë, novacionet e prodhuara nga juridiksionet nuk janë “përmbysje” të jurisprudence por fryte të “zbulimit” të pjesëmarrjeve të atyre parimeve që ishin tashmë të pranishme në drejtësi. Kështu, për shembull, vendimi për *Brown kundër Board of Education*, që nxorri jashtë ligjit dallimin racial nga Gjykata Supreme, nuk e anulon vendimin *Plessys kundër Ferguson*, i cili e kishte lejuar dallimin racial në emër të parimit “të ndarë, por të barabartë”: kjo ngaqë është provuar se, siç e ka treguar edhe përvoja, edhe kjo e ndriçuar nga shkencat sociale, dallimi racial (thjesht si një masë politike) është i papajtueshëm me barazinë (e cila është parim i së drejtës kushtetuese). Dworkin-i e pasqyron doktrinën e tij nëpërmjet një krahasimi, i bërë tashmë i njohur, atij midis “zinxhirit të së drejtës” dhe krijimit të një romani të madh që shkruhet nga autorë të cilët vijnë pas njëri-tjetrit në kohë: që të shkruajë pjesën e vet, çdo romancieri i duhet të ketë parasysh krerët paraardhës, me qëllim që të ruhet në roman një unitet i mjaftueshëm për ta marrë atë si një tregim të vetëm; kështu edhe kompleksiteti i kësaj detyre pasqyron vështirësitë që hasin gjyqtarët kur, duke u ndeshur me “raste të vështira” (*hard cases*), ata duhet t’i zgjidhin duke respektuar të drejtën në tërësinë e saj (*under law as integrity*)⁹. Pra, veprimtaria e gjyqtarit nuk kufizohet, ashtu si te Bork-u, vetëm në të kuptuarit e fakteve nën dritën e precedentëve ose në kërkimin e “qëllimit” të ligjvënësit ose konstitucionalistit, por, megjithatë, nuk është një krijim i lirë i interpretimit ose i vullnetit: gjyqtari duhet të respektojë idenë që përshkon tregimin dhe, pra, duhet t’ia ndalojë vetes të kundërshtojë krerët

⁹ Ronald Dworkin, *Law’s Empire*, Cambridge Mas., *The Belknap Press of Harvard University Press*, 1986, f.229.

paraprirës. Kështu Dworkin-i e shtyn më tej refuzimin e shpallur nga “*judicial activism*”, pasi ai shkon deri atje sa të thotë që për çdo rast në drejtësi ekziston vetëm “një përgjigje e mirë”, e cila rrjedh nga logjika e parimeve dhe rregullave¹⁰, edhe pse evoluimi i shijeve (dhe i zakoneve...) prej krerëve të parë deri tek ata të fundit mund të lejojë njëfarë ndryshimi të atmosferës romaneske (duhet shënuar, përveç kësaj, se doktrina e “përgjigjes së mirë” e mohon vlefshmërinë e aktivizimit të gjyqtarit për të autorizuar më mirë korrigjimin e gabimeve të shfaqura gjatë krijimit të romanit të së drejtës).

Kjo teori kaq elegante pa dyshim që është shumë e dobishme për një jurist, sepse ajo lejon, si të thuash, kthimin e të drejtës kushtetuese në një “të drejtë të përgjithshme” në drejtësi, gjithnjë duke e zvogëluar diferencën midis doktrinës dhe jurisprudencës. Megjithëkëtë më duket se në dy pika të rëndësishme ajo nuk pajtohet me vetë natyrën e së drejtës kushtetuese amerikane, çka shpjegon kështu faktin se pse ajo nuk ka triumfuar asnjëherë mbi doktrinën konkurrente. Vështirësia e parë, e cila, mesa di unë, nuk ka një zgjidhje të qartë në veprën e Dworkin-it, ka të bëjë me statusin e *opinioneve përçarëse*, publikimi i të cilave me vendimet e gjykatës nxjerr hapur statusin e “opinionit mazhoritar” të këtyre të fundit, gjithnjë duke formuar argumentet e disponueshme për ata që do të donin të punonin për ndonjë ndryshim të “Kushtetutës aktuale”; zgjidhja më e thjeshtë e kësaj vështirësie do të ishte pa dyshim që “opinionet përçarëse” thjesht të tregojnë ndarjen e mundshme në gjykimin efektiv të gjyqtarit nga ajo që duhet të ishte në konceptin e tij, por kjo më duket se mund të krijonte një të çarë të rrezikshme në doktrinë, duke nxjerrë në pah pasigurinë e përgjigjeve të sjella nga gjykata. Vështirësia e dytë është, si të thuash, e natyrës estetike: ajo ka të bëjë me rëndësinë e figurës së “romanit të madh” si përfaqësues i ndjeshëm i “zinxhirit të së drejtës”. Nëse e krahasojmë këtë figurë me historinë e së drejtës kushtetuese amerikane, do të vërejmë vetëm se ajo është e përshkuar nga befasi dhe

¹⁰ Ronald Dworkin, *A Matter of Principle*, Cambridge, Mas., *Harvard O.P.*, f. 119-145.

përmbysje të papritura që të kujtojnë më shumë romanet popullore si *Lufta dhe Paqja* ose *Madame Bovari*: aty në të vërtetë çdo gjë ndodh si në këto seri romaneske, ku një personazh, që mendohej se kishte vdekur, rishfaqet për të kënaqur kërkesat e lexuesve, të lidhur shumë pas modeleve të tipit *happy end* sesa dramave të pakthyeshme (Sherlock Holmes kishte rënë në humnerë bashkë me Profesor Moriarty, por kishte shpëtuar nga vdekja për të vazhduar fshehurazi veprën e tij, për të bërë drejtësi para se të rishfaqej për kënaqësinë e publikut). Kjo e metë e vogël zhduket megjithëkëtë, nëse pranohet ajo që nuk ka bërë Dworkin-i, se gjyqtari është këtu më pak romancieri sesa personazhi i një intrige që ai nuk e sundon, dhe që “autori” i së cilës, fatkeqësisht jo “i dukshëm”, është vetëm populli amerikan, ai “*We the People*”, që mendohet se flet në fillim të tekstit të Kushtetutës. Kjo gjë është veçanërisht e qartë për sa i përket çështjes së dallimit racial, ku çdo gjë nis nga amendamentet e pas Luftës Civile dhe ku jurisprudenca e matur e Gjykatës Supreme ka lulëzuar vetëm në përfundim të një procesi politik, i cili nga njëra anë ka lejuar të pranohet papajtueshmëria mes “parimeve” të Kushtetutës dhe pabarazisë raciale dhe, nga ana tjetër, të kufizohen privilegjet e shtetit në fushën e të drejtave civile: që *parimet* të ishin të qarta, në radhë të parë duheshin ndryshuar *rregullat*; përballë kundërshtimeve të Dworkin-it, trashëgimtarët “pozitivistë” të Hart-it nuk do të ishin, pra, domosdoshmërisht pa argumente.

(3) Për të dalë nga kjo vështirësi, pa dyshim që duhet pranuar se e drejta kushtetuese amerikane nuk i nënshtrohet vetëm detyrimit të arsytimit që prodhon ndërveprimi i “rregullave” me “parimet”, por ajo është, gjithashtu, fryt i një veprimtarie, e cila nuk kufizohet vetëm në “zbulimin” e moralit të tekstit kushtetues (Dworkin), as në sqarimin e plotë, si në çastin pothuajse mitik të themelimit ose të paktën në format aq solemne të nenit V, të “qëllimeve” të konstitucionalistit (Bork). Është meritë e punimeve të Bruce Ackerman-it¹¹ që (ri)hapi rrugën e tretë, duke propozuar një interpretim “dualist” të Kushtetutës Amerikane, e pakufizuar si për legjicentrizmin

“monist” (që e përfshin pushtetin kushtetues të legjislativi), ashtu edhe për “themelizimin e të drejtave” (që ia nënshtron tërësinë e procesit politik disa normave thujse të larta dhe gjithësesi të paarritshme për çdo rishikim). Për mua ky interpretim, i mbështetur në një rilexim të pasur, ndonëse ndonjëherë i diskutueshëm i historisë kushtetuese, ka dy merita të mëdha. Merita e parë është të bërit drejtësi në tërësinë e jurisprudencës së Gjykatës Supreme, duke e interpretuar atë si një vepër që gjithnjë mund të rishikohet si një *sintezë* e çasteve të njëpasnjëshme të zhvillimit të “Kushtetutës”. Merita tjetër është të dhënë tuptim atyre *tensioneve* që përshkojnë “demokracinë kushtetuese” që prej themelimit të saj, duke treguar fare mirë se si logjika e përfaqësimit, e kombinuar me atë të konstitucionalizmit, kontrollon njëherësh mbizotërimin “liberal” të sferës private dhe vigjilencën republikane të qytetarëve, duke e lidhur fitimin e të drejtave me zhvillimin e demokracisë.

“Dualizmi” nuk është pa pasoja në marrëdhënien midis “kohës” kushtetuese dhe veprimtarisë “interpretuese” të gjyqtarit. Ai supozon se zinxhiri i së drejtës mund të jetë, në mos i ndërprerë, të paktën i ribërë nga një veprimtari kushtetuese, format e së cilës nuk katandisen në procedurën strikte të amendimit: *vazhdimësia* e së drejtës mbështetet nga shkëputje reale, të cilat zgjidhin çështje, për të cilat ndoshta nuk kishte një “përgjigje të mirë”. Përveç kësaj ai përfshin njëfarë konceptimi të gjyqtarit, njëherësh më të guximshëm dhe realisht më modest sesa ato konceptime të cilave u referohen vëllezërit armiq të *original intent*-it dhe *living constitution*-it: këtu gjyqtari kushtetues nuk mund të mburret as për transparencën e vullnetit të konstitucionalistit, as për arsyen e plotë të së “drejtës”, për shkak të mungesës së mundësisë për t’u mbështetur në kufirin përfundimtar midis së drejtës dhe “politikës”.

¹¹ Bruce Ackerman, *We the people, Foundation*, 1991, përkth. Paris, Calmann-Lévy, 1998, *Au nom du -peuple. Les fondements de la démocratie américaine* (Në emër të popullit. Themelet e demokracisë amerikane).

Doktrina e Ackerman-it, ashtu si edhe ajo e Dworkin-it dhe Bork-ut, sigurisht që ka edhe përfshirje politike të menjëhershme, edhe rëndësi teorike më të gjerë. Politikisht ajo shpreh shqetësimet e atyre liberalëve, të cilët, para mundësisë së një zhvillimi “konservator” të Gjykatës Supreme, rizbulojnë vetitë e harruara të sovranitetit popullor, duke patur parasysh se “arritjet” e fundit të demokracisë amerikane (si e drejta për abort) ndoshta do të ishin më mirë të garantuara nëse shfaqeshin si rezultat i kompromiseve politike, sesa si rrjedhojë e “të drejtave themelore” tepër të diskutuara. Ky pozicion më shumë “demokratik” sesa “liberal” nuk kalon pa njëfarë skepticizmi mbi kapacitetin përgjithësues të të drejtave dhe parimeve që informojnë drejtpërdrejt për funksionimin e demokracive. Për këtë pikë mund të krahasojmë mendimin e Ackerman-it për veprat e Cass R. Sunstein¹², i cili ka një vizion tepër zvogëlues për funksionin e gjykatave në demokraci, gjithnjë duke u përpjekur të tregojë se, edhe në regjimet përfaqësuese, “është veprimtaria e gjallë e qytetarëve që prodhon vërtet drejtësi”; sipas Sunstein-it, në të vërtetë, gjyqtari mund të shërbejë si ndërmjetës midis interesave të ndryshme në konflikt jo duke treguar parimet, por përkundrazi, duke zgjidhur raste të veçanta (“gjyqtarët e kufizojnë enkas spektrin e vendimeve të tyre, me qëllim që të shmangin rihapjen e debateve të gjera”, e pikërisht në “të tilla marrëveshje jo plotësisht teorike” qëndron kontributi i tyre në jetën demokratike, i cili supozon *kompromise* ndërmjet vizioneve që gjithnjë do të jenë të papajtueshme). Do të vërejmë këtu se, nëse tezat e Dworkin-it kanë qenë me të drejtë afër atyre të Habermas-it (për të cilin demokracia mbështetet në përgjithësimin e parimeve të fshehura nga interesat në konflikt), logjika e demokratëve dualistë, përkundrazi, i çon ata të pranojnë një minimum “vendosmërie”, duke vlerësuar kompromisin mbi mirënjohjen.

REFERENCA:

Cesare Beccaria. Thomas Hobbes.

¹² Cass R. Sunstein, *The Partial Constitution*, Harvard, 1993; *Legal Reasoning and Political Conflict*, Oxford, 1996.

Raymond Carré de Malberg. Léon Duguit. Maurice Hauriou. Hans Kelsen. Carl Schmitt.

Bruce Ackerman. Robert H. Bork. Ronald Dworkin. William H. Rehnquist. Cass R. Sunstein.

Olivier Beaud. Jacques Chevallier. Blandine Kriegel. Philippe Raynaud. Marie-José Redor.

KONCEPTE:

Machtstaat. Polizeistaat. Rechtsstaat. Selbstverpflichtung. Selbstbindung. Selbstbeschränkung.

Rule of Law.

BIBLIOGRAFI

1/ *Teoritë europiane për shtetin e së drejtës*

Raymond Carré de Malberg, *Contribution à la théorie générale de l'Etat* (1920), ribot. Botim i C.N.R.S., 2 vëll. 1962. Léon Duguit, *Traité de droit constitutionnel*, 5 vëll., botimi i tretë, Paris, 1927-1930. Maurice Hauriou, *Traité de droit constitutionnel*, bot. i dytë (1929), botim i C.N.R.S., 1965. Hans Kelsen, *Théorie pure du droit*, përkth., Paris, Dalloz, 1962. Carl Schmitt, *Théorie de la constitution* (1928), përkth. Paris, P.U.F., kol. "Léviathan", 1993; *Les trois types de pensée juridique* (1934-1944), përkth. Paris, P.U.F., 1995.

Olivier Beaud, *Les derniers jours de Weimar. Carl Schmitt face à l'avènement du nazisme*, Paris, Descartes dhe Cie, 1997. Jacques Chevallier, *L'état de droit*, bot. i tretë, Paris, Montchrestien, kol. "Clefs". Blandine Kriegel, *L'état et les esclaves*, bot. i tretë, Paris, Payot, 1989. Jürgen Habermas, *Droit et démocratie*, përkth. Paris, Gallimard, 1997. Philippe Raynaud, "Des droits de l'homme à l'Etat de droit chez les théoriciens français classiques du droit public", *Droits*, nr.2, 1985, f. 61-73; "Juge" in Ph. Raynaud dhe Stéphane Rials (bot.), *Dictionnaire de philosophie politique*. M. J.

Redor, *De l'Etat légal à l'Etat de droit. L'évolution de la doctrine publiciste française 1879-1914*, Paris, Economica, 1992. Michel Troper, "Le concept d'Etat de droit", *Droits* nr.15, 1992, f. 51-63.

2/ *Debatet amerikane*

Bruce Ackerman, *We the people, Foundations*, 1991, përkth. Paris, Calmann-Lévy, 1998, *Au nom du peuple. Les fondements de la démocratie américaine*, Robert H. Bork, *The Tempting of America. The Political Seduction of the Law*, *The Free Press*, 1990.

Ronald Dworkin, *Taking Rights seriously*, Cambridge, Mas., *Harvard U.P.*, 1977. *Law's Empire*, Cambridge Mas., *The Belknap Press of Harvard University Press.*, 1986. *A Matter of Principle*, Cambridge, Mas., *Harvard U.P.*.

Ph. Raynaud, "La démocratie saisie par le droit", *Notes de la fondation Saint-Simon*, shtator 1995 dhe *Le débat*, nr. 87, nëntor-dhjetor 1995. "Law et Right" në Barbara Cassin (bot.), *Vocabulaire européen de la philosophie*, në botim nga Seuil.

Cass R. Sunstein, *The Partial Constitution*, Harvard, 1993; *Legal Reasoning and Political Conflict*, Oxford, (1996).

Informacion për legjislacionin e miratuar në Kuvend

Filip Lako
Jurist

Qendra e Studimeve Parlamentare

Ligji nr.9565, datë 19.6.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Estonisë për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”” Në lidhjen e kësaj Marrëveshjeje palët kanë synuar të sigurojnë mbrojtjen e ndërsjellë të të gjithë informacionit të klasifikuar, të klasifikuar në shtetin e njëjës palë dhe të transferuar në shtetin e palës tjetër, me dëshirën për të vendosur rregullat për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar. Sipas Marrëveshjes “Informacion i klasifikuar” që do të shtrihen në të gjitha marrëveshjet e bashkëpunimit, të lidhura ndërmjet palëve, dhe në kontratat e vendosura ndërmjet organizatave të shteteve palë të cilat sigurojnë shkëmbimin e informacionit të klasifikuar” nënkupton çdo dokument ose material, pavarësisht nga forma, natyra apo mënyra e transmetimit, cili në interes të sigurisë kombëtare dhe në përputhje me ligjet e rregullat kombëtare të palëve, kërkon mbrojtje nga shkeljet, shkatërrimi, ekspozimi i paautorizuar, humbja, aksesit në të prej personave të paautorizuar ose ndonjë lloj tjetër komprometimi. Për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar dhe për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje ngarkohet Autoriteti i Sigurimit Kombëtar, i cili është një organ publik, i cili vepron në përputhje me ligjet kombëtare. Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë, organ i

tillë është Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, kurse për Qeverinë e Republikës së Estonisë është Departamenti i Sigurisë i Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Estonisë. Marrëveshja parashikon edhe mënyrën e transmetimit të informacionit të klasifikuar. Ky informacion do të transmetohet normalisht përmes shkëmbimit diplomatik, ushtarak dhe korrier, të miratuara nga autoriteti kompetent i sigurisë. Pala marrëse do të konfirmojë marrjen e informacionit të klasifikuar. Edhe shkatërrimi i këtij informacioni do të bëhet në mënyrë të tillë që të shmanget rindërtimi i pjesshëm ose i plotë i tij. Marrëveshja trajton edhe probleme lidhur me riprodhimin dhe përkthimin e informacionit tepër sekret, probleme lidhur me kontratat e klasifikuara, probleme që i përkasin rasteve të shkeljes së sigurisë etj.

Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 27.7.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.75 të vitit 2006, në faqen 2180. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja.

Ligj nr. 9566, date 19.6.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës së Industrive Gjermane (BDI)/(IFG), që vepron në emër të kreditorëve gjermanë, për riskedulimin e borxhit të prapambetur, kundrejt kreditorëve gjermanë, të pagarantuar nga Qeveria Federale e Gjermanisë” Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë njeht rregullsinë e borxheve, si dhe datat e tyre të maturitetit, konfirmon përfshirjen e tyre në këtë Marrëveshje dhe merr përsipër detyrimin për të paguar në kushtet që parashikohen këtu. Këto borxhe janë pasqyruar në listën e shtojcës 2, ku gjenden edhe datat e maturimit dhe sasia e borxhit në valutë. Marrëveshja do të përbëjë marrëdhënie ligjërishit detyruese ndërmjet BDI/IFG, që vepron në emër të kreditorëve gjermanë, dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Komiteti Qeveritar për Negocimin e Borxhit të jashtëm të Shqipërisë (GEDNCoA). Në Marrëveshje është parashkruar se për qëllime riplanifikimi, borxhet e emërtuara në dollarë amerikanë do të këmbehen me euro në kursin

e referencës me Euro të Bankës Qendrore Europiane. Në këtë kontekst, një dollar amerikan është i barabartë me 0.837 euro. Borxhet e rikonfirmuara, në një shumë totale prej 3 684.075 euro do të paguhen në 10 këste të barabarta, të njëpasnjëshme vjetore dhe gjashtëmujore. Data e maturimit të këstit të parë fillon më 30 qershor 2006 dhe data e maturimit të këstit të fundit është 30 dhjetor 2010. Në rast të ndonjë vonese, në ripagesë në kohën e maturimit, përqindja e interesit prej 4,5 për qind në vit, do të rritet nga një pikë përqindje nga data e maturimit të këstit të ripagesës, deri në ditën në të cilën është marrë pagesa. Në rast se një kreditor gjerman merr një pagesë të drejtpërdrejtë, me qëllim shlyerjen e një sasive borxhi të konfirmuar pjesërisht ose plotësisht, detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje do të pushojnë së zbatuari, duke filluar ditën në të cilën është marrë kjo pagesë nga kreditori gjerman. Janë parashikuar, gjithashtu, edhe konfliktet e pasojat e tyre që vijnë nga shkëlja e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje, si dhe mënyra e zgjidhjes së tyre. Pjesë e Marrëveshjes janë edhe dy shtojca. Shtojca 1 përmban listën e kreditorëve, kurse shtojca 2 përmban listat e kreditorëve e të debitorëve përkatës, datën e maturimit, sasinë e borxhit dhe llojin e valutës dhe ekuivalentët e tyre. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 16.7.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.67 të vitit 2006, në faqen 1869. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja dhe dy shtojca.

Ligj nr. 9567, datë 19.6.2006 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, të ndryshuar”. Ligjit në fuqi i bëhen pesë ndryshime, një shfuqizim dhe dy shtesa. Kudo në ligj fjalët “Ministri i Financave” zëvendësohen me fjalët “ministria përgjegjëse për ekonominë”, fjalët “Ministria e Financave”, zëvendësohet me fjalët “ministria përgjegjëse për ekonominë” dhe fjalët “Ministria e Rendit Publik” zëvendësohen me fjalët “ministria përgjegjëse për rendin publik”. Në nenin 4 të ligjit në fuqi trajtohen probleme të shqyrtimit të kërkesave për licencim. Ky nen ndryshon tërësisht dhe sipas

ndryshimit, për shqyrtimin e kërkesave për licencimin e lojërave të fatit, kazinotë dhe hipodromet, krijohet Komiteti i Lojërave të Fatit, si strukturë *ad hoc*, pranë ministrit përgjegjës për ekonominë. Përbërja, përgjegjësitë dhe mënyra e organizimit të këtij Komiteti përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Neni 5, i cili trajtonte probleme lidhur me emërimin e personelit të Komitetit të Lojërave të Fatit, është shfuqizuar. Përtëritja e lejes rregullohet nga neni 12 i ligjit në fuqi. Pika 2 e këtij neni ka ndryshuar dhe, sipas ndryshimit, organizatori i lojës së fatit duhet të bëjë kërkesë me shkrim në ministrinë përgjegjëse për ekonominë për rinovimin e lojës, të paktën 6 muaj përpara mbarimit të afatit të lojës së dhënë. Tërësisht ndryshon edhe neni 12. Sipas ndryshimit, ministri përgjegjës për ekonominë, bashkëpunon me ministrin përgjegjës për rendin publik për dhënien e lejeve për ushtrim veprimtarie për kazinotë dhe hipodromet. Neni 13 i ligjit në fuqi rregullon probleme që kanë të bëjnë kryesisht me kazinotë. Pika 2 e këtij neni ndryshon tërësisht dhe sipas ndryshimit, Këshilli i Ministrave përcakton zonat ku mund të hapen kazinotë. Ministri përgjegjës për ekonominë dhe ministri përgjegjës për rendin publik, me propozimin e Komitetit të Lojërave të Fatit, përcaktojnë numrin e kazinove që mund të hapen në çdo zonë të përcaktuar sipas këtij neni. Organizatori i pajisur me lejë nuk mund të hapë më shumë se një kazino në zonat e përcaktuara. Pas nenit 30 janë shtuar nenet 30/1 dhe 30/2. Neni 30/1 ngarkon organet tatimore të bëjnë mbikëqyrjen dhe kontrollin e ushtrimit të veprimtarisë së personave juridikë që ushtrojnë veprimtari në fushën e lojërave të fatit, kazinove dhe hipodromeve, në zbatim të dispozitave të këtij ligji dhe të ligjit në fuqi “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Neni 30/2 trajton probleme lidhur me transferimin, shitjen, lënin peng dhe çdo formë tjetër disponimi të aksioneve të shoqërive të licencuara për zhvillimin e lojërave të fatit, kazinove dhe hipodromeve. Ligji ka tetë nene dhe ka hyrë në fuqi më 27.7.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.75 të vitit 2006, në faqen 2185.

Ligj nr. 9568, datë 19.6.2006 “Për një ndryshim në ligjin nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, të ndryshuar””. Në paragrafin e dytë të nenit 8 të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 thuhet se pas vdekjes së veteranit, të drejtën e shpërblimit mujor e përfitojnë vetëm bashkëshorti i paaftë për punë, të miturit dhe personat e tjerë të paaftë për punë në ngarkim të tij, kur nuk përfitojnë pensione nga sigurimet shoqërore. Në paragrafin e tretë të nenit të lartpërmendur thuhet: “Familjarëve të veteranëve të vdekur para daljes së këtij statusi, që e përfitojnë atë, u jepet një shpërblim i menjëhershëm, përjashtuar familjeve të atyre veteranëve që e përfitonin shtesën e pjesëmarrjes në luftë prej 100 lekë në muaj.” Me ligjin nr.9568, datë 19.6.2006, paragrafi i dytë dhe i tretë i nenit 8 të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994, shfuqizohen. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 27.7.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.75 të vitit 2006, në faqen 2187.

Ligj nr.9569, datë 19.6.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë të Belgjikës për transportin ndërkombëtar rrugor””. Me lidhjen e kësaj Marrëveshjeje, qeveritë e të dy vendeve, synojnë krijimin e mundësie më të mira për zhvillimin e marrëdhënieve tregtare, krijimin e lehtësirave të kënaqshme për transportin e mallrave dhe udhëtarëve, njëkohësisht duke mbajtur parasysht procesin europian të liberalizimit, i cili kontribuon në lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve dhe të njerëzve. Dispozitat e Marrëveshjes do të zbatohen në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave dhe udhëtarëve për të tretë, ose me shpërblim, ose për llogari të vet, ndërmjet territoreve të palëve kontraktuese. Sipas Marrëveshjes, çdo palë kontraktuese duhet të lejojë cilindo operator transporti të vendosur në territorin e palës tjetër kontraktuese të kryejë transport mallrash dhe udhëtarësh. Peshat dhe përmasat e mjeteve duhet të jenë në përputhje me regjistrimin zyrtar të mjetit dhe nuk duhet të kapërcejnë limitet në fuqi në

vendin pritës. Operatorët e transportit të një pale kontraktuese dhe ekipet e mjeteve të tyre, kur janë në territorin e palës tjetër kontraktuese, duhet të zbatojnë ligjet dhe rregullat në fuqi në atë vend. Në rastin e ndonjë shkeljeje të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nga ndonjë transportues i një pale kontraktuese, pala kontraktuese në territorin e të cilës kryhet shkelja, mundet, pa paragjykim për procedimin e saj ligjor, t'ia njoftojë këtë shkelje palës tjetër kontraktuese, e cila do të ndërmarrë hapa, të cilat janë parashikuar në ligjet ndërkombëtare. Autoritetet kompetente të palëve kontraktuese do të rregullojnë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin dhe përdorimin e kësaj Marrëveshjeje dhe për këtë qëllim është parashikuar që ato të ngrejë një komitet të përbashkët. Ky komitet do të tregojë vëmendje të veçantë sidomos për zhvillimin e harmonizuar të transportit ndërmjet palëve kontraktuese, për bashkërendimin e politikave të transportit, për shkëmbimin e informacionit përkatës, për nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve dhe institucioneve të transportit etj. Marrëveshja përmban edhe dispozita për transportin e udhëtarëve lidhur me shërbimet e rregullta, shërbimet vajtjeardhje dhe shërbimet e rastit, si dhe dispozita lidhur me transportin e mallrave. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 10.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.78 të vitit 2006, në faqen 2227.

Ligji nr. 9570, datë 3.7.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar. Ligjit në fuqi (të cilit i janë bërë ndryshime e shtesa me 3 ligje të tjera më parë) tani i bëhen 11 ndryshime dhe 2 shtesa. Pas nenit 6, që tregon se cilat janë politikat aktive të tregut të punës, është shtuar neni 6/1 i cili përcakton se cilat janë veprimtaritë që përfshijnë shërbimet e punësimit. Të tilla janë informimi për vende të lira pune, ndërmjetësimet për punësim dhe këshillimet e orientimet për punë dhe profesion. Për këto shteti krijon dhe mban organizime të posaçme, që ofrojnë, pa pagesë, shërbime punësimi në të gjithë territorin e vendit. Pas nenit 7 të ligjit në fuqi (Ndërmjetësimi për punësim)

është shtuar neni 7/1 (Këshillimi dhe orientimi për profesion dhe punësim). Sipas këtij neni (7/1) këshillimi dhe orientimi për profesion dhe punësimi ka për qëllim t'i ndihmojë punëkërkuessit në zgjedhjen dhe formimin e tyre në një profesion të përshtatshëm me cilësitë individuale dhe të kërkuar në tregun punës. Shërbimi Kombëtar i Punës kryen, pa pagesë, këshillim dhe orientim për profesion dhe punësim për punëkërkuessit në të gjithë territorin e vendit. Ndryshime janë bërë në nenin 2 (Përfundimet), nenin 6 (Politikat aktive të tregut të punës, në nenin 7 (Ndërmjetësimi për punësim). Vlen të përmendet për këtë ndryshim fakti që janë caktuar përparësitë për ndërmjetësimin sidomos për punëkërkuessit nga grupe të veçantë dhe për punëkërkuessit të papunë afatgjatë. Ndryshim tërësor ka pësuar nenin 9 (Praktikat profesionale-stazhi). Edhe për formimin profesional, në nenin 11 janë bërë ndryshime. Me rëndësi është fakti që me ndryshimet e bëra i janë dhënë përparësi edhe punës të Zyrave të Punësimit. Këto të fundit mbështesin financiarisht, në bazë procedurash konkurrimi, organizimin e kurseve të formimit profesional, të organizuara nëpërmjet institucioneve të formimit profesional, publike ose private. Procedurat për zhvillimin e konkurrimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Ligji ka 16 nene dhe ka hyrë në fuqi më 10.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 78, të vitit 2006, në faqen 2233.

Ligj nr. 9571 datë 3.7.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane “Për programin rajonal CARDS 2005””. Kjo Marrëveshje është lidhur ndërmjet Komunitetit Europian, i përfaqësuar nga Komisioni i Komuniteteve Europiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Sipas saj, Komuniteti Europian do të kontribuojë për financimin e programit CARDS Rajonal 2005, i cili është përshkruar në dispozitat teknike dhe administrative në shtojcën II të Marrëveshjes. Komuniteti Europian ka marrë përsipër financimin e shumës 47 900 000 euro dhe është i ndarë sipas zërave të buxhetit që janë përshkruar

në dispozitat teknike dhe administrative të shtojcës II. Në shtojcën I trajtohen probleme lidhur me kostot, periudhën e ekzekutimit, lidhjen e kontratave dhe granteve, rregullat e zbatueshme për përmbushjen e kontratave siç janë e drejta e vendosjes dhe e qëndrimit të personave fizikë dhe juridikë që marrin pjesë në ftesat për tenderat e drejtë e cila do të jetë e vlefshme për një muaj pas dhënies së kontratës. Në këtë pjesë janë trajtuar edhe problemet lidhur me normat tatimore dhe doganore, normat mbi kursin e këmbimit, përdorimi i të dhënave nga studimet dhe alokimin e fondeve të rikthyera nga kontratat. Në shtojcën II bëhet fjalë për kushtet teknike dhe administrative, dhe jepet edhe përmbledhja e programit të veprimit. Ky program i veprimit rajonal reflekton Dokumentin Strategjik Rajonal (RSP) 2002-2006 dhe Programin Indikativ Shumëvjeçar 2005-2006. Programi indikativ shumëvjeçar për periudhën e referuar do të fokusohet në ngritjen institucionale, ku përfshihet reforma në administratën publike, drejtësia dhe çështjet e brendshme (rritja e bashkëpunimit të policisë dhe gjyqësorit), me fokus luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe që të korrespondojë me konsideratat dhe angazhimet politike të bëra nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Programi i veprimit përmban edhe bashkëveprimin ndërkuftar, zhvillimin e sektorit privat, zhvillimin e infrastrukturës (transporti, energjia, mjedisi e shoqëria e informacionit), duke i parë këto gjithnjë si një hapësirë ekonomike të përbashkët për operatorët e huaj. Në shtojcën II gjendet edhe pasqyra me projektet përkatëse (të ndara në mënyrë analitike për çdo projekt), si dhe buxheti për çdo projekt në tërësi dhe për ndarjet analitike. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 10.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.78 të vitit 2006, në faqen 2237.

Ligj nr.9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për krijimin, përgjegjësitë dhe funksionimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Fusha e veprimit të këtij Autoriteti është rregullimi dhe mbikëqyrja e tregut të tujve

dhe të veprimtarisë së këtij tregu, e tregut të sigurimeve dhe e veprimtarisë së këtij tregu, e tregut të pensioneve suplementare dhe e veprimtarive të tjera financiare jobankare. Ky Autoritet është person juridik publik, i pavarur, me seli në Tiranë, i specializuar për të rregulluar dhe mbikëqyrur veprimtarinë subjektive që ushtrojnë një ose disa nga veprimtaritë e përmendura më lart. Për këtë veprimtari Autoriteti raporton në Kuvend. Organi vendimmarrës i tij është bordi, i cili përbëhet nga 7 anëtarë, nga të cilët 1 kryetar, 2 nënkryetarë dhe 4 anëtarë. Ligji ka përcaktuar se cilat janë kërkesat për t'u emëruar anëtar i bordit, gjithashtu, ligji tregon mënyrën se si emërohen këta anëtarë, sa është mandati i tyre, kur bëhet lirimi nga detyra e anëtarit të bordit, kompetencat në miratimin e strukturës dhe të pagave të Autoritetit, kur bëhen mbledhjet e bordit e si thirren ato, transparenca në veprimtarinë e Autoritetit etj. Në kreun III trajtohen objektivat, kompetencat e Autoritetit dhe të drejtat e bordit. Kështu Autoriteti në përmbushjen e funksioneve dhe të kompetencave të parashikuara në këtë ligj udhëhiqet nga mbrojtja e interesave të investitorëve dhe të personave të siguruar, nga nxitja e qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve financiare jobankare dhe nga sigurimi i respektimit të ligjit. Po në këtë kre trajtohen kompetencat e bordit, objekti i veprimtarisë së “Autoritetit, kompetencat e kryetarit të bordit, të nënkryetarëve dhe të anëtarëve që nuk kanë funksione ekzekutive. Veprimtaria e Autoritetit mbështetet nga një administratë, që funksionon në përputhje me rregulloren e brendshme dhe me rregulloret e tjera për funksionimin e administratës, që miratohen nga Bordi me propozimin e kryetarit. Me rëndësi të veçantë janë edhe ato pjesë të ligjit ku trajtohen problemet e konfliktit të interesit të anëtarëve të bordit dhe të nëpunësve të Autoritetit, problemet e Kodit Etik, profesionalizmi dhe konfidencialiteti etj. Ligji trajton edhe probleme lidhur me financimin dhe buxhetin e Autoritetit, kontrollin e veprimtarisë së Autoritetit etj. Ligji i lartpërmendur ka shfuqizuar ligjin nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve” dhe bën ndryshime në ligjin nr.8080, datë 1.3.1996

“Për letrat me vlerë” dhe në ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”. Ligji nr.9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” ka 43 nene dhe ka hyrë në fuqi më 10.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.78 të vitit 2006, në faqe 2252.

Ligji nr.9573, 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”. Ky ligj ka si qëllim të rrisë në një shkallë më të lartë sigurinë në qarkullimin rrugor, si dhe të parandalojë e të luftojë trafikun e mjeteve të vjedhura. Gjithashtu, ai përcakton rregullat që duhen zbatuar për kryerjen e shërbimeve nga subjektet që kryejnë veprimtarinë e autoriparimit, që blejnë, shesin ose ndërmjetësojnë në shitblerje, që pjesëtojnë, rivënë në punë, japin mjete me qira ose venë në dispozicion të të tretëve mjetet e tyre, që depozitojnë dhe shkatërrojnë mjetet e dala jashtë përdorimit, si dhe përcakton rregullat për ushtrimin e veprimtarisë së agjencive, që trajtojnë praktikat për qarkullimin e mjeteve me motor dhe të rimorkiove. Objekti i ligjit është disiplinimi dhe monitorimi i veprimtarive për autoriparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve motorike, blerjen dhe shitjen e tyre, vendruajtjet, dhënien me qira, si dhe mbledhjen, depozitimin dhe shkatërrimin e mjeteve ose pjesëve të tyre, të dala jashtë përdorimit ose të braktisura. Në ligj jepen në mënyrë të detajuar përkufizimet e termave dhe kuptimi i tyre. Kjo bëhet për termat “Autoriparim”, “Veprimtari të riparimit” dhe “Veprimtari e mirëmbajtjes së mjeteve me motor dhe të rimorkiove.” Trajtohen në ligj edhe procedura për dhënien e lejeve për veprimtarinë e autoriparimit, për regjistrimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari autoriparimi, për mënyrën e plotësimit të regjistrit, për kushtet dhe procedurat për regjistrim, për detyrimet e pronarit ose të përdoruesit të mjeteve me motor dhe/ose rimorkiove, për kërkesat që duhet të plotësojë një person që të jetë përgjegjës teknik etj. Lidhur me veprimtarinë e shitblerjes së mjeteve të reja ose të përdorura, ligji përcakton se kjo

veprimtari u lejohet vetëm subjekteve juridike, të regjistruara në seksionin përkatës të regjistrit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Edhe për ndërmjetësimin në shitblerje, subjektet që e ushtrojnë këtë veprimtari ndërmjetësimi trajtohen si subjekte të tatueshme dhe i nënshtrohen legjislacionit në fuqi. Ligji vendos rregulla edhe për veprimtarinë e mbledhjes, depozitimit, shkatërrimit të mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe të pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura, duke detyruar që të ushtrojnë veprimtari të tillë, që këto mjete të vendosen në vende të veçanta, të përcaktuara në bashkëpunim me organet përkatëse të pushtetit vendor, sipas kërkesave për mbrojtjen e mjedisit. Janë parashikuar edhe sanksione për rastet e ushtrimit pa leje të çdo veprimtarie, për të cilat ky ligj kërkon marrjen e lejes. Ligji ka 45 nene dhe ka hyrë në fuqi më 12.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.79 të vitit 2006, në faqen 2271.

Ligji nr. 9574, datë 3.7.2006 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar”. Në ligjin në fuqi bëhen 4 ndryshime, 2 shfuqizime dhe në një rast bëhet zëvendësim emërtimi. Kështu, kudo në ligj emërtimi “Drejtoria” e Përgjithshme e Hidrokarbureve” zëvendësohet me emërtimin “Strukturat përgjegjëse për veprimtarinë e hidrokarbureve”. Në nenin 14 paragrafi i parë i pikës 4 tregonte se si bëhej transporti i naftës, si lidheshin kontratat, me çfarë mjete bëhej transporti, pronë e kujt mund të jenë këto mjete etj. Ky paragraf është hequr dhe ka mbetur vetëm paragrafi i dytë i kësaj pike me këtë përmbajtje: “Shoqëria e tregtimit me shumicë përgjigjet për sasinë dhe cilësinë e ngarkesës gjatë transportit”. Pika 1 e nenit 12 trajtonte probleme të përcaktimit të rafinerive të naftës si persona juridikë, tregonte se si duhej bërë formimi i shoqërive të tregtimit me shumicë e pakicë, cilat dispozita duhet të zbatonin lidhur me konkurrencën etj. Kjo pikë tani shfuqizohet. Kudo në nenin 17

hiqen fjalët “Lojë përpunimi”, kurse pika 1 e nenit 18 shfuqizohet. Kjo pikë tregonte se kujt u jepej leja e koncesionit .Ka ndryshuar tërësisht neni 21 dhe, pas ndryshimit, ka këtë përmbajtje “Personat juridikë, që paraqesin kërkesë për leje tregtimi, sipas nenit 19 të këtij ligji, janë të detyruar të plotësojnë kushtin e kapacitetit të depozitimit në instalimet, prona të tyre ose të marra në përdorim me kontratë, për një periudhë kohore të barabartë me atë të vlefshmërisë së lejes së tregtimit. Kushtet e dhënies së lejes së tregtimit përcaktohen nga Këshillit i Ministrave. Kushti i kapacitetit të depozitimit specifikohet, sipas llojit të lejes dhe kategorisë së produkteve që tregtojnë.” Në nenin 25 fjalët “Impiante përpunimi” dhe “Leje përpunimi” hiqen. Ligji ka 8 nene dhe ka hyrë në fuqi më 12.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 79 të vitit 2006, në faqen 2282.

Ligj nr.9575, datë 3.7.2006 “Për faljen e gjobave të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për personat juridikë e fizikë, të regjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël, për periudhat tatimore të vitit 2005””. Sipas këtij ligji, personave juridikë e fizikë, të regjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël, u falen gjobat e vendosura, që i përkasin të gjitha periudhave tatimore të vitit 2005, që lidhen me deklarin dhe pagimin me vonesë të detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore, të kontributeve të sigurimit të kujdesit shëndetësor dhe të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, me kusht që deklarimi dhe pagesa të bëhen brenda datës 31.12.2006. Personave juridikë e fizikë, të regjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël u rimbursohet shuma e gjobave të paguara, që i përkasin të gjitha periudhave tatimore të vitit 2005, që lidhen me deklarin dhe pagimin me vonesë të detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore, të kontributeve të sigurimit të kujdesit shëndetësor dhe të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi. Ligji ka zgjidhur edhe problemet e ndërmjetme që lidhen me këtë falje. Kështu çështjet

në proces apelimi dhe çështjet për ekzekutimin e vendimeve të gjykatave, që kanë marrë formë të prerë, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që lidhen me gjobat e përmendura më lart, pushohen. Për zbatimin e këtij ligji janë ngarkuar të gjitha institucionet shtetërore, të prekura nga fusha e zbatimit të tij. Ligji ka 5 nene dhe ka hyrë në fuqi më 12.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.79 të vitit 2006, në faqen 2283.

Ligji nr. 9576, datë 3.7.2006 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Ligjit nr. 8461, datë 25.2.1999, i janë bërë ndryshime dhe shtesa me ligjet nr. 9120, datë 28.7.2003, nr. 9206, datë 17.6.2004 dhe ne. 9387, datë 4.5.2005. Me ligjin nr. 9576, datë 3.7.2006 bëhen ndryshime dhe shtesa për herë të katërt. Pas nenit 10 të ligjit në fuqi janë shtuar nenet 10/1 (Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës, neni 10/2 (Përbërja e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës), neni 10/3 (Kriteret për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës), neni 10/4 (Mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve të tjerë të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës) dhe neni 10/5 (Funksionimi i Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës). Në nenin 13 të ligjit në fuqi, pas paragrafit të tretë, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Ministria e Arsimit dhe Shkencës miraton formën dhe përmbajtjen e diplomës dhe shtojcës së diplomës, që lëshohen nga shkollat e larta. Në nenin 31 ndryshimet janë bërë kryesisht lidhur me kriteret për pranimet në shkollat e larta. Kështu, sipas këtyre ndryshimeve, pranimet në shkollat e larta publike bëhen në bazë të kuotave. Kuotat e pranimit për sistemin e studimeve me kohë të plotë propozohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave. Për përcaktimin e kuotave dhe të tarifave të shkollimit merret edhe mendimi i shkollave të larta. Pranimet në shkollën e lartë publike bëhen me konkurrim. Mënyra e konkurrimit përcaktohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Kur numri i kandidatëve të regjistruar është më i vogël se kuota e parashikuar,

pranimit janë të hapura. Ndryshimet në nenin 35 kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e studimeve. Studimet në shkollat e larta kryhen në vite akademike. Në shkollat e larta universitare studimet janë të organizuara në cikle studimi. Cikli i parë i studimeve zgjat të paktën 3 vite akademike. Në shkollat e larta jouniversitare studimet zgjasin 2 vite akademike. Studenti, në përfundim të tyre, merr diplomën përkatëse. Kualifikimi shkencor pasuniversitar kryhet pranë shkollave të larta universitare dhe përfundon me dhënien e gradës shkencore “doktor i shkencave”. Ligji ka 8 nene dhe ka hyrë në fuqi më 12.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 79 të vitit 2006, në faqen 2288.

Ligj nr.9577, datë 11.7.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Letonisë për transportin ndërkombëtar rrugor”. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Letonisë, me dëshirën për të nxitur transportin e udhëtarëve dhe mallrave me automjete ndërmjet dhe në transit përmes territoreve të të dy vendeve, kanë lidhur këtë Marrëveshje më datën 28 mars 2006 në Rigë. Kjo Marrëveshje zbatohet për operimet e transportit ndërkombëtar rrugor të kryera nga transportuesi, i cili në vendin e tij amtar, në përputhje me legjislacionin kombëtar, i është dhënë e drejta të kryejë veprime të transportit ndërkombëtar rrugor, me qira dhe shpërblim ose për llogari të vet, dhe mund të kryejë operime të tilla për në, nga, ose në transit nëpërmjet territorit të vendit tjetër. Transportuesi dhe stafi i tyre duhet t’u binden ligjeve dhe dispozitave kombëtare në fuqi në territorin e vendit pritës, ndërsa kryejnë operimet e transportit rrugor brenda territorit të vendit pritës. Për aplikimin dhe zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente të të dyja palëve krijojnë një komitet të përbashkët, i cili formohet nga delegatë të caktuar nga këto autoritetet. Autoritete kompetente janë për Republikën e Shqipërisë, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

dhe për Republikën e Letonisë, Ministria e Transportit. Në Marrëveshje trajtohen shërbimet e rregullta dhe vajtje-ardhje, shërbimet e rastit, regjimi i lejeve, përjashtimi nga kërkesa e lejeve etj. Shërbimet e rregullta dhe vajtje-ardhje, të kryera ndërmjet territoreve të palëve kontraktuese ose në transit ndërmjet tyre, miratohen më përpara bashkërisht nga autoritetet e tyre kompetente. Për sa i përket regjimit të lejeve, parashikohet që transportuesi mund, nëpërmjet lejeve të siguruesve paraprakisht të lëshuara nga autoriteti kompetent i vendit pritës, të kryejë transport mallrash ndërmjet territoreve të palëve kontraktuese, vetëm në se vendoset ndryshe nga komiteti i përbashkët. Transportuesi transit i mallrave ndërmjet tyre do të kryhet pa leje. Marrëveshja parashikon edhe rastet se kur mund të bëhet përjashtim nga kërkesa e lejeve. Raste të tilla janë kur pesha e ngarkuar totale e lejueshme nuk i kalon 6 tonët, kur bëhet transport i mjeteve të cilat janë dëmtuar ose shkatërruar dhe transporti i mjeteve për riparimin e dëmeve, udhëtimet pa ngarkesë të një mjeti mallrash i dërguar për të zëvendësuar një mjet, i cili është dëmtuar, transportimi i furnizimeve dhe pajisjeve mjekësore të nevojshme për emergjencat. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 17.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.81 të vitit 2006, në faqen 2761. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja.

Ligji nr. 9578, datë 11.7.2006 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “Marrëveshjen e koncesionit, të formës “BOT” për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës “, ratifikuar në ligjin nr. 9298, datë 28.10.2004””. Me këtë ligj është miratuar një Marrëveshje shtojcë, për Marrëveshjen e koncesionit. Pra duke mbajtur parasysh se në Marrëveshjen e nënshkruar më datë 8.9.2004 vërehen disa pasaktësi në disa nene të saj, Palët, Qeveria e Republikës së Shqipërisë e përfaqësuar nga Organi Shtetëror i Autorizuar – OSHA dhe Shoqëria Koncesionare “Romano PORT”, gjithashtu duke mbajtur parasysh

edhe interesin dhe rolin mbizotërues të shtetit në dhënien në koncesion, administrimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore e të zhvillimit të sektorëve të ekonomisë, palët kanë rënë dakord që të bëjnë disa ndryshime e shtesa. Është rënë dakord që të mos lejohet përdorimi i postit nga subjekte të palicencuara, përveç rasteve kur kjo është kërkesë eksplicite e OSHA-së. Tarifat dhe çmimet e aplikueshme për shërbimin do të rishikohen çdo vit. Tarifat e reja të rishikuara do të shpallen nga OSHA dhe koncensioneri 30 ditë përpara datës së hyrjes në fuqi të tyre. Deri në atë moment do të vazhdojnë të aplikohen tarifat dhe çmimet e mëparshme. Koncensioneri do të kryejë nëpërmjet pontilit vetëm veprimtarinë e ngarkim-shkarkimit të naftës, gazit të lëngshëm dhe nënprodukteve të saj dhe jo aktivitete të tjera tregtare. Anijet që do të futen dhe do të dalin nga ky pontil, do të paguajnë ato tarifa për kryerjen e shërbimeve nga koncensioneri që janë të miratuara nga OSHA-ja. OSHA mbikëqyr procedurat e hyrjes dhe daljes nga porti duke pasur të drejtë të vendosë, në rast se ka më shumë se një anije që kërkon të shkarkohet, radhën preferenciale të hyrjes. Po ashtu, OSHA vendos kushtet e kriteret teknike që duhet të plotësojnë anijet që do të hyjnë në këtë port, dhe gëzon të drejtën të përjashtojë ato anije që nuk plotësojnë kushtet e vendosura prej saj për kategorinë, llojin etj. Të gjitha mosmarrëveshjet që do të dalin nga kjo Marrëveshje koncesioni, të cilat nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim nga përfaqësuesit e palëve, gjatë dy takimeve të cilat do të zhvillohen brenda një periudhe kohe jo më gjatë se 60 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës me shkrim nga njëra prej palëve, do të trajtohen e do të zgjidhen nëpërmjet arbitrazhit ndërkombëtar. Vendi i arbitrazhit do të jetë Parisi. Vendimi i dhënë nga arbitri do të jetë detyrues dhe përfundimtar për palët. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 17.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.81 të vitit 2006, në faqen 2765. Ligjit i bashkëlidhet, Shtojca e Marrëveshjes, Aneksi 1 (ndërtimi i pontilit), Aneksi 2 (shfrytëzimi i pontilit), Aneksi 3 (Mirëmbajtja e infrastrukturës), Aneksi 4 (tarifat) dhe Aneksi 5 (transferimi në shtet i pontilit).

Ligji nr. 9579, datë 11.7.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së financimit ndërmjet Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin “Modernizimi i sistemit shëndetësor””. Sipas kësaj Marrëveshje, financimi i Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) bie dakord t’i japë hua Republikës së Shqipërisë një shumë në monedha të ndryshme prej 10.700.000 SDR për të asistuar në financimin e projektit të përshkruar hollësisht në këtë Marrëveshje. Pikësynimet e Projektit janë përmirësim i aksesit fizik dhe financiar dhe përdorimi i shërbimeve shëndetësore parësore të cilësisë së lartë, përmirësimi i kapacitetit për të formuluar dhe zbatuar praktika dhe reforma shëndetësore në sektorin e shëndetësisë dhe përmirësimi i administrimit dhe menaxhimit të spitaleve. Në programet që i bashkëlidhen Marrëveshjes bëhet përshkrimi i hollësishëm i projektit dhe zbatimi i tij. Sipas pjesës të zbatimit të projektit, në seksionin I të tij flitet për funksionimin institucional, duke ngarkuar Marrësin (Republikën e Shqipërisë) që të zbatojë projektin në përputhje me disa mekanizma bashkërenduese. Nga këto del që përgjegjës për zbatimin dhe menaxhimin e përgjithshëm të projektit do të jetë zëvendësministri i Shëndetësisë në Ministrinë e Shëndetësisë, kurse përgjegjës për menaxhimin e përditshëm të projektit do të jetë Drejtori i Drejtorisë së Ekonomisë në Ministrinë e Shëndetësisë. Seksioni II i Programit 2, trajton probleme të marrëveshjes së zbatimit. Sipas kësaj, Marrësi do të përmbushë detyrimet në përputhje me planin e zbatimit të projektit dhe me Manualin e operacioneve për Programin e Granteve të Vogla dhe nuk do të amendojë, pezullojë, shfuqizojë, anulojë ose heqë dorë nga ndonjë dispozitë e planit të zbatimit të Projektit ose Manualit të Operacioneve për Programin e Granteve të Vogla. Marrësi, gjithashtu, do të monitorojë dhe vlerësojë ecurinë e Projektit, do të përgatisë raportet përkatëse dhe do të mbajë ose do të nxisë mbajtjen e një sistemi të menaxhimit financiar. Të gjitha mallrat që nevojiten për projektin dhe që do të financohen jashtë të ardhurave të financimit do të prokurohen në përputhje me kërkesat që përcaktohen ose që referohen në seksionin e udhëzimeve për prokurimet.

Parashikohen edhe metoda të veçanta të prokurimit të mallrave. Kështu, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe, mallrat do të prokurohen nëpërmjet kontratave që bëhen mbi bazën e tenderimit konkurrues ndërkombëtar. Në tabela të veçanta tregohen kategoritë e mallrave sipas referimit, shuma e kredisë së shpërndarë dhe përqindja e shpenzimeve që do të financohen. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 17.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 81 të vitit 2006, në faqen 2773. Ligjit i bashkëlidhen Marrëveshja e Financimit, Programi 1 (përshkrimi i projektit), Programi 2 (zbatimi i projektit) dhe shtojca (përcaktime).

Ligji nr. 9580, datë 13.7.2006 “Për një ndryshim në ligjin nr. 8408, datë 25.9.1998 “Për Policinë e Ndërtimit”, të ndryshuar”. Në ligjin e lartpërmendur bëhet vetëm një ndryshim në pikën 2 të nenit 3. Sipas kësaj pike të nenit 3, nga të ardhurat që vinin prej vendosjes së gjobave për shkelje të dispozitave të këtij ligji, 60 për qind e tyre kalonin në Buxhetin e Shtetit dhe 40 për qind në favor të Policisë së Ndërtimit. Pika 2 e nenit 3 ka ndryshuar dhe tani ka këtë përmbajtje: “Të vendosë gjoba për shkeljen e dispozitave ligjore të mësipërme. Të gjitha të ardhurat e krijuara nga gjobat derdhen në Buxhetin e Shtetit”. Përfundimisht, për vitin 2006, pjesa e të ardhurave, që do të përdoret për investime dhe shpenzime operative, është ajo që Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit ka miratuar për Policinë e Ndërtimit”. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 17.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 81, të vitit 2006, në faqen 2782.

Ligji nr. 9581, datë 13.7.2006 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”. Në ligjin nr. 8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore”, në nenin 8 (llojet e taksave vendore) në shtojcën “d” si taksë vendore përfshihet edhe taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme. Neni 17 i këtij ligji trajton problemin e taksës mbi

kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, kurse neni 18, flet për rastet e përjashtimit nga pagimi i taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme. Me ligjin nr. 9325, datë 6.12.2004 “Për disa shtesa në ligjin nr. 8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore” ndërmjet të tjerash është shtuar neni 25/1. Ky nen ka këtë përmbajtje: “Shkronja “d” e nenit 8 dhe nenet 17 e 18 të këtij ligji do të jenë në fuqi deri më 1 janar 2006”. Me ligjin nr. 9581, datë 13.7.2006 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, shkronja “d” e nenit 8 dhe nenet 17 e 18 (të përmendura më lartë) edhe pse janë shfuqizuar më 1 janar 2006 me ligjin nr. 9325, datë 6.12.2004, përsëri paraqiten me të njëjtën përmbajtje si ajo e vitit 2002 dhe ligji nr. 9581, datë 13.7.2006 i shton ato tekstualisht ashtu si kanë qenë në vitin 2002 dhe që u shfuqizuan në vitin 2004. Gjithashtu, edhe Aneksi 3 (nivelet e taksës së kalimit të pronësisë mbi matësat) i miratuar me ligjin nr. 9581, datë 13.7.2006 është tekstualisht si Aneksi 3 i ligjit nr. 8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore”. Ligji 9581, datë 13.7.2006 ka 4 nene dhe ka hyrë në fuqi më 17.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 81 të vitit 2006, në faqen 2783.

Ligj nr.9582, datë 13.7.2006 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8637, datë 6.7.2000 “Për Policinë Elektrike”, të ndryshuar””. Me ligjin e lartpërmendur janë bërë dy ndryshime dhe pikërisht në nenin 14 dhe 15 të ligjit në fuqi me nr.8637, datë 6.7.2000. Sipas paragrafit të tretë të nenit 14 të ligjit nr.8637, datë 6.7.2000 “Për Policinë Elektrike” të ardhurat nga gjobat kalojnë 50 për qind në favor të Buxhetit të Shtetit dhe 50 për qind në favor të Policisë Elektrike, prej së cilës deri në 10 për qind mund të përdoret, si shtesë mbi pagë për punonjësit që i realizojnë. Me ndryshimin e fundit që bëhet, “të ardhurat nga gjobat, nga vjelja e debive dhe shlyerjet e dëmeve, të realizuara prej Policisë Elektrike, derdhen në Buxhetin e Shtetit.” Sipas paragrafit të katërt të nenit 14 të ligjit në fuqi “Të ardhurat nga vjelja e

debive dhe shlyerjet e dëmeve të realizuara prej Policisë elektrike, kalojnë 90 për qind në favor të entit elektrik shpërndarës përkatës dhe 10 për qind në favor të Policisë elektrike”. Me ndryshimin që bëhet me ligjin nr.9582, datë 13.7.2006, ky paragraf ka këtë përmbajtje: “Përjashtimisht, për vitin 2006, pjesa e të ardhurave, që do të përdoret për investime dhe shpenzime operative në Policinë Elektrike, është sipas buxhetit të vitit 2006 të miratuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.” Sipas nenit 15 të ligjit në fuqi “Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit miraton organikën dhe fondin e pagave për Policinë Elektrike, i cili për periudhën deri në fund të vitit 2000 përballohet nga fondet e Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare dhe pas kësaj periudhe, përballohet nga Buxheti i Shtetit, si dhe lidhjen e pagës e të shpërblimeve suplementare me realizimin e detyrave.” Me ndryshimet që i janë bërë nenit 15, ai tani ka këtë përmbajtje: “Struktura dhe organike e Policisë Elektrike përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, brenda numrit të punonjësve të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave për ministrinë e linjës. Pagat dhe shpërblimet përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.” Ligji ka 3 nene dhe ka hyrë në fuqi më 17.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.81 të vitit 2006, në faqen 2785.

Ligj nr.9583, datë 17.7.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar. Ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i janë bërë disa ndryshime e shtesa, të cilat kanë zgjidhur një numër problemesh të rëndësishme, si në themel, ashtu edhe në procedurë lidhur me normat. Ndryshimet e shtesat janë të shumta dhe në pamundësi për t’i trajtuar të gjitha në këtë përmbledhje të shkurtër, po paraqesim disa nga më të spikaturat. Me ndryshimet që janë bërë, tanimë fusha e veprimit të këtij ligji shtrihet edhe për pasuritë e shtetasve shqiptarë, të krijuara përpara datës 7 prill 1939 dhe që janë sekuestruar sipas nenit 14 të ligjit nr.37, datë 13.1.1945 “Për tatimet e jashtëzakonshme për fitimet e

luftës”. Sipas këtyre ndryshimeve me truall industrial nënkuptohet sipërfaqja e tokës që ndodhet jashtë vijave kufizuese të qyteteve dhe qendrave të banuara, mbi të cilën janë ngritur objekte të përhershme ndërtimore për qëllime ekonomike ose që u shërbejnë funksionit të tyre. Tani u njihet e drejta e pronësisë dhe u kthehen subjektive të shpronësua, sipas kritereve të këtij ligji, edhe pasuritë e paluajtshme toka me vendndodhje brenda territoreve turistike, sipas ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”. Gjithashtu, subjekteve të shpronësuara u kthehen të gjitha pronat e paluajtshme në pronësi ose përdorim të Ministrisë së Mbrojtjes, por që janë jashtë strukturave të forcave të armatosura. Në rastet kur në pronën e marrë me qira është ndryshuar destinacioni i objekteve të ndërtuara, për të cilën është rënë dakord për t’i përdorur, toka quhet e pazënë dhe i kthehet subjektit të shpronësuar. Në ligj gjejnë zgjidhje edhe probleme lidhur me pronat që nuk kthehen, për pronat e kthyera që i shërbejnë interesit publik, të trojeve të zëna me ndërtime në pronësi të shtetit etj. Është përcaktuar qartë edhe zgjidhja e problemit për sa i përket banesave, pronë e subjekteve të shpronësuara, të cilat u janë dhënë me qira qiramarrësve nga shteti, para hyrjes në fuqi të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”. Ndryshimet dhe shtesat në ligj kanë dhënë më të plota e më të qarta detyrat dhe kompetencat e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, përgjegjësitë e zyrave në qendër dhe në qarqe, procedurat e ankimit etj. Ligji ka 24 nene dhe ka hyrë në fuqi më 17.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.81 të vitit 2006, në faqen 2286.

Ligj nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”. Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i mënyrës së përcaktimit të pagave, shpërblimeve dhe strukturave e organikave të institucioneve kushtetuese e të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj, si dhe përcaktimi i rregullave për pagat

dhe strukturat për disa institucione të tjera të pavarura dhe disa funksione të larta shtetërore. Pagat e punonjësve të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj, që nuk rregullohen me ligj, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji organik për krijimin e tyre. Paga më e lartë në institucionet e administratës publike, buxhetore dhe jobuxhetore, në Republikën e Shqipërisë është paga e Presidentit të Republikës. Paga e Presidentit të Republikës përcaktohet çdo vit në ligjin vjetor të Buxhetit të Shtetit, sipas propozimit të Këshillit të Ministrave. Pagat e funksionarëve të lartë shtetërorë të institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj, mandati i të cilëve është me kohë të plotë, përcaktohen në raport me pagën e Presidentit të Republikës, sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. (Në këtë tabelë gjendet raporti në përqindje, në krahasim me pagën e Presidentit të Republikës). Funksionarët e lartë shtetërorë të institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, nuk përfitojnë shtesa mbi pagë për punë jashtë orarit zyrtar të miratuar. Pagat e funksionarëve të kabineteve ndihmëse të Presidentit dhe të Kryetarit të Kuvendit janë të njëjta me pagat e funksionarëve të kabinetit ndihmës të Kryeministrit dhe përcaktohen nga Këshilli i Ministrave. Edhe këta funksionarë nuk përfitojnë shtesa mbi paga për punë jashtë orarit zyrtar. Struktura dhe organika e institucioneve kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, miratohen me vendim të Kuvendit, në bazë të numrit të miratuar në zbatim të ligjit vjetor të Buxhetit të Shtetit, për secilin institucion. Me miratimin e këtij ligji bëhen disa shfuqizime në ligjin nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin e pasurive”, në ligjin nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për RTV publik e privat në RSH” etj. Ligji ka 21 nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.84 të vitit 2006, në faqen 2841.

